



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.104/02-4044/25
Kaçanik, 27.02.2024

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 27 shkurt 2025, pos tjerash,

NJOFTOHET

1. Me Raportin Vjetor të Ekzekutivit të Komunës, për periudhën, Janar-Dhjetor 2024.

2. Në Raportin e përcaktuar si në pikën 1 të kësaj Shkrese është paraqitur, aktiviteti i Kryetarit të Komunës dhe Drejtorive Komunale që e kanë zhvilluar në saxe të objektivave dhe përgjegjësive të përcaktuara, për një funksionim të mirë të qeverisjes lokale, për periudhën: 01 Janar -31 Dhjetor 2024, duke paraqitur edhe sfidat -vështirësitë që i kanë përcjellë për gjatë realizimit të objektivave.


3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese, është: Raporti Vjetor i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2024 /Lënda 01Nr.104/02-4044/25.

Më këtë shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoritë komunale; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	18.02.2025	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë	
01	104/02-4044	*10	

Raporti i Ekzekutivit viti 2024

Hartoi: Zyra e Kryetarit

Fjala e Kryetarit

Bazuar në obligimet tona ligjore, përmes raportit të ekzekutivit komunal, do të raportoj për punën dhe aktivitetet komunale të realizuara gjatë vitit 2024.

Në vijimësinë e këtij raporti do të njoftoheni me të gjitha punët dhe projektet komunale të realizuara gjatë vitit 2024. Këto aktivitete janë përmbushur në përputhje të plotë me autorizimet ligjore që kam si kryetar i komunës, siç janë realizimi i projekteve infrastrukturore, zhvillim ekonomik, investime në sektorin e bujqësisë, infrastrukturë arsimore, shëndetësi, rini dhe sport.

Të gjitha këto aktivitete janë realizuar mbi parimin e transparencës dhe llogaridhënies, elemente këto tashmë të shëndrruara në mekanizëm jetik për qeverisjen tonë.

Profesionalizmi, ligjshmëria, integriteti dhe etika gjatë proceseve vendimmarrëse në komuna garantojnë llogaridhënie dhe përgjeghshmëri institucionale karshi qytetarëve,

Raporti Vjetor 2024

Kryetari Komunës
Besim Ilazi



- Zyra e Kuvendit
- Zyra e Prokurimit
- Zyra Ligjore
- Inspektorati komunal
- Zyra për Barazi Gjinore

- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtoria e Arsimit
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
- Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë
- Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

RAPORTI I PUNËS I SEKTORIT TË KUVENDIT PËR VITIN 2024

Punët dhe detyrat e punës së Kuvendit të Komunës dhe trupave punuese të kuvendit, përgatiten nga një (1) zyrtar i punësuar në Sektorin e Kuvendit dhe nga një (1) zyrtar i punësuar në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit. Me angazhimin e këtyre zyrtareve, përgatiten; mbledhjet, përpilohen Procesverbalet e

mbledhjeve, Vendimet dhe shkresat tjera dhe të njëjtat arkivohet për nevojat e komunës dhe të qytetarëve të saj.

Për gjatë periudhës raportuese nga Sektori i Kuvendit të Komunës, janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

1. Pranimi i çdo lënde të adresuar në emër të Kuvendit të Komunës, trupave punuese dhe zhvillimin e procedurave të mëtutjeshme;
2. Përgatitjet e nevojshme për mbledhjen 12 mbledhje të rregullta të Kuvendit të Komunës (mbledhja e 6 me dy vazhdime), 1 mbledhje të jashtëzakonshme, 1 mbledhje solemne, 1 mbledhje komemorative dhe distribuimi i tyre;
3. Përgatitjet e nevojshme për 11 mbledhje të rregullta të Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF, për 10 mbledhje të rregullta të Komitetit për Komunitete;
4. Mbajtja dhe përpilimi i procesverbaleve të 12 mbledhjeve të KK (mbledhja e 6 me dy vazhdime), 1 mbledhje të jashtëzakonshme, 1 mbledhje solemne, prezantimi për shqyrtim i proceseve të mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjes së jashtëzakonshme;
5. Mbajtja e procesverbalit për 11 mbledhje të rregullta të KPF, prezantimi i tyre për shqyrtim në mbledhjet organeve shqyrtues;
6. Mbajtja e Procesverbalit për 10 mbledhje të rregullta të Komitetit për Komunitet, prezantimi i tyre për shqyrtim në mbledhjet organeve shqyrtues;
7. Përpilimi i 68 vendimeve të KK, kryesisht në bazë të propozim vendimeve, përpilimi i shkresave 45 shkresave të tjera të dala nga mbledhjet e KK;
8. Dërgimin e akteve të KK për përkthim, tek zyrtari përkatës për përkthime;
9. Dërgimin e të gjitha Vendimeve të Kuvendi i Komunës, Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë përkatëse ekzekutuese;
10. Dërgimin e të gjitha vendimeve të Kuvendit të Komunës, në afatin e përcaktuar ligjor, Zyrës Ligjore të MAPL, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre, procedura e mëtutjeshme pas konfirmimit të ligjshmërisë (publikimit apo procedurën e rishqyrtimit të aktit);
11. Dërgimin e të gjitha akteve dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, në afatin e përcaktuar ligjor, Zyrës për Informim, respektivisht Zyrës së IT me qëllim të publikimit të tyre në faqen zyrtare të komunës;

Zyra e Prokurimit

Objektivat e Zyres së Prokurimit si njisi në kuader të zyrës së Kryetarit kanë qenë në përmbushjen e kërkesave të njisisve kërkuese respektivisht realizimin e planit të prokurimit në përmbushjen e kërkesave të njisisve kërkuese dhe realizimin tyre.

Të gjitha aktivitetet e Prokurimit janë realizuar bazuar në harmoni të plotë me kompetencat e Zyres së Prokurimit respektivisht Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotsuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim publik, Udhëzuesi nr. 001/2023 për Prokurim publik .

Në Raportin Vjetor të punës për periudhën 1 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2024, janë aktiviteti i zyrës së prokurimit lidhur me Raportimet , Procedimi i kërkesave të Drejtorive për Tenderimin dhe implementimin e Kontratave për Furnizime, Shërbime dhe Punë të realizuara gjatë vitit fiskal 2024.

Janë përgatit Raportet vjetore dhe janë përcjellë Raportimi për Kontratat e nënshkruara bazuar në Formularin standat të KRPP-së B53 .

Gjatë vitit fiskal 2024 janë zhvilluar proceduarat e prokurimit përmes sistemit e-prokurimi dhe janë publikuar respektivisht janë Kontraktuar 82 Kontrata për Furnizime, Shërbime dhe Punë në shumë prej 4,059,821.49€ ndersa vlera e planifikuar për keto Projekte ka qenë 4,901,480.30€.

Në bashkëpunim me Njisi të kërkuese respektivisht Drejtoritë janë publikuar 109 procedura të prokurimit prej tyre 82 kontrata janë lidhur 19 anulime 5 lëndë gjinden në OSHP si dhe 3 lëndë janë ende në procedurë bazuar në kërkesat dhe nevojave të njisisve kërkuese.

Bazuar në përgjegjësit dhe obligimet e Zyres së Prokurimit si dhe Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotsuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 respektivisht Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës janë dhënë qasje në kërkesat e Operatorëve ekonomik për qasje në dokumente publike ku kanë pasë qasje 13 Operatorë ekonomik dhe 3 qasje nga OJQ dhe institucione tjera.

Kerkesa për Rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues nga aktivitete të tenderimit kemi pasë 13 Kërkesa për Rishqyrtim prej të cilave janë Refuzuar prej të cilave vazhdu proceduarat repektivisht Ankesa në OSHP janë 5 Ankesa nga Operatoret ekonomik.

OSHP ka vendosë për 5 Ankesa të OE prej të cilave 4 është kthynë Rivlersim dhe 1 është Refuzu kerkesat e Operatoreve ekonomik respektivisht Vendimi i Autoritetit kontraktues ka mbetë në fuqi, dhe dy janë në proces të Vendimarrjes së OSHP-së.

Gjatë vitit 2024 stafi i Zyres së Prokurimit ka marrë pjesë në takime të Organizuara nga KRPP, Kolegjiumi i Prokurimit dhe IKP-i.

Bashkangjiteur Lista e Kontratave për vitin 2024.

KAPORIT VETËOR PËR KONTRATIN E NËNSHKRITURAS PËR NË

01.01.2024 - 31.12.2024

2024

#VALUE!

PLANSI I IDENTIFIKIMIT I AUTORITETEVE KONTRATUES

KOMUNA	
Qeveria	Kompani Publike
KA652	
Rruga "Agim Bajrami" p.m.	
71000	
0290 380 922	
Shekret Kodra	
Shkretet kodra@ksc.gov.al	
www.ksc.gov.al	

PIESËT E KONTRATIT E NËNSHKRITURAS PËR NË

Identi i Bazeve	Nr. Prokurimit	Lloji i prokurimit	Vlera e prokurimit	Procedura e prokurimit	Klasifikimi (2 shiftra e para te PPP)	Titulli i kategorisë së prokurimit	Data e informimit të aktivitetit të prokurimit	Data e publikimit të njoftimit për kontratë	Data e publikimit të njoftimit për afërsat të kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës (në rast anulimi data e gjatimit për anulim)	Afati për implementimin e kontratës (shkruaj datën e fillimit dhe të përfundimit)	Data e përfundimit të kontratës (data e pranimit të përkohshëm/preliminar)	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat e tj.	Çmimi i Aekës kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat e tj.	Zbritjet nga kontrata për shkak të ndryshimeve	Çmimi total i paguar për kontratën	Emri i OE të cilin i është dhënë kontrata	OE vendor (1) / Jo vendor (2)	Numri i rëkësive për DT dhe numri i ofertave të dorëzuara	Numri i ofertave të realizuara (shëruaj vetëm ato me emrin më të ulët në krahasim me ofruesin)	Afati kohor normal (1) Afati kohor i shkurtuar (2)	Çmimi më i ulët (1) Tendër ekonomikisht më i favorshëm (2)		
28.288.04	001	2	1	1	60	Shërbimet e transportit të pasivësve	07.12.2023	05.12.2023	28.03.2024	15.02.2024	15.02.2024	14.02.2025	€ 162,500.00	€ 12,000.00			€ 10,000.00	"RAIF SALIU B.I"	100	19.00	9	0	1	1	
1.2	001	2	1	1	60	Shërbimet e transportit të pasivësve	07.12.2023	05.12.2023	28.03.2024	15.02.2024	15.02.2024	14.02.2025	€ 5,280.00	€ 17,200.00			€ 4,094.00	"HALL SPAHIV B.I"	100	19.00	9	0	1	1	
1.2	001	2	1	1	60	Shërbimet e transportit të pasivësve	07.12.2023	05.12.2023	28.03.2024	15.02.2024	15.02.2024	14.02.2025	€ 17,200.00	€ 17,200.00			€ 13,780.00	"XHELAL SELIMI B.I"	100	19.00	9	0	1	1	
2	002	5	3	6	45	Mirëmbajtja dhe rregullimi i ndërqimit në mjetet sëdimese të ndërqimit autobusik	30.01.2024	02.02.2024	01.03.2024	04.05.2024	05.05.2024	23.04.2024	€ 9,900.00	€ 6,799.50			€ 6,799.50	"TONI INJINJERING" Shtp	100	21.00	5	0	1	1	
1.2	004	1	2	1	33	Furnizim me material mjedisor për laborator	12.01.2024	07.02.2024	13.02.2024	15.03.2024	15.03.2024	14.03.2026	€ 40,000.00	€ 49,450.00			€ 28,288.00	Shtp "BIO - LAB"	100	17.00	1	0	1	1	
2	005	5	2	1	45	Rregullimi i rrugës Bob - Kallia e Hasanit	25.01.2024	12.02.2024	10.06.2024	12.06.2024	17.06.2024	15.12.2025	€ 340,000.00	€ 327,172.01			€ 169,844.18	"EUROTRANS" Shtp	100	31.00	4	0	1	1	
2	006	5	2	1	45	Rregullimi i objektit këtu për veçitë tek bashkimi i dy lumenjesh	05.02.2024	13.02.2024	18.04.2024	04.07.2024	15.12.2025	05.07.2024	€ 75,000.00	€ 67,845.67			€ 6,778.11	"BDONA" Shtp	100	32.00	3	0	1	1	
2	007	5	3	6	45	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Rruga (Vardis Kontra)	20.02.2024	21.02.2024	12.03.2024	12.03.2024	12.03.2024	10.06.2024	€ 19,040.00	€ 19,040.00			€ 19,040.00	"GO "EUROTRANS" Shtp & "VIA EGNATIA" Shtp	100	1.00	1.00	1	0	1	1
2	008	1	2	1	1	Mirëmbajtja e fermereve në ndërqimit Bashkësi Proje	16.02.2024	21.02.2024	12.04.2024	22.04.2024	22.04.2024	28.05.2024	€ 21,000.00	€ 15,582.00			€ 15,582.00	"AGRI BAU" Shtp	100	19.00	2	0	1	1	
2	009	5	2	1	45	Rregullimi i ndërqimit Publi	14.02.2024	27.02.2024	23.04.2024	25.04.2024	30.06.2024	13.08.2024	€ 40,000.00	€ 39,323.35			€ 39,323.35	"PLUS TRADE" L.L.C	100	30.00	5	0	1	1	
2	010	1	4	7	36	Furnizimi me furnuaj Kombejar	01.01.2024	04.03.2024		06.03.2024	06.03.2024	11.03.2024	€ 990.00	€ 990.00			€ 990.00	"TE AKSA B" Shtp	100	3.00	1	0	1	1	
2	011	5	2	1	45	Ndërqimi i kalimit të SHFVQ "Agim Bajrami" Shirove	27.02.2024	04.03.2024	05.07.2024	04.07.2024	05.07.2024	05.08.2024	€ 30,000.00	€ 29,948.00			€ 29,948.00	NTSH "AR DRIT"	100	36.00	3	0	1	1	
014	5	2	1	45	Rrezeve të objektit e administrativës Komunale	06.02.2024	06.03.2024	02.05.2024	08.05.2024	09.08.2024	09.08.2024	09.08.2024	€ 17,200.00	€ 15,590.00			€ 15,590.00	NTSH "AR DRIT"	100	39.00	4	0	1	1	

Zyra Ligjore

Kam kënaqësinë të paraqes raportin përmbledhës të punës së Zyrës Ligjore të Komunës së Kaçanikut, konkretisht të Përfaqësuesit me autorizim të Komunës, për periudhën kohore janar-dhjetor 2024. Ky raport ofron një pasqyrë të hollësishme të aktiviteteve ligjore që janë zhvilluar gjatë këtij viti, duke përfshirë lëndët civile, penale, përbarimore dhe administrative që kanë qenë në trajtim nga Komuna e Kaçanikut. Gjatë këtij viti, përfaqësuesi-Zyra Ligjore ka pasur një angazhim të madh dhe ka luajtur një rol kyç në mbrojtjen e interesave të Komunës.

1. Aktivitete kryesore të realizuara

Në periudhën janar-dhjetor 2024, Zyra Ligjore ka qenë e angazhuar në shumë procedura gjyqësore, me qëllim mbrojtjen e të drejtave ligjore të Komunës së Kaçanikut. Gjatë këtij viti, janë mbajtur gjithsej **128 seanca të ndryshme gjyqësore** në gjykatat e Republikës së Kosovës. Këto seanca kanë përfshirë një gamë të gjerë çështjesh, të cilat kanë kërkuar vëmendje të theksuar dhe përpjekje të vazhdueshme për të siguruar një zgjidhje të drejtë.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm ka qenë **dhënia e 89 përgjigjeve në padi**, ku Zyra Ligjore ka trajtuar paditë që kanë ardhur gjatë këtij viti. Përgjigjet janë ofruar me qëllim të mbrojtjes së interesave të Komunës dhe për të garantuar që vendimet gjyqësore të jenë në përputhje me ligjin.

Po ashtu, janë **paraqitur 54 ankesa në Gjykatën e Apelit**, duke kërkuar rishikimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për këtë arsye, Zyra Ligjore ka vazhduar të angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar që çdo vendim që ndikon në të drejtat e Komunës të shqyrtohet dhe të rivlerësohet, në përputhje me parimet e drejtësisë.

Një tjetër aspekt që ka pasur një rëndësi të veçantë këtë vit kanë qenë **4 Revizionet në Gjykatën Supreme të Kosovës**, ku janë shqyrtuar çështje të ndryshme dhe me ndikim të gjerë për administratën komunale. Këto revizione kanë kërkuar një analizë të thellë të vendimeve të mëparshme dhe kanë pasur për qëllim sigurimin e një vendimmarrjeje të drejtë dhe të barabartë.

Po ashtu, janë realizuar **82 pajtime gjyqësore në Gjykatën Themelore në Ferizaj – Dega Kaçanik**, duke siguruar që lëndët të zgjidhen me marrëveshje dhe pa shkuar në faza të mëtejshme gjyqësore. Këto pajtime kanë kontribuar në kursimin e kohës dhe burimeve (financave).

Inspektorati Komunal

Spektori i Inspektoratit

Spektori i inspektoratit është organ i administratës, fushë - veprimtaria e së cilit është përcjellja, monitorimi dhe marrja e masave, përmes vendimeve dhe konkluzioneve

Inspektorati Komunal

Sektori i Inspektoratit

Sektori i inspektoratit është organ i administratës, fushë - veprimtaria e së cilit është përcjellja, monitorimi dhe marrja e masave, përmes vendimeve dhe konkluzioneve administrative, në funksion të mbikëqyrjes inspektuese, të fushave të rregulluara me ligje, akte nënligjore, vendime dhe urdhëresa në fuqi.

Sektori i inspektoratit vepron në kuadër të zyrës së kryetarit.

Sektori i inspektoratit në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisive të saj, ushtron aktivitetet e mbikëqyrjes inspektuese nga:

- Inspektori i Mjedisor,
- Inspektori i Tregut,
- Inspektori i Shërbimeve Publike,
- Inspektori i Komunikacionit,
- Inspektori i Ndërtimit.

Gjatë këtij viti, kemi pasur shumë sfida dhe të cilat kemi arritur t'i tejkalojmë në bashkëpunim të ndërsjellë me ekzekutivin e komunës, përfshirë kryetarin e komunës, nënkryetarin e komunës, drejtoritë komunale, policinë e Kosovës por edhe me palët e ndryshme në terren.

Gjatë këtij viti, kemi pasur inspektime të përbashkëta edhe me policinë e Kosovës, ku kemi bërë largimin e shitësve ambulant nëpër disa rrugë të qytetit, pastaj kemi bërë lirim të disa parkingjeve ilegale nëpër rrugë të qytetit, ku ne si inspektorat paraprakisht kemi bërë identifikimin e veturave të parkuara në kundërshtim me ligjin e trafikut. Njëkohësisht kemi bërë lirim të vend parkimeve të caktuara për taksi, por që nuk respektohet nga ngasësit e tjerë në komunikacion.

Inspektime kemi pasur ndaj operatorëve me autobusë, kombi taksi, auto taksi, inspektime në mosrespektimin e orarit të punës nga barnatoret farmaceutike, inspektime të çmimeve të artikujve të ndryshëm, inspektime për afat të skadimit – artikujve të ndryshme, inspektime në mbrojtjen e mjedisit – hedhja e mbeturinave, inspektime të ndërtimeve të objekteve pa leje komunale, ndërhyrje të ndryshme në infrastrukturë komunale pa leje paraprake nga organet komunale dhe probleme të ngjashme.

Sipas planit të paraparë të punës për vitin 2024, kemi arritur të kryejmë inspektime pas orarit të rregullt të punës (gjatë muajit të ramazanit) – inspektime pas iftarit.

Kemi pasur inspektime pothuajse të rregullta në orët e mbrëmjes në sezonin veror, pra në sezonin kur në pushime kemi mërgimtarët.

Kemi zbatuar planin vjetor të punës së sektorit të inspektoratit për vitin 2024, ku të parapara kanë qenë inspektimet jashtë orarit të rregullt të punës por edhe ditëve të pushimit.

Vlen të potencohet se policia e Kosovës na u kanë përgjigjur sa herë kemi kërkuar nga ta që të na asistojnë.

Njëherit ju njoftojmë se policia e Kosovës, përmes raporteve të oficerit na njofton për shkelje të ndryshme të rregulloreve komunale apo ligjeve tjera në fuqi, e ku pastaj inspektorë të lëmive përkatëse marrin veprime konkrete ndaj shkelësve të këtyre rregulloreve komunale apo ligjeve në fuqi.

Inspektori mjedisor

Përmes këtij raporti po ju njoftojmë, për punën dhe aktivitetet të cilat i kemi realizuar gjatë vitit 2024 në lëminë e mjedisit.

Me qëllim të përmirësimit dhe kontrollimit të gjendjes në fushën e mjedisit gjatë tërë vitit janë zhvilluar aktivitete të vazhdueshme si dhe ka vazhduar bashkëpunimi me institucionet tjera: Policinë e Kosovës, Inspektoratin e Mjedisit në MMPHI, Inspektoratin e Minerave në KPMM.

Ujërat

Për vitin 2024 nuk kemi pasur asnjë rast të eksploatimit ilegal të zhavorrit në lumenj dhe gjendja e lumenjve është nën kontroll.

Në bashkëpunim me Inspektoratin e MMPHI-së është bërë inspektimi i lokacionit të Guri i Shpuem në lumin Lepenc për shkak të krijimit të një deponie ilegale të mbeturinave.

Problematika kryesore e lumenjve mbetet shkarkimi i ujërave të zeza pa asnjë trajtim adekuat në lumin Lepenc dhe lumin Nerodime nga vendbanimet e komunës sonë dhe komunave fqinje.

Një problematikë tjetër është shfrytëzimi i resurseve ujore në mënyrë të pakontrolluar, kryesisht burimeve ujore për nevoja të amvisërisë në pjesën e maleve të Sharrit.

Mbeturinave

Komuna e Kaçanikut në vazhdimësi ka arritë të përmirësojë sistemin e grumbullimit të mbeturinave, aktualisht shërbimi i grumbullimit të mbeturinave i afrohet 90% e qytetarëve të komunës sonë.

Përkundër përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave një nga problematikat kryesore të menaxhimit të mbeturinave mbetet mos caktimi i një lokacioni për deponimin e mbeturinave inerte dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave.

Resurset natyrore

Komuna e Kaçanikut është mjaft e pasur me resurse natyrore e në veçanti me gurë gëlqeror. Në komunë tonë operojnë 10 operatorë të licencuar të cilët merren me shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit gëlqeror.

Licencat dhe kontrollin për shfrytëzimin e resurseve minerale e bën Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Inspektorati komunal në vazhdimësi kryen kontrollat të përbashkëta me Inspektoratin e KPMM-së në këtë fushë.

Pra, edhe ky sektorë është nën kontrollë dhe nuk kemi raste të shfrytëzimit ilegal të resurseve natyrore.

Zonat e mbrojtura

Komuna e Kaçanikut njihet për malet, lumenjtë, grykën e Kaçanikut dhe peizazhin e mrekullueshëm.

Janë te evidentuara dhe të mbrojtura 14 monumente natyrore: 09 prej të cilave janë monumente me karakter botanik, 02 monumente me karakter spelologjik, 02 monumente me karakter gjeomorfologjik si dhe 01 kompleks i pishave si peizazh i mbrojtur.

Kompleksi i pishave gjendet në zonën turistike të fshatit Strazhë dhe përfshinë një sipërfaqe prej 25 ha. Peisazhi ka vlera natyrore turistike, rekreative dhe estetike.

Sipas rekomandimeve të Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, komuna e Kaçanikut është e obliguar që të hartoj një plan menaxhues të peizazhit të mbrojtur si dhe të bëj rrethojën e saj.

Aktivitetet

Gjatë vitit 2024 inspektori mjedisor ka shqyrtuar 37 lëndë, ka hartuar 19 procesverbale dhe ka shqiptuar 03 gjoba mandatore në vlerë prej 1000€.

Aktivitete të tjera: inspektime të përbashkëta me inspektorët e lëmive të tjera, urdhëresa dhe vërejtje verbale për qytetarë për eliminimin e shkeljeve të ndryshme.

Sfidat

Puna dhe aktivitetet e inspektoratit komunal janë të ndërlidhura edhe me projektet, lejet apo pëlqimet që lëshohen nga komuna. Sfidat me të cilat është ballafaquar inspektorati si pasojë e aktiviteteve nga vet institucioni janë:

Pëlqimi për pastrimin e lumit Lepenc në gjatësi prej L=2860 m, i lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Kompleksi i pishave në Strazhë (peizazh i mbrojtur dhe zonë turistike) - komuna e Kaçanikut ka zbatuar një projekt në këtë zonë, që përfshinë ndërtimin e terreneve sportive, këndit të lodrave, vendeve për rekreacion, stazat e ecjes.

Mirëpo për zbatimin e këtij projekti në teren nuk është pajisur me leje konform legjislacionit në fuqi si dhe Vendimit për Mbrojtjen e Vlerës së Natyrës Kompleksi i Pishave në fshatin Strazhë si peizazh i mbrojtur 01Nr. 16-9661/16 i datës 29.04.2016.

Deponitë e mbeturinave – Inspektorati komunal ka identifikuar lokacione në territorin e komunës së Kaçanikut, ku si pasojë e hedhjes së materialeve inerte nga implementimi i projekteve të ndryshme nga vet komuna e Kaçanikut, janë krijuar deponi ilegale të mbeturinave.

Këto deponi kryesisht janë krijuar gjatë rikonstruimit të rrugëve dhe të objekteve të ndryshme.

Rekomandimet:

Duke e analizuar gjendjen e mjedisit në komunën e Kaçanikut është e nevojshme të ndërmerren këto hapa:

- Komuna e Kaçanikut të pajiset me leje mjedisore për çdo projekt i cili ka ndikim në mjedis. Komuna të pajiset me leje për çdo projekt që sipas legjislacionit në fuqi duhet ti nënshtrohet lejeve mjedisore, lejeve komunale mjedisore, lejeve ujore apo vlerësimit të ndikimit në mjedis, ngase realizmi i projekteve të caktuara ndikon në ndotjen dhe degradimin e mjedisit.
- Të trajtohet me prioritet caktimi i lokacionit për deponimin e mbeturinave inerte, ngase si pasojë e mos caktimit të këtij lokacioni po krijohen deponi ilegale. Shpeshherë krijimit të këtyre deponive ilegale i kontribuon edhe vet komuna si institucion gjatë realizmit të projekteve të ndryshme.
- Largimi i mbeturinave ilegale të mbeturinave të bëhet në bashkëpunim me Inspektoratin Mjedisor, të jemi të informuar se cilat deponi ilegale të mbeturinave janë larguar brenda vitit.
- Drejtoritë komunale të hartojnë planet komunale të cilat dalin si obligim nga legjislacioni mjedisor.

Inspektori i Tregut

Përmes kësaj shkrese ua dërgojmë raportin e punës së Inspektorit të tregut për 2024

- Gjoba mandatore11
- Shuma e gjobave mandatore 2100€
- Inspektime për parandalimin e ekonomisë jo formale 118
- Pranime teknike 3
- Aktvendime 11
- Urdhëresa72
- Njoftim dhe shkresa zyrtare.....4
- Intervenime rreth vendosjes së orarit të punës dhe

mbishkrimit të firmës35

- Plan operativ për mibkqyrjen e respektimit të kujdestarisë së natës nga Barnatoret Farmaceutike;

- Inspektim gjatë natës,

- Plani Operativ lidhur me transportin e mallrave pa dokumente,

- Inspektimet janë kryer së bashku edhe me Policinë e Kosovës,

- Inspektim i subjekteve të cilat veprojnë me karburante lidhur me licencat për gaz dhe karburant si dhe dokumentacionet tjera.
- Inspektim rreth zbatimit të ligjit për duhan .

Largimi duhanit nga shitja në vende të ekspozuara,

Largimi i të gjitha produkteve ushqimore dhe jo ushqimore të ngjajshme me duhanin,

- Inspektimi i vendosjes së deklaracionit të artikujve ushqimorë,
- Largimi i shitësve ambulant,
- Kontrollimi i të gjitha furrave të bukës në Komunën e Kaçanikut si dhe matja e peshës së bukës,
- Kontrollimi i vendosjes së çmimeve për artikujt ushqimor,
- Kontrollimi i cilsisë së mallit me Inspektorin sanitar dhe konfiskimi i mallit.

Inspektori i Shërbimeve Publike

- Ka kryer inspektime nga më të ndryshmet, duke filluar nga:
- Largimi i shitësve ambulant të cilët mallin e tyre e ekspozojnë nëpër hapësira të ndaluara,
- Largimin e reklamave të vendosura nëpër hapësira publike nga qytetarët, pa pëlqim paraprak nga organet komunale.
- Largimin e barrierave – pengesave nëpër rrugë të vendosura pa leje komunale,
- Largimin e një objekti montazhë të vendosur pa leje në një hapësirë publike - në hyrje të fshatit Duraj – pronë komunale,
- Ka bërë largimin e rrethojave metalike që ishin vendosur pa leje komunale, afër objektit të shkollës fillore të fshatit Koxhaj. Me këtë rast janë marr policia e Kosovës dhe prokuroria e shtetit.
- Ka intervenuar në kompanitë transportuese të cilat gjatë bartjes me cisterna të betonit, shpesh ka ndodhur që të bie betoni nga mbushja e tepërt e cisternës dhe të bie nëpër rrugë të asfaltuara.
- Kemi bërë një shkresë zyrtare për kompaninë punëkryese sipas projektit të ndërtimit të hekurudhave të Kosovës – “Informatë në lidhje me dëmtimet në infrastrukturën rrugore, të shkaktuara nga punimet në hekurudhat e Kosovës”. Përmes kësaj shkrese është njoftuar

punëkryesi – një kompani italiane e cila është duke kryer punimet sipas projektit nacional të ndërtimit të hekurudhës dhe e cila ka bërë:

Dëmtimin e rrugës së fshatit Runjevë, e cila është asfaltuar me kontributin e banorëve të fshatit Runjevë, dëmtimin e rrugëve të asfaltuara – projekte të realizuara nga ana e komunës së Kaçanikut, dëmtimin e shenjave të komunikacionit, dëmtimin e rrjetit të kanalizimit dhe ndërhyrjen - mbushjen e pronave bujqësore pa lejen e pronarëve. Nga kompania kemi kërkuar që të na siguroj një marrëveshje apo kontratë me shkrim apo të na njoftoj zyrtarisht se pas përfundimit të këtij projekti të gjitha dëmet e shkaktuara nga punë kryesi do të sanohen po nga ky punë kryes. Në të kundërtën ne si organe komunale jemi të obliguar të ndjekim rrugët ligjore, me qëllim që pasojat mos t'i bartë komuniteti apo institucionet komunale të Kaçanikut por vet punë kryesi, i kontraktuar nga hekurudha e Kosovës.

Përfaqësuesi i kësaj kompanie përmes adresës zyrtare njofton se ka pranuar shkresën e inspeksionit dhe do të jetë objekt studimi për planifikimin e ndërhyrjeve – restauruese të rrugëve.

- Inspektori i shërbimeve publike në bashkëpunim me inspektorë tjerë dhe në asistim të policisë së Kosovës – Stacioni Policor në Kaçanik, ka bërë zbatimin e planit për inspektime, i hartuar nga sektori i inspektoratit.

Inspektori i Komunikacionit

Gjatë vitit 2024 janë kryer 105 inspektime të vazhdueshme në transportin Publik të Udhëtarëve, në lëminë e komunikacionit rrugor dhe 29 inspektime të përbashkëta me inspektorët komunal të lëmvive të ndryshme si dhe kemi kryer punë tjera shtesë të angazhuara me vendime.

Në lëmin e transportit Publik të udhëtarëve kemi 19 procesverbale të ndryshme, prej tyre:

- 02 – procesverbale me vërejtje për ndërprerjen e veprimtarisë pa Leje Pune - e kryer,
- 02 – procesverbale – urdhëresë për vazhdimin e Lejes së Punës – e kryer,
- 07 – procesverbale – urdhëresë për kryerjen e kontrollës teknike periodike, çertifikatë të mjekut - e kryer,
- 06 – procesverbale – urdhëresë për plotësim dokumenteve, çmimoreve dhe fletë urdhëresën e rrugës, aparatit për fikjen e zjarrit – të kryera,
- 02 – procesverbale – për eliminimin e mbingarkesës – e kryer
- 06 – vërejtje verbale për kryerjen e kontrollimit teknik periodik, çertifikata të mjekut, vazhdim të lejes së punës – të kryera,
- 04 – gjoba mandatorë me aktvendim - të kryera.

Inspektori i komunikacionit ka pranuar dy raporte mujore nga stacioni i autobusëve në Kaçanik rreth operimit të operatorëve të Transportit Publik të udhëtarëve.

Në lëmin e Komunikacionit rrugor - Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal kemi 02 procesverbale:

- 01 – procesverbal për dëmtim të rrugës – e kryer
- 01 – procesverbal për ndërhyrje në shenjat e komunikacionit – e kryer,
- 01 – largimin e dy pengesave (policë të shtrirë) në rrugë pa leje komunale - e kryer,

Vendosja - futja në databazë e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit, të dëmtuara në teren.

Të pranuar një raport nga Policia e Kosovës, për vendosjen e pengesave në rrugë, për të cilën inspektori i komunikacionit jep një përgjigje me shkrim.

Inspektori i komunikacionit ka bërë një kërkesë zyrtare - zyrës së prokurimit publik, që gjatë dhënies së kontratave (kompanive fituese), të vendos kriter që gjatë punimeve në rrugë të merren masat dhe të vendosen shenjat adekuate. Në të kundërtën ne si inspeksion jemi të obliguar të marrim masa ndaj këtyre kompanive punëkryese.

Ka bërë shtatë (07) kërkesa DESHP-së, për rregullimin e shenjave të komunikacionit, ku prej tyre janë identifikuar 42 shenja të dëmtuar.

Ka bërë një (01) kërkesë për vendosje të pengesave në rrugë (policë të shtrirë).

Komision komunal për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të palëve nga lëmia e komunikacionit, ku prej tyre kemi shqyrtuar një kërkesë dhe kemi dhënë rekomandim.

Ka pranuar dy (02) ankesa, prej të cilës i ka dhënë përgjigje me shkrim,

Ka pranuar katër (04) kërkesa, prej të cilave i ka dhënë përgjigje me shkrim,

Ka dhënë dy (02) përgjigje për pengesa në rrugë (Policë të shtrirë),

Ka lëshuar dy (02) Pëlqime për pengesa në rrugë (Policë të shtrirë).

Punë tjera:

Komision në angazhimin e punës për Performancë komunale, për fushën e Transportit publik të Udhëtarëve dhe fushën e Parkingjeve Publike, ku kemi pasur edhe takime me koordinatoren dhe përfaqësuesin e DEMOS-it, me temë diskutimi vështirësitë dhe sfidat në raportim.

Komision në Planin Komunal për Transport Lokal Publik të Udhëtarëve,

Ka asistuar edhe te inspektorët e lëmive tjera, si te inspektori i Shërbimeve Publike – 10 asistime, inspektori i Ndërtimit – 08 asistime, inspektori i Tregut – 04 asistime, inspektori Mjedisor – 02 asistime dhe inspektori i Pylltarisë - 05 asistime.

Trajnim – seminar të organizuar nga Zyra e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe GIZ me temat: 1. Përmbajtja e Procesverbalit të Inspektimit dhe 2. Reformat Inspektuese dhe Metodologjia e bazuar në rrezik.

Takim me përfaqësuesin e firmës të punimeve në hekurudhë Xhusepe Muraca (italian) me temë diskutimi – dëmtimi i rrugëve gjatë punimeve, zhytja me baltë e rrugëve dhe siguria në komunikacion.

Takim me drejtorët e DESHP-së ndërmjet komunës Kaçanik dhe Ferizaj lidhur me mundësinë e marrëveshjes për Transport Rrugor në linjat Ferizaj - Bajnicë dhe Ferizaj - Rakaj – Duraj.

Inspektori i Ndërtimit

Përmes këtij raporti vjetor, paraqitet puna e inspektorit të ndërtimit, ku gjatë këtij viti kemi pasur sfida të ndryshme e që kemi arritur t'i përfundojmë me sukses.

Bazuar në autorizimet ligjore, inspektori i ndërtimit ka marrë të gjitha masat e duhura për pengimin e ndërtimeve pa leje në teritorin e Kaçanikut, kontrollimin e të gjitha objekteve të pajisura me leje ndërtimore, materialit ndërtimorë, kushteve ndërtimore, dokumentacionit teknik të objekteve si dhe mbrojtja e shëndetit publik me rastin e kryerjes së punëve ndërtimore.

Të gjitha kërkesat e parashtruara pranë zyrës së inspektorit të ndërtimit, janë kryer në afatin ligjor dhe sipas detyrës zyrtare.

Janë kryer kontrollime të objekteve ndërtimore, në bazë të kërkesave të investitorëve, me qëllim të kontrollimit të armaturës dhe betonit si dhe produkteve ndërtimore ku iu është urdhëruar edhe marrja e mostrave të betonit, respektimi në përgjithësi i projektit dhe mbajtja me rregull e librit dhe ditarit ndërtimorë si dhe rrethimi i vendpunishtes.

Kemi pasur raste të ndërprerjeve të punimeve pa leje paraprake nga organet komunale.

Njëkohësisht nëpër këto objekteve kemi bërë vendosjen e shiritave dhe shenjave me të cilat i kemi ndaluar punimet pa leje paraprake.

Kemi pasur disa intervenime për ndërprerje të punimeve pa leje ndërtimi:

Në fshatin Strazhë në një parcelë pronë publike është ndërtuar një shtëpi malore – vilë pa leje (rast recidivist), gjë që nga inspektori i ndërtimit rezulton me ndërprerje të punimeve, me dërgim të lëndës në gjykatë dhe gjykata pos shqiptimit të gjobës ndaj uzurpatorit merr vendimin edhe për lirimin e kësaj hapësire nga uzurpatori. Për të zbatuar vendimin e gjykatës, inspeksioni ka dhënë disa njoftime, urdhëresa dhe afate për largimin e objektit vilë malore, por pala nuk ka zbatuar shkresat e tilla.

Andaj jemi detyruar që me asistim të policisë së Kosovës, të bëjmë lirimin e kësaj hapësire publike, ku pala në prezencë të inspektoratit dhe policisë së Kosovës ia hudhi flakën këtij objektit vilë malore dhe e dogji të tërësi, ku nga ana e zjarrfikësve u lokalizua zjarri.

Materiali i mbetur, rrethojat - telat me gjemba janë larguar dhe i gjithë materiali ndërtimor i djegur është larguar nga kompania e angazhuar, me qëllim të liritimit të kësaj hapësire publike dhe e cila hapësirë është liruar në tërësi.

Tani me këto hapësira publike menaxhon Agjensioni i Pyjeve të Kosovës (APK) dhe kompetencat për menaxhim i ka Agjensioni i Pyjeve të Kosovës.

Inspektori i ndërtimit ka bërë ndërprerjen e 07 objekteve malore – vilave pa leje ndërtimi.

Ka marr të gjitha masat me kohë deri në dërgim të lëndëve në prokurorinë e shtetit.

Kemi pasur vizita dhe konsultime të vazhdueshme me inspektorë të ndërtimit nga niveli qendror, ku shpesh ka marr edhe rekomandime dhe ndihmë nga inspektorët e nivelit qendror se si veprohet në raste të ndryshme.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer gjithsej 37 inspektime dhe 10 inspektime me inspektorët tjerë.

- Janë përpiluar 19 procesverbale me urdhëresa për ndërprerje të punimeve dhe kontrollave sistematike të punëve.
- Kemi pranuar 05 ankesa, të cilat i kemi trajtuar menjëherë dhe kemi marr masat e nevojshme me qëllim të zgjidhjes së problemeve.
- Janë shqiptuar gjoba në total 500 euro për mos informim dhe punim pa leje ndërtimi, të cilat janë paguar në afatin prej 7 ditësh dhe janë konfirmuar me flet pagesë nga pala.
- Kemi zbatuar një vendim të gjykatës për rrënim të një objekti villë nga druri pa leje ndërtimi.
- Një rast të ndërprerjes së punës me asistim të policisë për shkak të mos bindjes së urdhërave të inspektoratit.
- Dy kallëzime penale për arsye se palët kanë vazhduar punimet edhe pas ndërprerjes së punëve me shirit për punët e bëra pa leje ndërtimi, ku të njëjtit paraprakisht i është shqiptuar gjoba dhe i janë dhënë afate kohore për tu pajisur me leje ndërtimi.

Rekomandim: Që drejtoria e urbanizmit të respektoj ligjin e ndërtimit në lëshimin e vendimeve të lejeve të ndërtimit të cilat duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe shkresat të

Njësia për të Drejta të Njeriut
- Zyrtari për barazi gjinore-

2024

Raporti vjetor

**Raporti vjetor mbi punën nga Njësia për të Drejtat e Njeriut, dhe
Zyrtari për barazi gjinore viti - 2024**

Objektivi	Aktiviteti	Përgjegjës dhe merkatues	Alat	Bashkimi	Sfondi e parashikuara	Rezultatet
Monitorimi i mbledhjeve të K.K.K, si dhe komiteteve të cilat funksionojnë në komunën tonë.	a) monitorimi – përcjellja e punës dhe aktiviteve të (seancave të kuvendit dhe komiteteve të cilat veprojn) e cila duhet të jetë në harmoni me ligjet vendore dhe ndërkombtare .	<ul style="list-style-type: none"> NJDNJ Z.B.GJ 	JANAR DHJETOR	%	i. përpunimi e tyre me standardet evropiane ndërkombtare dhe vendore (vendimet)	I. respektimi i standarteve ndërkombtare dhe vendore (ligjit)
Përcjellja e intervistave gjat pranimit të punëtorëve në pergjithsi të shërbysve civil dhe në arsim.	Monitorimi gjatë intervistimit të kandidatave të gjitha intervistave të cilat janë mbajtur .	K.K. Kaçanik D.A. NJDNJ	JANAR DHJETOR	%	Serioziteti në pun nga K.K.K.- D A, NJDNJ Respektimi i barazisë gjinore rregullorës së punës , dhe kushteve të parapara me konkurs.	Respektimi i kriterëve dhe kushteve të parapara me konkurs , dhe profesionalizimi i zyrtarëve të përgjendhur
Takime të rregullta mujore me avokatine popullit- zyrtarin e tij	Shqyrtimi i ankesave të qytetareve, nuk ka pasur ndonjë ankesë.	NJ.D.NJ AVOKATI I POPULLIT	JANAR DHJETOR	%	Marraj në shqyrtim	Zgjidhja e tyre përmes zyrës së avokatit të popullit .
takimet të ndryshme me institucionet tona dhe (ojq) vendore dhe ndërkombtare.	Mbledhje , seminare trajnime, tryeza te rrumbullakta .	K.K.K, NJDNJ OJQ vendore dhe ndërkombtare dhe institucioet tjera relevante.	JANAR DHJETOR	%	Aftesimi dhe bashkpunimi ndërinstitucional, etj	Bashkpunimi i ndërsjell instucional ngritja e kapaciteteve etj.
Takim me kforin LMT	Diskutime rreth infrastruktures ligjore dhe lirive te drejtave te njeriut	KFOR- LMT NJDNJ	DHJETOR			Bashkpunim i mir shkëmbim i përvojave

Zyrtari për barazi gjinore

Objektivi	Aktiviteti	Përgjegjës dhe përkatësi	Afati	Ecurshmi	Rezultatet
Takim me grupin e Grave Asambleiste të Komunës	Tryeze e rrumbullakët te takime me temën – formimi i GGA – hartimi i planit te veprimit dhe fushata vetdiesore kunder dhunes ne familje .	ZBGJ GGA	<i>Shtator – Nëntor</i>		Diskutimet e ndryshme si dhe mundesia e hartimit të nje plani të veprimit.
Shënimi i ditës së 8 marsit ditës ndërekombtare të gruas	5 ditë aktivizem nëpër të gjitha shkollat e komunes sonë ligjerata me temën - Roli i gruas në shoqeritn Kosovare dhe sfidat e saj.	ZBGJ DA	Mars		Vetëdisimi i nxensave , Njohurit mbi aspektin gjinor, bashkpunimi i mir instucional , etj
Pjesmarjia në grupin e performancës së Komunës .	Mbledhja e te dhemave , përpunimi i tyre nga aspekti gjinor për raportim të vittit paraprak	Z.BGJ	Janar Maj		Bashkpunimi i mir nderinstucional .
Mekanizmi kunder dhunës në familje.	4 – Takime me te gjitha instucionet e Komunës për formimin e mekanizmit në Komunën ton .	ZBGJ dhe gjitha instucionet që veprojn në Komunën ton.	Qershor Gusht		Perfshirja e te gjitha instucioneve te cilat veprojn në Komunën ton, dhe krijimi i mekanizmit kunder dhunës në familje.
Krijimi i mekanizmit dhe hartimi i planit tre vjeqar Kunder dhunës në familje.	Punëtorja dy ditore dhe hartimi i planit te mekanizmit	ZBGJ – OSBE si dhe të gjithë akterët e mekanizmit.	Gusht	260 €	Hartimi i planit trevjeqar duke u bazura ne strategjin kombtare kunder dhunes ne familje si Konventa e Stambollit.
Fushata - Trafikimi me qenje njerzore.	2 - ligjerat me nxënsit në shkollës Emin Duraku 2 – ligjerata me nxensit e shkollës se meseme profesionale –Feriz Guri & Vllezrit Çaka.	ZBGJ – DA	Tetor		Vetëdisimi i nxënsave , intresimi i tyre etj.
Edukimi i grave te reja mbi feminizmin në Kaçanik .	Diskutime, kuiz, mbi jeten partiarkale dhe sfidat e saj si dhe ndryshimet , dhe ngritja e saj ne shoqeri ,	ZBG- DKRS- ATROPOLIS- si dhe Qendra Rinore- Shtëpia e	Nëntor		Pjesmarjia e madhe , ndarja e pervojeve dhe perfitimi i njohurive te reja .

<p>15 ditë aktivizem kundër dhunës në familje .</p>	<p>15 ditë ka qenë në shërbimin digjital në hyrje dhe dalje të qytetit - fushata me moton raportoj dhunën - dhuna është krim raportoj mos hesht – raportoj në 092 Në të gjitha xhamitë e komunës sonë është mbajtur ligjërata me temën – dhuna familjare nga imamët e të gjitha xhamive të komunës sonë Defilimi nëpër qytet me grupin e grave asambleiste dhe shoqërinë civile .</p>	<p>Shpreses ZBGJ KBI – Në Kaçanik GGA</p>	<p>Nëtor Dhjetor</p>	<p>Realizimi i kesaj fushate .</p>	<p>Njoftimi i qytetrave Bashkpunimi i mir me bashkësinë Islame Grupin e grave asambleiste etj.</p>
---	---	--	---------------------------	------------------------------------	--

Drejtoria e Administrates

Një nga synimet kryesore të administratës komunale është arritja e efikasitetit në të gjitha nivelet. Institucionet publike janë përgjegjëse për të siguruar të mirat dhe shërbimet e nevojshme publike për qytetarët pa asnjë diskriminim. Prandaj, objektivat shumë dimensionale të administratës komunale kërkojnë që performanca jo vetëm të jetë e kufizuar në ofrimin e shërbimeve, por gjithashtu të përfshijë elementin thelbësor të sigurimit të vlerave llogaridhënese për qytetarët.

Në kohën bashkëkohore, pikëpamjet e duhura se si duhet të funksionoj administrata komunale orientohen kryesisht në përparimin në teknologji që pritet të ketë ndikim të jashtëzakonshëm në evolucionin e ofrimit të shërbimeve si një fushë dinamike e së ardhmes.

Drejtoria e Administratës është tradicionalisht e angazhuar në arritjen e efikasitetit në punën e dikastereve të saj, me theks të veçantë në ofrimin e shërbimeve. Prandaj, efikasiteti gjen një vend të përhershëm në planin dhe programin qeverisjes lokale. Efikasiteti dhe eficienca merr një vemendje të rëndësishme kur përpiqemi ta aplikojmë atë në një sistem që bazohet në shumë vlera, profesionalizëm e transparencë të zyrtarëve të angazhuar publik. Dimensioni i transparencës i jep një perspektivë unike efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.

Drejtoria e Administratës përkushtimin e saj e bazon në tri shtylla: efikasitet, performancë, transparencë. Këto mekanizma janë instaluar dhe vazhdojnë të përkrahen nëpërmjet investimeve kapitale në vazhdimësi. Investime këto kryesisht në teknologji, infrastrukturë të objektit dhe investime tjera të rëndësishme. Mbi këto parime, DAP ka ushtruar funksionin e saj statutor dhe në këtë raport shfaqet puna 6 mujorshe e kësaj drejtorie bashkë me sektorët e saj sipas organogramit.

1. Qendra Komunale për Shërbime me Qytetar

Njëra ndër sektorët më vital për funksionimin e duhur të institucionit lokal është Qendra për Shërbime me Qytetar.

Zyrtarët e Qendrës për Shërbim me qytetar kanë qenë mjaft efektiv në realizimin e detyrave të tyre të punës . Ata kanë bërë pranimin e të gjitha lëndëve si nga brenda dhe jashtë institucionit, të njëjtat janë regjistruar , protokoluar dhe shpërndarë në sektorët përkatës.

Më poshtë mund të shihni tabelën e detajuar të lëndëve :

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Perfunduar	Totali
DAP	Drejtorja e Administratës së Përgjithshme	6	68	2,030	6	0	0	0	4	17,871	19,985
DA	Drejtorja e Arsimit	7	28	1,349	67	2	14	2	26	0	1,495
DBZHRP	Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë	1	11	367	128	2	0	0	104	0	612
DBF	Drejtorja e Buxhetit dhe Financave	1	13	1,157	1	0	0	0	3	0	1,175
DSHMS	Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	5	18	373	79	0	7	0	2	0	484
DESHP	Drejtorja e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike	11	3	528	38	0	0	0	8	0	588
DUKMM	Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	46	3,873	1,327	2	0	2	0	12	0	5,262
SHK	Shërbimi i Kryetarit	42	452	2,072	367	6	0	3	7	0	2,949
DKRS	Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	3	77	0	0	0	0	0	1	0	81
DZHET	Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	1	0	79	4	0	0	1	0	0	85
		123	4,543	9,282	692	10	23	6	167	17,871	32,717

Tab. 1. Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes prej 01.01.2024 – 31.12.2024

2. Zyra Komunale e Gjendjes Civile

Zyra Komunale e Gjendjes Civile ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e saja në bazë të autorizimeve ligjore si në vijim:

Përshkrimi

	Copë
Ekstrakte të Lindjes	14261
Certifikata të Lindjes	4963
Certifikata e Martesës	2741
Certifikata e Vdekjes	1058
Certifikata e Gjendjes Martesore	323
Deklarata Familjare	2776
Certifikata e Vendbanimit	1820
Certifikata e Shtetësisë	184
Vërtetime të Arkivit	522
Dëshmi Vdekje	322
Totali:	28 970

Tab. 2. Numri i certifikatave të lëshuara nga data 01.01.2024- 31.12.2024

Përshkrimi

	Copë
Regjistrime të Lindjes të Rregullta	07
Regjistrime të Lindjes të Veçanta	371
Shpallje të martesave	285
Kurorëzime	285
Regjistrime të kurorëzimeve nga jashtë	78
Regjistrime të vdekjes të rregullta	109
Regjistrime të vdekjeve nga jashtë	156
Lëndë të kompletuara për fitim të shtetësisë	131
Lëndë të kompletuara për humbje të shtetësisë	27

Tab. 3. Numri i akteve të lëshuara nga data 01.01.2024- 31.12.2024.

Në kuadër të punës të ZKGJC janë përgatitur statistikat mujore dhe janë dërguar me kohë në Agjencionin e Statistikave të Kosovës si dhe të gjitha gabimet për përmirësim janë dërguar me kohë në ARC.

Tash së fundmi është duke u implementuar projekti për rregullimin e adresave nga AKK dhe ARC, punë efektive po bëjnë edhe zyrtaret e gjendjes civile të cilët janë ngarkuar me këtë detyrë.

Janë mbajtur takime në lidhje me problemet dhe vështirësitë e ndryshme që përcjellin punën e përditshme të kësaj zyre.

Jemi kujdesur për funksionimin e rregullt të e-kisokut dhe furnizimin me kohë me certifikata, kemi miratuar me kohë lëndët në internet për sektorin e Gjendjes Civile.

Gjithashtu janë vizituar herë pas here edhe zyret e gjendjes civile të cilat operojn në terrenin e komunës sonë.

3. Arkivi komunal

Hartimin e planit të punës për sektorin e arkivit për vitin 2025;

Hartimin e raportit vjetor të punës për sektorin e arkivit për vitin 2024;

1.PUNËT NË ZYRE

-Sektori Arkivit ka punuar dhe rregulluar të gjitha proceset e punës dokumentacionin punimin, klasifikimin, sistemimin, regjistrimin e lëndës arkivore duke krijuar data bazën e dokumentacioneve me vlerë të përhershëm, si dhe me afate tjera.

Punimin e librave arkivor.

Nga sektori i gjendjes civile kemi pranuar regjistrimet, të rregullta, speciale të lindjes, martesave dhe të vdekjes prej viti 2014-2018, aktgjykimet e shkurorëzimeve për persona mbi 18 vjet, vendime për rifitimin e shtetësisë, anulime 2018-22, gjithsej 151 kutia, si dhe 11 libra të protokollit. Gjithashtu kemi bërë asgjësimin e kërkesave të gjendjes civile prej vitit 2017-2022.

Nga zyra e DUKMM-së kemi pranuar disa prej projekteve shoqërore 2013-2022.

Nga kuvendi kemi pranuar gjithë materialin në formë libri 2001-2013 gjithsej 59 copë.

2.PUNË NË DEPO

-Hulumtimi për gjetja e lëndëve arkivore sipas kërkesave të zyrtarëve komunal dhe palëve, bartja e lëndëve nga depo për të i shërbyer palëve si dhe për të i punuar në zyrë dhe anasjelltas duke i vendosur në vendet përkatëse.

3. KËRKESA INTERNE

- Prej zyrtarëve të drejtorive të komunës janë parashtruar 70 kërkesa gojore për gjetjen e lëndëve dhe projekteve të ndryshme arkivore, të njëjtat janë kthyer dhe vendosur në vendin përkatës. Gjithashtu janë parashtruar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve- Divizioni i Pensioneve të Jashtme 12 kërkesa për verifikimin e vërtetimeve lëshuar nga Sektori Arkivit Komunal.

4. KËRKESA TË PARASHTRUARA NGA PALËT – 114 kërkesa nga këto, 19 kanë qenë për stazh pune, 3 kanë qenë për vërtetim dhe konfirmim të dokumenteve.

-Palëve të interesuara ju kemi dhënë udhëzime profesionale komfor ligjit për Arkivat dhe Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Nga grupi punues komunal është bërë Hartimi i Listes së Shenjave Unike të

Klasifikimit të Dokumenteve dhe Afatet e ruajtjes së tyre për komunën e Kaçanikut ,

ndërsa e njëjta ka marr pëlqimin për implementim nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës.

4. Mirëmbajtja e objektit dhe autoparku

DAP nëpërmjet sektorit teknik, është përkujdesur për higjienën, pastërtinë e objektit të administratës komunale, mirëmbajtjen e nxemjes, mirëmbajtjen e aseteve etj.

Veturat zyrtare kanë qenë në gjendje të rregullt ,të regjistruara , servisuara dhe furnizuara me derivate, si dhe në dispozicion për të gjithë zyrtarët publik përgjatë periudhës për të cilin raportojm.

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme gjithashtu ka inicuar kërkesa të ndryshme për zhvillimin dhe arritjen e objektivave të drejtorisë :

1. Kërkesa për vendosjen dhe mirëmbajtjen e GPS-ve në veturat e administratës komunale.
2. Kërkesa për shërbime të byfes.
3. Kërkesa për shërbime të sigurimit fizik të objekteve të administrates komunale.
4. Kërkesa për furnizim me material higjenik për objektin e administrates komunale.
5. Kërkesa për furnizim me dru zjarri për objektin e administrates komunale.
6. Kërkesa për furnizim me pajisje teknologjike për zyrtaret .
7. Kërkesa për furnizim me material për zyre.
8. Kërkesa për regjistrim dhe sigurim te veturave zyrtare të administrates komunale.
9. Kërkesa për mirëmbajtje dhe servisim të veturave zyrtare.
10. Kërkesa për mirëmbajtje të objektit të administrates komunale etj.

Gjithashtu gjatë vitit që lamë pas kemi realizuar projektin "Renovimi i tualeteve në objektin e administratës komunale".

Është duke u realizuar projekti EU for ALL , projekt i financuar nga BE për ofrimin e qasjes më të lehtë në objektin e administratës komunale për personat me aftësi të kufizuara.

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme është kujdesur edhe për pranimin dhe procesimin e të gjitha faturave të institucionit po ashtu edhe për sistemin e e-pasurisë dhe përditësimin e të dhënave në këtë sistem.

Është kujdesur edhe për Kutin e Ankesave , hapjen e saj dhe raportimin e rregullt nga komisioni për hapjen e kutisë së ankesave.

Përmes zyrtares për përkthime janë përkthyer të gjitha dokumentet e kërkuara duke respektuar ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare të Kosovës.

Si drejtori u kujdesem edhe për shpalljet e ndryshme si në tabelën e shpalljeve fizike dhe atë elektronike, si dhe pranimin dhe shpërndarjen e postës .

Drejtoria e Shëndetësisë

RAPORTI VJETOR PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2024

Ky është raport përmbledhës i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i cili ka për qëllim raportimin të kryetari i komunës lidhur me ecurinë e punëve të kësaj drejtorie , si dhe informimin e qytetarëve të komunës së Kaçanikut për mbarëvajtjen e punëve të DSHMS-së , për periudhën Janar – Dhjetor 2024.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSIË FAMILJARE

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare punon 24 orë, që nënkupton se stafi shëndetësor punojnë në tre ndërrime gjatë javës dhe të shtunave e të dielave. Stafi i QKMF-së kujdesen për shëndetin dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve të komunës sonë.

Në QKMF funksionojnë Këshilli Drejtues i QKMF-së dhe Këshilli Profesional të cilët janë në përbërje nga stafi shëndetësorë, kryesuar nga Drejtori i QKMF-së. Këto Këshilla mbajnë takime të rregullta në çdo muaj, në të cilat diskutohen çështje të ndryshme profesionale si dhe çështje organizative për funksionim të mirë të punës së QKMF-së.

Në QKMF funksionon edhe klasa për nëna dhe fëmijë, e cila mbanë ligjërata rregullisht për të gjitha grat e interesuara. Kontribut të madh në këto ligjërata japin specialistja e gjinekologjisë dhe specialistja e pediatriisë.

Gjithashtu edhe vizita shtëpiake për të sëmurët në stadin terminal të kancerit, si dhe të sëmurët e palëvizshëm ,si dhe vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç janë realizuar gjatë vitit 2024.

QKMF është furnizuar me insulinë, si dhe me terapi tabletare për sëmundjen e sheqerit, për hipertension ,për yndyrë. Po ashtu edhe me material shpenzues mjekësor jemi të furnizuar. Po ashtu jemi furnizuar me barna edhe nga komuna . Furnizimi me barna dhe material shpenzues nga Ministria e Shëndetësisë ka qenë i mirë , mirëpo jo në nivelin e duhur.

Edhe gjatë këtij viti në QKMF janë kryer të gjitha shërbimet shëndetësore siç janë:

1.Mjekësia familjare	102.046	kontrolla mjekësore
2.Urgjenca	30.573	kontrolla mjekësore
3.Stomatologjia	1,368	kontrolla mjekësore
4.Pediatria	4,574	kontrolla mjekësore
5.Vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç	1,927	
6.Vaksinimi	7777	
7.Laboratori	13793	
8.Rëntgeni	4,745	
9.Terreni	3,475	
10.Shërbimet infermierike –QKMF ,QMF dhe AMF.....	198,913	
11.Gjinekologjia	1921	
12.Pulmologjia	649	
13.Radiologjia	427	

14.Klasa për nëna dhe fëmijë250

Totali i shërbimeve shëndetësore për vitin 2024 ka qenë 372,438.

AKTIVITETET NË QKMF GJATË VITIT 2024

Gjatë vitit 2024 ka vazhduar mbajtja e ligjëratave në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, ku kanë marrë pjesë mjekë dhe infermierë nga QKMF-ja.

Gjatë këtij viti kemi pasur problem me funksionimin e SISH-it dhe se kjo situatë po paraqet problem. Kemi lajmëruar zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë dhe kompaninë e cila ka qenë e kontraktuar për këtë për këtë problem, por përgjigjja e tyre ka qenë se jemi në fazën kur po punojmë për kontraktimin e një kompanie tjetër ,pasi që kompanisë aktuale i ka përfunduar kontrata. Problemi i njëjtë është në tërë Kosovën.

Një ekip mjekësor nga QKMF-ja ka qenë prezent në Palestrën e Sporteve në turnirin për futboll të vogël me rastin e shënimit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës ,me ç’rast është kujdesur për shëndetin e pjesëmarrësve për 2 ditë radhazi ,me datën 16.02 dhe 17.02.2024. Me datën 27 shkurt dhe 28 shkurt 2024 ka filluar vaksinimi kundër HPY-së (virusit të papillomës humane) për nxënëset e klasave të gjashta .Virusi i papillomës humane është shkaktari i kancerit të qafës së mitrës.

Me datën 07 mars 2024, jemi ftuar në takim me përfaqësuesit e AQH-së në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Kaçanikut ,Dr.Besim Ilazi. Ata kishin ardhur për të na njoftuar për fazën e tretë të projektit të AQH-së,që parashihet të shtrihet edhe në komunën tone.

Me datën 12 mars 2024 kam pranuar zyrtarisht njoftimin se QKMF-Kaçanik është përzgjedhë në projektin ICARS- MSH për përmirësimin e cilësisë së përshkrimit të antibiotikëve në kujdesin primar shëndetësor. Ky projekt do të implementohet nga IKSHP-ja me Koordinator ,Prof.Dr.Lul Raka me ekipin e tij .Në këtë projekt janë të përfshirë 6 komuna: Prishtina, Gjakova, Klina, Lipjani, Vushtrria dhe Kaçaniku.

Me datën 19.03.2024 kemi pritur në takim ekspertët e AQH-së : Dr.Bajram Maxhuni, Dr.Genc Ymerhalili, Dr.Merita Shehu dhe Dr.Elvira Rasimi. Ata kishin ardhur për të prezantuar projektin e fazës së tretë të AQH-së, si dhe modalitetet se si do të realizohet ky projekt.

Me datën 16 prill 2024 është bërë përrurimi i objektit të ri të QMF-së në Doganaj. Objekti i ri është ndërtuar në tërësi nga buxheti komunal dhe ka kushtuar 113.000 €.Shërbimet shëndetësore do të ofrohen për qytetarët tanë nga e hëna deri të premten nga ora 08.00 deri në ora 15.00.

Me datën 2 maj 2024 është kthyer participimi për shërbimet shëndetësore për qytetarët.

Vendimin e ka marrë Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në muajin prill. Vlen të theksohet se që nga 21 prilli 2020 gjatë pandemisë COVID-19 e deri më 1 maj 2024 qytetarët e Komunës së Kaçanikut janë liruar nga pagesa për shërbimet shëndetësore. Vendimin është marrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në bashkëpunimin me Shtabin Emergjent Komunal i formuar gjatë pandemisë COVID-19.

Me datën 29 maj 2024 është mbajtur punëtorja gjysmë ditorë e organizuar nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me procesin e përzgjedhje së mjekut familjar në tërë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe përgjegjësitë që do ti kenë Drejtorët e QKMF-së lidhur me procesin në fjalë!

Me datën 03 qershor 2024 stafi menagjues i QKMF -së ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga AMC-ja, UNFPA,MSH-ja, dhe IKSHPK-ja ,ku u diskutua lidhur me zbatimin e trajnimeve të organizuara për stafin shëndetësor që ka të bëjë me shëndetin reproduktiv, planifikimin familjar, infeksionet seksualisht transmise dhe dhuna në baza gjinore.

Me datën 20.06.2024 kemi marrë pjesë në takimin e pare të projektit ICARS-MSH për përmirësimin e cilësisë së përshkrimit të antibiotikëve në Kujdesin Primar Shëndetësor. Në këtë

projekt janë të përfshirë QKMF- Prishtinë, QKMF-Lipjan, QKMF-Gjakovë, QKMF-Vushtri, QKMF-Klinë dhe QKMF-Kaçanik. Prezent në takim ishin Drejtori i QKMF-së dhe koordinatori i cilësisë. Qëllimi i këtij projekti është ulja e përshkrimit të antibiotikëve për infeksionet e sipërme të frymëmarrjes ,ky projekt zgjatë 3 vite dhe parashihet të zgjerohet në të gjitha komunat e Kosovës.

Gjatë muajit korrik kemi pasur në vizitë ekspertët vendor të AQH-së, të cilët erdhën për të pare kushtet që i ofron QKMF-ja për fazën e tretë të projektit, ku parashihet që të hapet edhe këshillimorja për sëmundjet kronike jo ngjitëse(për hipertensionin, diabetin dhe asthmën bronkiale),si dhe këndin e edukimit për pacientë.

Gjatë muajit korrik kemi pasur rritje të numrit të pacientëve dhe kjo rritje ka ardhur si rezultat i ardhjes së bashkatdhetarëve në vendlindje.

Me datën 29.08.2024 kam pranuar nga MSH-ja qarkoren informative nr.04/2024 ,që ka të bëjë me caktimin e dhomës për edukim dhe promovim shëndetësor në Kujdesin Primar Shëndetësor, si dhe përpilimin e listës së standardizuar për pajisje dhe inventar për dhomën për edukim shëndetësor në kuadër të QKMF-së. Kurse me datën 30.08.2024 kam proceduar me kërkesë për pajisje dhe inventar përmes e-maili drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë. Ky është projekt i Ministrisë së Shëndetësisë, kurse me AQH-në është projekt tjetër.

Që nga data 02 shtator 2024 në 8 punkte shëndetësore ,mjeku është në dispozicion, kurse në Kotlinë,I vajë ,Shtrazë nuk është paraparë pasi nuk ka pacientë fare. Nga data 09 shtator 2024 ka filluar fushata sensibilizuese për vaksinim kundër virusit të papillomës humane,i cili është shkaktar i kancerit të qafës së mitrës dhe tash parashihet që nga moshë 13-21 vjeç të bëhet vaksinimi.

Kryetari i komunës, z.Besim Ilazi së bashku me ISLAMIC RELIEF kanë nënshkruar marrëveshjen për bashkëfinancim për blerjen e aparatit të mamografisë për QKMF-në në vlerë prej 100.000 €.

Me datën 18.09.2024 kam proceduar me kërkesë përmes e-mailit Drejtorit të SHSKUK-së dhe Drejtoreshës së Klinikës së Radiologjisë për sjelljen e mamografit mobil në QKMF-Kaçanik në kuadër të muajit tetor –muajit të ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit.

Gjatë muajit shtator kanë filluar punimet nga kompania kontraktuese për rregullimin e depos dhe garazhave të reja për veturat e QKMF-së, projekt dy vjeçar qe kap vleren e investimit 214.464 €. Me datën 25 shtator 2024 jemi furnizuar me 1500 doza të vaksinës kundër gripit sezonal.

Vaksinimi ka filluar me datën 30 shtator 2024 dhe kategoritë që parashihen të vaksinohen janë: personat mbi moshën 65 vjeçare, shtatzënat, lehonat, të sëmurët kronikë, punëtorët shëndetësor, . Vaksinimi kundër gripit sezonal është duke u bërë edhe në terren.

Me datën 03 tetor 2024 kemi hapur fushatën në kuadër të muajit për ndërgjegjësimin kundër kancerit të gjirit, me ç’rast një ekip mjekësor ka qëndruar nga ora 10.00-12.00 në sheshin e ri të qytetit ,ku janë dhënë këshilla mjekësore, si dhe janë shpërndarë broshura.

Me datën 10.10.2024 është mbajtur ligjërata për kancerin e gjirit nga Dr.Lirika Loku dhe kryeinfermierja Filkizare Çuni Dema në sallën e Kuvendit Komunal të Kaçanikut. Kjo ligjëratë ishte interaktive dhe zgjoi interesimin e të pranishmëve.

Me datën 16 dhe 17 tetor 2024 mamografi mobil ka qenë në dispozicion , me ç’rast 25 gra kanë kryer mamografinë. Po ashtu në bashkëpunim me Laboratorin AVICENA KS në QKMF-Kaçanik ka qenë i angazhuar radiologu gjatë ditës së hënë nga ora 14,30 deri 18.00 (4 herë gjatë muajit tetor), me ç’rast kanë kryer ultratingullin e gjirit 87 gra dhe vajza nga komuna jonë, si dhe 18 gra dhe vajza nga Hani i Elezit.

Me datën 25.10.2024 QKMF-ja në bashkëpunim me AQH-në dhe KOPF-in kanë organizuar Karvanin lëvizës shëndetësor „PËRSHËNDETJE”. Ky aktivitet është zhvilluar në sheshin e ri të qytetit nga ora 11.00 deri në ora 14.00. Interesimi i qytetarëve ishte i madh, ku ata u informuan për faktorët e rrezikut për sëmundjet jo ngjitëse si diabeti, hipertensioni, astma bronkiale, dëmet që shkakton duhan pirja, alkooli, mos aktiviteti fizik, këshilla për ushqyerje të shëndetshme.

Me datën 12.11.2024 kemi pritur në takim Drejtorin e Shoqatës së të Drejtave të pacientëve (PRAK) Agron Bytyçi, Kryetari i PRAK-ut Besim Kodra, si dhe Elmedina Kukaj nga AQH-ja. Në këtë takim u nënshkrua memorandum i mirëkuptimit për nisjen e procedurave për themelimin e Këshillit të pacientëve në QKMF-Kaçanik. Memorandumi u nënshkrua nga Drejtori i DSHMS-së dhe Drejtori i PRAK-ut.

Në DSHMS janë udhëhequr të gjitha procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pacientëve, siç janë: Ftesa publike për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pacientëve, e cila ka qenë e publikuar në web faqen e komunës, formimi i Komisionit për përzgjedhje të anëtarëve dhe intervistimi i kandidatëve. Me datë 19.12.2024 është formuar Këshilli i pacientëve në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve të cilët janë: Valdet Raka, Jasemine Krasniqi, Suzana Rudi, Xhevahire Brati dhe Bashkim Baftiri. Këshilli i pacientëve është funksional dhe është i gatshëm për bashkëpunim me qytetarët e komunës sonë dhe me QKMF.

Me datën 14.11.2024 është mbajtur trajnimi për stafin shëndetësor nga ana e Kryetarit të PRAK-ut, Besim Kodra me temën „PARANDALIMI I KONFLIKTEVE ME PACIENTË DHE KOLEGË NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE”. Gjithashtu Kryetari i PRAK-ut, Besim Kodra ka mbajtur trajnim edhe me anëtarët e Këshillit të Pacientëve.

Me datën 14.11.2024 është shënuar Dita Botërore e Diabetit, me ç’rast një ekip mjekësor në QKMF, ka ofruar shërbime shëndetësore falas për qytetarët tanë si matja e glikemisë (sheqerit në gjak), si dhe janë dhënë këshilla mjekësore se si të parandalohet sëmundja e sheqerit dhe si të menagjohet kjo sëmundje.

Organizata „KOPF” ka mbajtur një aktivitet për sëmundjen e SIDËS në sheshin e ri të qytetit me datën 20.11.2024 nga ora 12.00 deri në ora 14.00, me ç’rast janë dhënë këshilla për qytetarët tanë, si dhe janë shpërndarë broshura, kurse në fund të aktivitetit QKMF-së i janë dhuruar material sensibilizues për sëmundjen e SIDËS.

Me datën 27.11.2024 një ekip mjekësor nga QKMF-ja është kujdesur për shëndetin e pjesëmarrësve në aktivitetet sportive tek palestra e sportit, me rastin e Festës së 28 Nëntorit!

Me datën 03.12.2024 në Prishtinë është mbajtur trajnimi për auditet klinike në kuadër të projektit për reduktimin e përrshkrimit të antibiotikëve në Kujdesin Primar Shëndetësor. Nga QKMF-ja në këtë trajnim kanë marrë pjesë 12 mjekë, të cilët do të marrin pjesë në realizimin e këtij projekti.

Me datën 04.12.2024 është bërë planifikimi për listën esenciale për barna dhe material shpenzues mjekësor për vitin 2025 dhe i është dërguar Ministrisë së Shëndetësisë në e-mail e po ashtu edhe kopja fizike.

Me datën 10.12.2024 është bërë plani për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional për vitin 2025 dhe i njëjti i është përcjellë në Odën e Mjekëve për aprovim.

Me datën 11.12.2024 kemi pranuar donacion nga Ministria e Shëndetësisë përmes UNICEF-it disa mjete konkretizuese për klasat për nëna dhe fëmijë, si dhe 1 (një) inventar për nevojat e këtij projekti, i cili mbikëqyret nga MSH-ja dhe AMC-ja.

Me datën 18 dhjetor 2024 kanë filluar punimet në oborrin e QKMF-së për ndërtimin e memorialit për heroinat nga kompania kontraktuese, projekt i Qeverisë së Kosovës.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Historiku i Qendrës për punë sociale në Kaçanik

Qendra për Punë Sociale është themeluar më datën .01.09.1983 ku në fillim kishte 5 punëtorë, deri atëherë punët rreth mbrojtjes sociale ishin kryer në kuadër të B.V.I sepse deri atëherë nuk kishte objekt, QPS-ja punën e kishte filluar me objektin e ri të ndërtuar në vitin 1982, ku në vitin 2022 objekti i Qendrës për Punë Sociale është rrënuar nga komuna dhe ne jemi vendosur përkohësisht në Palestër Sportive në Kaçanik. Qendra për Pune Sociale ka 8 punëtorë.

Kjo Qendër si një institucion me rëndësi të veçantë shoqëror i ka kryer të gjitha punët dhe detyrat të cilat ishin të rregulluara në bazë të Ligjeve në fuqi me qëllim të sigurimit të mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët në nevojë.

- ka vendosur për të gjitha çështjet që parashihte ligji në shkallë të parë;
- ka ofruar shërbime të ndryshme sociale dhe familjare për të gjitha kategoritë shoqërore.

Përveç këtyre punëve Qendra për Punë Sociale ka kryer edhe punë profesionale me qëllim të përmbushjes së kërkesave të ndryshme të qytetarëve, rreth mbrojtjes sociale

- ka zbuluar dhe përcjellë nevojat e qytetarëve si dhe problemet në domenin e mbrojtjes sociale;
- ka propozuar si dhe ka ndërmarr masa për zgjidhjen e nevojave sociale të qytetarëve;
- ka organizuar dhe aplikuar format e mbrojtjes sociale si dhe njëkohësisht ka ofruar shërbime të nevojshme sociale;
- ka zhvilluar punën preventive kundër paraqitjes së problemeve të ndryshme sociale;
- ka ofruar shërbime të ndryshme këshilluese si dhe ndihma profesionale nevojtarëve;
- ka kryer punët e organit të kujdestarisë ndaj të miturve dhe personave të rritur;
- ka kryer mbikëqyrje profesionale ndaj ushtrimit të së drejtës prindërore, dhe besimit të fëmijëve njërit nga prindërit;
- ka kryer punët e adoptimit;
- ka kryer punët lidhur me delikuecën e të miturve etj.

Misioni i Qendrës për punë sociale

Misioni i Qendrës Për Punë Sociale është ofrimi i shërbimeve të nevojshme për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë pa dallim kombi, feje, gjinie, ngjyre etj., respektimin në përpikëri të legjislacionit në fuqi, ngritjen e efikasitetit të shërbimeve dhe mbrojtjes sociale, mbështetjen e qëndrueshme në çdo aspekt të qytetarëve të cilët kanë nevojë më së shumti.

Misioni i Qendrës për Punë Sociale edhe në të ardhmen do të mbetet ofrimi i shërbimeve më të avancuara, zbatimi dhe implementimi i të gjitha ligjeve, rregulloreve dhe doracakëve të ndryshëm, të hartuara nga DMS -së, me qëllim të mbrojtjes sa më të mirë të kategorive të ndryshme siç janë:

- Ofrimi i shërbimeve sociale sipas standardeve dhe në harmoni me kërkesat e grupeve dhe kategorive të ndryshme:, mbrojtja e fëmijëve të braktisur; fëmijëve bonjak; e fëmijëve të abuzuar dhe të keqtrajtuar; mbrojtja e viktimave të trafikimit dhe ri integrimi i tyre, mbrojtja e viktimave të dhunës në familje; mbrojtja e fëmijëve me sjellje asociale; rastet e të sëmurëve, personat e moshuar pa përkujdesje të askujt; personat me aftësi të kufizuar etj.

- implementimi sa më i drejtë i ligjit të ndihmës sociale, me qëllim që ndihmat sociale të arrijnë tek të varfëritë.

- ofrimi i mundësive dhe shërbimeve të barabarta për të gjitha qytetarët (shërbime sociale, njohjen e së drejtës në ndihma sociale pa kurrfarë diskriminimi) etj.

- bashkëpunimi me të gjitha institucionet qeveritare, OJQ-t e ndryshme, me qëllim të ofrimit sa ma të mirë të shërbimeve sociale;

- pjesëmarrja në të gjitha takimet dhe seminarët të cilat do ti organizoi DSHMS, DMS-së apo ndonjë OJQ-ë, krejt me qëllim të ngritjes profesionale të nëpunësve të QPS-së.

Qëllimi i Qendrës për punë sociale

Qendra për punë sociale, si qëllim kryesor ka organizimin dhe realizimin e formave mbrojtëse sociale, ofrimin e shërbimeve të ndryshme për të gjitha komunitetet pa dallim etniteti dhe besimi. Qëllimet kryesore të Qendrës Për Punë Sociale do t'i priorizionim me këtë renditje:

përkrahja e grupeve të marginalizuara shoqërore, zbutjen e varfërisë dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme për të gjithë qytetarët;

- ofrimin e ndihmave sociale për familjet me gjendje të vështirë materiale dhe shëndetësore;
- implementimi i politikave sociale të hartuara nga DMS-së;
- ngritja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve sociale në përgjithësi;
- rritja e bashkëpunimit më të ngusht në mes institucioneve profesionale, OJQ-ve me qëllim të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët.
- ngritja e vazhdueshme profesionale e zyrtareve gjegjësisht e stafit të Qendrës me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira, në dobi të të gjithë qytetarëve.

Aktivitetet e zhvilluara

Gjatë vitit 2024 kemi pranuar gjithsej 594 lëndë, në shërbimin social Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të resurseve humane në Qendrën për punë sociale edhe gjatë këtij viti zyrtaret e shërbimeve sociale kanë marrë pjesë në përpunimin e udhëzuesit për ofrimin e shërbimeve sociale, dhe janë trajnuar për bazën e të dhënave të shërbimeve sociale , bazën e dhunës në familje , bazën e FAKP fëmijëve me aftësi të kufizuar , bazën e strehimit familjar, dhe duke marrë pjesë në të gjitha trajnimet e organizuar nga ministria , departamenti dhe OJQ të ndryshme , ku edhe jemi licencuar nga ministria për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në Qendrën për Pune sociale.

Sa i përket ndihmës dhe mbështetjes së familjeve me gjendje të rëndë ekonomike dhe familje të cilat kanë mungesë strehimi ose jetojnë në shtëpi të cilat nuk i plotësojnë kriteret për banim, komuna e Kaçanikut, me datë 02.09.2024 ka publikuar Shpalljen Për aplikim në kuadër të Programit trevjeçar të Banimit për familjet me kushte të rënda sociale dhe ekonomike, të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit. Shpallja është publikuar në web faqen e komunës, si dhe është shpërndarë edhe në rrjete sociale si në facebook. Aplikimi ka qenë i hapur për 30 ditë. Të gjithë aplikuesit para aplikimit janë konsultuar rreth kompletimit të dokumentacionit në zyrat e DSHMS-së, në mënyrë që çdo kujt t'i mundësohet aplikimi. Pas përfundimit të afatit për aplikim është formuar edhe Komisioni për përzgjedhjen e familjeve , në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, të cilët kanë dal në terren dhe i kanë verifikuar të gjitha familjet e aplikuesve, nëse i plotësojnë kriteret sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 21/2010. Gjithsej kanë aplikuar 67 familje, mirëpo prej tyre vetëm 36 kanë qenë përfitues të programit, pasi që kemi pasur në dispozicion 36 banesa, në dy ndërtesat në fshatin Kaçaniku i Vjetër.

Gjithashtu komuna e Kaçanikut në bashkëpunim me Shoqatën Humanitare “Jetimat e Ballkanit” kanë ndërtuar 10 shtëpi, në të cilat do të strehohen 10 familje me kushte të rënda ekonomike, të cilat familje janë përzgjedhur nga një Komision përzgjedhës.

Realizimi i të drejtave të qytetarëve për shërbimet e ofruara

Qendra për punë sociale lidhur me realizimin e të drejtave të qytetarëve, ka bërë përpjekje maksimale që konform ligjeve të aplikueshme, të gjithë qytetarëve pa dallim kombi, feje, ngjyre dhe gjinie t’iu ofroi shërbime të nevojshme sipas kërkesave të tyre.

Po ashtu jemi përpjekur maksimalisht që të gjithë parashtruesit e kërkesave të i informojmë me kohë si që e përcaktojnë ligjet, po ashtu edhe ankesave të tyre u kemi përgjigjur me kohë. Si vendosja e mbishkrimeve në objektin e Qendrës për Punë Sociale, ku janë vendosur njoftimet lidhur me njohjen e të drejtave për çështje të ndryshme me interes për qytetarët.

Shërbimet sociale dhe vendosja në institucionet për përkujdesje

Nëpunësit e shërbimeve sociale në kuadër të Qendrës, shërbimet e mbrojtjes sociale i kanë kryer dhe realizuar në harmoni me:

1. Ligjin mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare;
2. Ligjin mbi shërbimet sociale dhe familjare;
3. Ligjin për familjen –në Kosovë;
4. Doracakun për mbrojtjen e fëmijëve,
5. Ligjin mbi procedurën kundërvajtjes, ndaj të miturve;
6. Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale ndaj të miturve;
7. Ligjin mbi mbrojtjen sociale;
8. Ligjin mbi procedurën e përgjithshme administrative;
9. Ligjin mbi procedurën jashtë kontestimore;
10. Ligjin i procedurës penale të Kosovës;
11. Kodi penal i Kosovës
12. Ligji penal për të mitur, i Kosovës
13. Ligjin mbi kontestet administrative;
14. Doracakun për strehim familjar
15. Rregullorja mbrojtja kundër dhunës në familje;
16. Rregullorja mbi ndalimin e trafikimit të qenjeve njerëzore dhe të gjitha udhëzimet administrative si dhe të gjitha konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të njeriut.

Fëmijët pa përkujdesje prindërore

- a. Fëmijët bonjak (pa dy prindër);
- b. Fëmijët e braktisur;
- c. Strehimi familjar;
- d. Prindërit e fëmijëve që nuk i kanë kryer detyrat prindërore

a. Fëmijët bonjak pa dy prind

Gjatë kësaj periudhe, zyrtaret e shërbimeve sociale kujdesë të veçantë i kanë kushtuar fëmijëve pa kujdes prindërorë (bonjak) të strehuar te të afërmit e tyre. Nëpunësit konform

ligjit për të gjithë fëmijët pa kujdesje prindërore numri i të cilëve ishte në fillim të vitit 6 ku shërbimi social në vazhdimësi ka përcjell dhe monitoruar në vazhdimësi këta familje dhe fëmijë në bashkëpunim edhe me OJQ te ndryshme.

b. Fëmijët e braktisur

Zyrtarët e shërbimeve sociale janë marrë edhe me mbrojtjen e fëmijëve të braktisur, ku fatmirësisht këtë vit ne komunën tonë nuk kemi fëmijë të braktisur.

Zyrtarët e shërbimeve sociale kanë identifikuar familjet potenciale për birësimin-Adoptimin e fëmijëve të braktisur, deri me tani I kemi 09 kërkesa të qifteve bashkëshortorë te cilët kanë bërë kërkesë për adoptim të fëmijëve . Qendra për Pune Sociale , konkretisht shërbimi social pas pranimit të kërkesës ka dal ne teren, vizitë familjes , ku edhe ju është dhënë përshtatshmëria për adoptim dhe janë futur në listën e pritjes si familje potenciale për Adoptim.

Ekipi profesional i QPS –së çdo vit bënë rivlerësimin e familjeve potenciale për adoptim

c. Prindërit e fëmijëve të cilët nuk i kanë kryer detyrat prindërore

Një prej dukurive shqetësuese me të cilat është ballafaquar shërbimi Social është edhe mbrojtja e fëmijëve, për të cilët është mbajtur evidencë, janë dhënë mendime dhe propozime të ndryshme për masat që duhet tu shqiptohen këtyre të miturve.

Gjatë këtij viti jemi ballafaquar me këto raste të cilat prindërit nuk kanë pasur kujdes të duhur prindëror ndaj fëmijëve të tyre, ku numri i tyre arrin në **6 fëmijë**, ndaj të cilëve prindërit nuk kanë treguar kujdes të duhur. Këta fëmijë janë identifikuar nga nëpunësit e Qendrës. Këta fëmijë janë gjetur duke lypur lëmoshë në rrugë. Lidhur me këto raste nuk ka munguar bashkëpunimi me terr des Hommes si dhe Shërbimin Policor të Kosovës.

Fëmijët e familjeve në konflikte:

a. Fëmijët e familjeve me marrëdhënie të çrregulluara.

b. Fëmijët e prindërve të shkurorëzuar dhe të ndarë.

Gjatë këtij viti, në trajtim të QPS-së kanë qenë 6 qifte bashkëshortor, prej tyre të gjithë kanë qenë me kurorë, ku zyrtaret e shërbimit Social, kanë bërë sanimin e marrëdhënieve bashkëshortore të këtyre rasteve. Zyrtaret e shërbimeve sociale këto raste i vizitojnë dhe i kanë në tretman të vazhdueshëm, duke ju ofruar këshilla psiko - sociale dhe rekomandime te vazhdueshme

Vlen të përmendet bashkëpunim i ngushtë me policin, strehimoret e ndryshme të cilat veprojnë në Kosovë dhe institucionet tjera si Gjykata dhe QKMF etj.

Fëmijët dhe rinia me sjellje të çrregulluara

Një ndër problemet shqetësuese me të cilën ballafaqohet shoqëria është delikuenca e të miturve për të cilën kategori zyrtaret e shërbimeve sociale pranë kësaj qendre ka punuar me rastet e tilla.

Fëmijë me sjellje asociale kemi pasur **12 raste** me të cilët është punuar dhe në bashkëpunim me prindërit dhe shkollën, ku kemi pasur sukses në parandalimin, evitimin dhe kemi marr masa që faza latente mos të shndërrohet në atë manifestuese . Delikuent të mitur - kemi pasur **64 raste** ,prej tyre të trajtuar nga ana e Qendrës për Pune Sociale duke ju ofruar këshillime psiko-sociale dhe duke bashkëpunuar edhe me psikologë të shkollave deri në risocializimin e tyre .

Vlen të përmendet bashkëpunimi shumë i ngushtë me drejtorët e shkollave , psikologët police QKMF dhe gjykatën dhe te gjithë aktorët tjerë të përfshirë në raste.

Rezultatet shihen sepse zyrtarët e shërbimeve sociale në bashkëpunim me fëmijët, prindërit, shkollën dhe policinë ka bërë kthesë që këta të mitur të mos manifestojnë ndonjë sjellje tjetër kundër ligjore.

Kjo dukuri e këtyre të miturve vjen në shprehje për shkak të mungesës apo pa kujdesit prindërorë ndaj fëmijëve të tyre ku prindërit janë në të shumtën e rasteve bashkëfajtorë për sjelljet dhe veprimet e fëmijëve të tyre.

Shkaqet të cilat kanë ndikuar në kryerjen e veprave kundër ligjore janë:

1. Kushtet e vështira ekonomike;
2. Përdorimi i substancave narkotike sidomos neper shkolla
2. Lënia pas dorë e fëmijëve nga ana e prindërve;
3. Mungesa e bashkëpunimit të prindërve me shkollën, dhe QPS -në
4. Ndërrimi i ambientit shoqëror, -zhvendosja nga vendbanimi rural në ate urban
5. Çrregullimet e raporteve bashkëshortore etj.

Fëmijët me nevoja të veçanta

Çështje mjaft serioze dhe e ndjeshme për shoqërinë është edhe çështja e fëmijëve me nevoja të veçanta FAKP. Gjatë vitit 2024 QPS –ja është përpjekur për evidentimin e të gjitha rasteve të fëmijëve dhe të rinjëve me nevoja të veçanta . Ku me ligjin për përkrahjen e familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme kanë gëzuar të drejtën e ndihmës materiale në vlerë prej 120 euro në muaj , 63 familje nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Disa fëmijë vijnë në mësimet në shkolla normale në gjithë territorin e komunës sonë.

Duhet theksuar se zyrtarët e shërbimit social në vazhdimësi këshillojnë prindërit që këta fëmijë me nevoja të veçanta të vijnë në mësimet në shkolla normale në vende ku edhe jetojnë.

Qendra për Punë Sociale çdo 6 muaj bënë vizita të rregullta në këto familje ku bashkëbisedon me këta fëmijë, dhe prindërit e tyre, ju jepen sugjerime dhe rekomandime për trajtimin e tyre, ky është monitorim I vazhdueshëm nga ana jonë.

Trafikimi i qenieve njerëzore

Në komunën tone nuk kemi pasur asnjë rast të trafikimit të qenieve njerëzore.

Të rriturit me nevoja të veçanta

Sa i përket të rriturve me nevoja të veçanta pran QPS-së janë evidentuar një numër i madh i të rriturve dhe të moshuarve me nevoja të veçanta, një pjesë e të cilëve janë përfshirë në asistencë sociale, një pjesë tjetër kanë përfituar shërbime sociale ku ju është këshilluar, orientuar personat me nevoja të veçanta që të vizitojnë Qendrën e shëndetit Mental në Ferizaj , në mënyrë që të trajtohen në mënyrë adekuate pasi që aty ka profesionist të cilët mund t'i ofrojnë shërbime adekuate ku një pjesë e tyre edhe sot trajtohen, pasi që në komunën tonë nuk kemi institute të shëndetit mental, prandaj të gjithë personat me problem mentale me ndihmën tonë duhet të dërgohen në Ferizaj për trajtim.

Të rriturit në gjendje konfliktuoze

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2024 në Qendrën për punë sociale janë trajtuar **11** raste të cilat kanë pasur çrregullime familjare, të cilat pas trajtimit që kanë bërë zyrtarët e shërbimeve sociale raportet familjare janë sanuar. Rastet e tilla nga ana e nëpunësve të shërbimeve sociale janë përcjellë vazhdimisht, andaj kjo ka ndikuar që raportet familjare janë përmirësuar dukshëm.

Dhuna në familje

Gjatë kësaj periudhe në Qendrën për Punë Sociale janë referuar dhe trajtuar **21** raste të dhunës në familje, të cilat kanë përfituar dhe marrë shërbimet e duhura në Qendër Për Pune Sociale Një rastë ka qëne në strehimore në Ferizaj, ku pala ka përfituar të gjitha shërbimet brenda strehimores , pas një jave viktima është kthyer tek familja e sajë, ndërsa për raste tjera pas sanimit të marrëdhënieve familjare të njëjtat janë kthyer në familjet e tyre.

Në të gjitha rastet kemi pasur një bashkëpunim të mirë me Policinë, Gjykatën, Zyrën për mbrojtjen e viktimave, familjen, si dhe strehimoret dhe OJQ të ndryshme ,Institutin për politikë sociale, Departamentin e punës dhe mirëqenies sociale, dhe të gjitha institucionet tjera që kanë qenë të përfshira në raste.

Në Qendër për Punë Sociale lëshohen edhe disa lloje te ndryshe te vërtetimeve si :

Vërtetime për zotësi veprimi - 161

Vërtetim për marrjen e shtetësisë së Kosovës - 4

Vërtetim për përkujdesje -16

Vërtetim për udhëtim jashtë vendit -16

Raporti për format, masat e shërbimeve sociale të ofruara nga QPS-së-Kaçanik

Nr	I. Fëmijët pa kujdes prindëror	Viti	2024	Vjetor
		Mash.	Fem.	Gjithsejt
1	Kujdestaria	4	2	6
2	Adoptimi -para adoptim	0	0	0
3	Strehimi familjar. për fëmijët e rrezikuar e keqtrajtuar	0	0	0
4	Strehimi ne SOS Kinderdorf-	0	0	0
5	Kërkesa për adoptim	8		8
Nr	II.Të miturit e keqtrajtuar, rrezikuar te lënë pas dore	2024	Vjetor	
		Mash.	Fem.	Gjithsejt
	Keqtrajtim seksual	0	2	2
3	Strehimi familjar (me pagese)	4	2	6
5	Caktimi i kujdestarit nga QPS-te	0	0	0
6	Caktimi i kujdestarit jashtë QPS-se	4	2	6
Nr	III Fëmijët e prindërve te shkurorëzuar apo te ndare	2024	Vjetor	
		Mash.	Fem.	Gjithsejt
1	Sanimi i marrëdhënieve familjare	0	4	4
2	Propozimi për besimin e femiut	4	3	7
3	Për nënën	3	4	7
4	për babain	2	0	2
5	Vendimi i gjykatës për besim te femiut	2	1	3
6	Besimi nga QPS-ja për bashkëshort pa kurorë	Ne proces	1	1
7	Përcjellja e kontakteve	7	5	12

8	Klient tjerë	30	18	48
9	Çrregullime bashkëshortore pa fëmijë	0	0	0
10	Martesa e të miturve	0	0	0
11	Çrregullime bashkëshortore në proces	1	1	2
12	Bashkim familjar	0	4	0
13	Bredhësa-Lypsa	6	0	6
Nr	IV.Femijet dhe rinia me sjellje te çrregulluar dhe delikuent	Viti	2024	Vjetor
		Mash.	Fem.	Gjithsejt
1	Fëmijët me sjellje asociale deri ne 14 vjeç	10	7	17
2	Te miturit me sjellje asociale 14-18 vjet	36	0	36
3	Delikuentet e mitur 14-16 vjet	20	1	21
4	Delikuentet e rritur 16-18 vjet	43	1	44
	a)Trajtimi i rastit dhe risocializimi	25	1	26
	b)Bashkëpunimi me familje	po		
	c)Ne polici	po		
	d)Propozimi i masës risocializuese për gjykatë	40	0	40
Nr	V.Te miturit me nevoja te veçantë	Viti	2024	Vjetor
		Mash.	Fem.	Gjithsejt
1	Fëmijët me paaftësi të përhershme me pagesë	37	26	63
4	Në shkolla	12	5	17
Nr	VI.Dhuna në familje (baza gjinore)	Viti	2024	Vjetor
		Mash.	Fem.	Gjithsejt
1	Ndaj te miturve	6	2	8
2	Ndaj grave	0	21	21
3	Bashkëpunimi me policinë			po
4	Bashkëpunimi me gjykatë			po
5	Institucione tjera			po
Nr	VII. Te moshuarit pa kujdes familjar dhe residentë Në Shtime	Viti	2024	Vjetor
		Mash.	Fem.	Gjithsejt
1	Në strehim te farefisi	0	0	0
2	Në Shtime-rezidentë	2	0	2
	Institute i shëndetit mendor Ferizaj trajtim	6	0	6

Shërbimi i Ndhimave Sociale

Qendra për punë sociale punët dhe detyrat e punës në lëminë e ndihmave sociale gjatë vitit 2024 i ka realizuar në harmoni me Ligjin e Skemës sociale,Nr.2003/15 i cili ka filluar të implementohet në Janar të vitit 2005,dhe udhëzimeve administrative. Në realizimin e mbrojtjes sociale Qendra për punë sociale , ka kryer këto detyra të punës nga fushë veprimtaria e Skemës së ndihmave sociale:

- ka organizuar dhe realizuar format e mbrojtjes sociale, dhe permanent ka shërbyer për qëllime mbrojtëse të personave dhe popullatës;
- ka evidentuar raste sociale, dhe u ka dalë në ndihmë të gjithëve të cilët i kanë plotësuar kriteret për ndihmë sociale;
- ka përcjellë me kohë të gjitha lëndët në komision mjekësor;
- ju ka përgjigjur me kohë të gjitha ankesave të klientëve siç është e paraparë me Ligjin e skemës sociale etj.

Nëpunësit e skemës sociale janë të ndarë në bazë të terrenit, te cilin e mbulojmë 2 punëtorë, të cilët bëjnë evidentimin e një numri të konsiderueshëm të shfrytëzuesve të ndihmave sociale.

Obligim kryesor i zyrtareve për ndihma sociale për vitin 2024 ka qenë përcjellja e rasteve që e gëzojnë të drejtën në ndihmë sociale zbulimi dhe identifikimi i rasteve të reja që gjenden në situata të nevojave sociale.

Zbulimi i rasteve të reja për ndihmë sociale është një punë e përditshme dhe obligim i përhershëm i punëtorëve, si dhe verifikimi i rasteve të dyshuara se ndonjëri prej anëtarëve të familjes është punësuar, por kemi marrë parasysh edhe iniciativat dhe rekomandimet e subjekteve tjera të cilat janë të interesuara për mbrojtjen sociale të qytetarëve të komunës.

Vështirësi gjatë punës së zyrtareve për ndihma sociale ka qenë se ka mjaftë familje që nuk i plotësojnë kriteret e ndihmës sociale në asnjërën kategori por vërtet janë raste sociale.

Zyrtaret e ndihmave sociale gjatë vitit **2024** kanë dërguar në komision mjekësor **421** kërkesa ku prej tyre **326** pozitive **44** janë refuzuar.

Po ashtu gjatë këtij viti që po e lëmë pas janë shqyrtuar **12** ankesa (ankesa në shkallën e parë) të gjitha janë refuzuar në shkallën e dytë **8** të gjitha janë refuzuar

Zyrtaret e S.A.S-it gjatë këtij viti kanë lëshuar lloje të ndryshme të vërtetimeve :

Vërtetim për studentët të cilët janë shfrytëzues të SAS-it

Vërtetime për fitimin e shtetësisë së Kosovës 96

Vërtetim që është shfrytëzues i ndihmës sociale 11 , apo nuk është shfrytëzues I ndihmës sociale 20 .

Numri përfituesve të Asistencës sociale për vitin 2024

Tabela e numrit të përfituesve të asistencës sociale

Nr.	Muajt	Nr i familjeve përfituese
1.	janar	568
2.	shkurt	562
3.	mars	557
4.	prill	547
5.	maj	539
6.	qershor	539
7.	korrik	531
8.	gusht	523
9.	shtator	528
10.	tetor	510
11.	nëntor	506
12.	dhjetor	498
13.	Mesatarje Mujore	534

Pilotimi i reformuar i Skemës së Ndihmës Sociale ka filluar në muajin Maj të vitit 2024, Projekt i prezentuar nga Ministria e Punës dhe Transfereve dhe i financuar nga Banka Botërore.

Qëllimi I këtij projekti është të krijohet një skemë e re e cila heq diskriminimin që ekziston në skemën aktuale, duke mos përjashtuar nga skema familjet që skanë fëmijë nën moshën 5 vjeçare dhe që e inkurajon punësimin në anën tjetër përmes bashkëpunimit me Zyrën Rajonale të Punësimin.

Përmes kësaj skeme testohet varfëria në familjet aplikuese përmes kalkulimit të testeve të të hyrave dhe diskriminimit të projektligjit actual.

Fillimi i verifikimeve të rasteve ka filluar nga muaji Gusht, ku janë përcjellur listat me familjet të cilat kanë kaluar testin e të hyrave dhe asetëve për verifikim ku në listen e parë ka arritur numri në 165 familje , lista e dytë e aplikimeve ka qenë 178 familje, si dhe lista e tretë ka arritur deri në 116 raste.

Gjatë këtyre muajve jemi ballafaquar me punë jashtëzakonisht të ngarkuar, ngase ne si zyrtarë dhe në mungesë të stafit kemi punuar edhe me ligjin actual ku kemi pasur riaplikime të kategorive dhe vërtetime të shfrytëzuesve të ndihëmes sociale dhe njëkohësisht verifikimet në teren të riaplikimeve online të këtij projekti.

Gjatë këtyre vizitave vlenë të theksohet se përfitues të këtij projekti në Komunën tone janë 120 familje që mendojmë të jenë në ndihmë sado pak e mjaftueshme për familjet e anueshme në Komunën tone . Ky projekt është ende funksional, ku ne si zyrtar jemi të angazhuar të bëjmë verifikimin e familjeve të përzgjedhura nga ana e komisioneve punuese në kuadër të këtij projekti, ku të dhënat që përcillen nga ana e Zyrtarëve të Skemës për Ndhimë Sociale që përcaktohen si familje përfituese.

Drejtoria e Arsimit

Raporti i punës për vitin 2024

Aktivitetet kryesore për realizimin e prioritetit	Arritjet/progresi/permanca kyçe gjatë vitit 2024
---	--

1. Organizimi dhe funksionimi i sistemit arsimor

1.1 Organizimi dhe funksionimi i sistemit arsimor; Arsimi parafillor (0), Fillor (1), Mesëm i ulët (2) dhe Mesëm i Lartë (3)

Funksionimi i sistemit arsimor, për nivelet e Arsimit parafillor (0), Fillor (1), Mesëm i ulët (2) dhe Mesëm i Lartë (3) në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-32 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjin Nr. 03/L-068 për arsimin më Komunat e Republikës së Kosovës.

Zbatimi i Kurrikulës së re bërthamë e bazuar në kompetenca, përkatësisht promovimi i arimit gjithëpërfshirës, cilësor dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare, ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet shkollore dhe përgatitja e tyre për sfidat e jetës.

1.2 Përfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor, duke përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta; respektivisht gjithëpërfshirja që mundëson mbështetje për të gjithë nxënësit pavarësisht gjendjes së tyre fizike, intelektuale, sociale etj.

Gjithëpërfshirja ishte prioritet dhe synim për përfshirjen e të gjithë nxënësve/fëmijëve në procesin edukativ arsimor, duke përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta.

Në këtë mënyrë, në institucionet tona arsimore është arrit shkallë e kënaqshme e gjithëpërfshirjes së fëmijëve duke përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta, ndërkohë që pjesëmarrja/përfshirja e tyre duke mësuar së bashku me të tjerët e duke bashkëpunuar me bashkëmoshatarët dhe duke ndarë të njëjtat përvoja të të nxënit ka qenë vlerë e njëkohësisht edhe proces që ka ndihmuar fëmijët të njohin, pranojnë e vlerësojnë veten. Gjithëpërfshirja është e drejtë e çdo fëmije të ndjehet i respektuar, i sigurtë, i mbrojtur dhe të zhvillojë plotësisht potencialin e vet.

2. Ngritja/Avansimi i cilësisë në arsim – Zbatimi i Kurrikulës në arsimin parauniversitar

2.1 Vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas UA Nr.06/2022, respektivisht i bazuar në rezultatet e të nxënësve dhe reflektimi i performancës së nxënësve.

Janë zbatuar standardet në përputhje me dispozitat e UA për vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar respektivisht ka vazhduar vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas Kornizës kurrikulare të bazuar në rezultatet e të nxënësve për kompetenca (RNK), rezultatet e të nxënësve për fushë kurrikulare (RNF) dhe rezultatet e të nxënësve për lëndë mësimore RNL). Sipas Kornizës Kurrikulare qëllimi kryesor i vlerësimit është mbledhja e informacioneve për përkrahjen e nxënësve në zotërimin e rezultateve të të nxënësve, arritjet individuale të nxënësve, përcaktimi i performancës dhe orientimi i tyre për shkollim të mëtejshëm.

2.2 Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm - Testi i Maturës dhe Testi i Arritshmërisë

Në Testin e Maturës, në afatin e parë, të mbajtur më 22 qershor 2024, gjithsej 218 maturant i janë nënshtruar Provimit të maturës shtetërore. Në Gjimnazin “Skënderbeu” nga gjithsej 194 kandidatë, testin e maturës e kanë kaluar 119 prej tyre, apo 71.13 %, ndërsa në IAAP “Feriz Guri e vëllezërit Çaka”, nga gjithsej 24 maturant të testuar, 8 prej tyre e kanë kaluar atë apo 33.33 %. Ndërkaq, nga të dhënat e publikuara, në këtë afat, del se në nivel komunal, kalueshmëria është 66.97 %.

Ndërkaq, në afatin e gushtit, të mbajtur më 31 gusht 2024, nga gjithsej 51 maturant sa iu kanë nënshtruar testit, 32 prej tyre kanë arrit rezultat pozitiv. Në Gjimnazin “Skënderbeu” nga gjithsej 35 maturant, testin e kanë kaluar 23 prej tyre (65.71%) e në IAAP nga 16 maturantë, atë e kanë kaluar 9 prej tyre ose 56.25 %.

Testi i Arritshmërisë 2024, është mbajtur me nxënësit e klasave të nënta dhe atë në dy pjesë. Pjesa e parë është mbajtur më 25 qershor 2024, në lëndët mësimore: Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Histori dhe Gjeografi, dhe pjesa e dytë e mbajtur më 28 qershor 2024, në lëndët mësimore: Matematikë, Informatikë, Fizikë, Kimi dhe Biologji.

Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët “ Emin Duraku” nga Kaçaniku ka arritur rezultatin më të mirë duke u radhitur e para me shkollë të kalueshmërisë prej 49.12

	<p>% Shkolla e dytë është radhitur “Ali Asllani” nga Doganaj me 48.02 % , e treta “Idriz Seferi” nga Bobi me 47.59 % , etj. Ndërsa në nivel komunal, është arritur kalueshmëria në shkallë prej 43.66 %.</p>
<p>2.3 Trajnimi i mësimitdhënësve sipas fushave kurrikulare dhe furnizimi i shkollave me material pedagogjik dhe tekste shkollore</p>	<p>Trajnimet e vazhdueshme kanë qenë një komponentë e rëndësishme që kanë ndikuar pozitivisht në performancën e mësimitdhënësve, ndërkaq kualifikueshmëria në shkallë 100 % e stafit arsimor, në shkollat e fillore e të mesme të ulëta dhe shkollat e mesme të larta, po ashtu është një tregues dhe faktor që ndikon në rritjen e rezultateve dhe efikasitetin në mësimitdhënie e nxënie.</p> <p>Me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale të mësimitdhënësve, gjatë muajve qershor – korrik 2024, 61 mësimitdhënës të nivelit 6-9 (mesëm të Ulët) e kanë vijuar trajnimin me temë: “Zhvillimi i të menduarit kritik dhe kreativ tek nxënësit” dhe 31 mësimitdhënës të nivelit 1 - 5 (fillor) e kanë vijuar trajnimin me temë: “Plani individual i Arsimit - Planifikimi sipas nevojave të nxënësve me nevoja të veçanta, hartimi i planit individual arsimor për nxënësit me aftësi të kufizuar”.</p> <p>Trajnimi është organizuar nga Drejtoria e Arsimit, ndërkaq është mbështetur me 3,320 (tremijë e treqind e njëzet) euro, nga buxheti i Kmunës.</p> <p>Drejtoria e Arsimit, me kohë ka bërë furnizimin e shkollave me materiale pedagogjike e materiale tjera të nevojshme, ndërkaq edhe sivjet, sikurse edhe vitin e kaluar, Ministria e Arsimit nuk ka bërë furnizimin e nxënësve me libra falas, ndërsa ka bërë subvencionimin e tyre me nga 80 euro nxënësit e nivelit 1 – 5, dhe me nga 110 euro ata të nivelit 6 – 9, por jo edhe ata të nivelit para fillor.</p>
<p align="center">3.Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit i bazuar në transparencë dhe llogaridhënie – Funksonimi i organeve të shkollës</p>	

<p>3.1 Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit arsimor</p>	<p>Krijimi i disiplinës dhe rendit shkollor është bazë për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar duke zhvilluar një sistem funksional në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ngritja e nivelit të përgjegjësisë së drejtorëve të institucioneve shkollore për një shkollë moderne me nivel të lartë dhe edukim cilësor e po ashtu edhe ngritje e performancës së koordinatorëve të cilësisë dhe në përgjithësi të mësimdhënësve për një sistem efikas arsimorë.</p>
<p>3.2 Funksionimi i organeve të shkollës: Drejtori/zëvendësdrejtori i shkollës, Këshilli Drejtues i Shkollës, Këshilli pedagogjik/Këshilli i arsimtarëveAktivevet Profesionale, Task Forca në nivel shkolle e DKA, Koordinatorët e cilësisë, Këshilli i prindërve e Këshilli i nxënësve dhe Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisje dhe Mosregjistrimit dhe Këshilltari i karrierës, në nivel të ShFMU-ve.</p>	<p>Ngritja e nivelit të përgjegjësisë, koordinimi dhe ndarja e punëve e përgjegjësive në përputhje me rolin dhe kompetencat e organeve të shkollës.</p> <p>Promovimi i mësimdhënies dhe avansimi i të gjitha fushave të cilësisë, respektivisht përmirësimi i mjedisit mësimor dhe kushteve të punës e njëkohësisht zvogëlimin në minimum të braktisjes së nxënësve në shkollë</p> <p>Ndërkaq Koordinatorët e cilësisë janë angazhuar për sigurimin e cilësisë përmes procesit të planifikimit gjithëpërfshirës ku janë pasqyruar nevojat dhe prioritetet e shkollave, funksionimin efikas dhe zbatimin e planit për zhvillimin e cilësisë.</p> <p>Këtë vit është caktuar edhe një Këshilltar i karrierës, pozitë e re sipas politikave të MASHT-it, ku i njëjti është caktuar të punojë në ShFMU “Emin Duraku” në Kaçanik, por mbulon edhe disa shkolla të tjera të mesme të ulëta.</p> <p>Ekipet për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit si mekanizëm parandalues ndaj braktisjes është angazhuar për mundësi të barabarta për të gjithë në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë.</p> <p>Ndërkaq, edhe gjatë vitit të kaluar Ekipi Komunal për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta ka identifikuar dhe vlerësuar 48 fëmijë me nevoja të veçanta, sipas kërkesave të prindërve. Për rastet e vlerësuar janë dhënë rekomandimet përkatëse si: sigurimi i asistëntes, sigurimin e transportit etj. e për disa raste të tjera është rekomanduar qëndrimi i tyre në Qendrën Burimore në Prizren.</p>

4. Investimet në infrastrukturën shkollore

4.1 Përmirësimi i infrastrukturës shkollore
Furnizimi i shkollave me pajisje shkollore

DKA edhe gjatë vitit që e lam pas, është angazhuar për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e procesit mësimor dhe ngritjen e cilësisë në arsim. Segment i rëndësishëm është edhe ndërtimi i objekteve shkollore, zgjerimi i hapësirave dhe furnizimi me inventarë, kabinete shkollore e mjete të nevojshme për funksionimin e institucioneve shkollore e po ashtu edhe ndërtimin e palestrave sportive.

Në SHFMU “Jusuf Gërvalla” në Biçec është bërë ndërtimi i Palestrës sportive, ndërsa janë investuar 313.000 euro nga buxheti i Komunës. Palestra është kompletuar/pajisur me mjete e pajisje sportive nga MASHTI.

Në ShFMU “Agim Bajrami” në Stagovë është realizuar projekti “Rregullimi i kulmit në objektit shkollor” në vlerë 29.948 euro.

Në SHFMU “Nazmi Osmani” në Elezaj ka përfunduar me sukses projekti “Izolimi i jashtëm dhe zbatimi i masave të efijencës në vlerë 77.777 euro.

Projekti “Ndërtimi i sallës së edukates fizike në ShFMU” Idriz Seferi” në Bob, është project dy vjeçar, për të cilin do të shpenzohen gjithsej 367.000 euro, mjete nga buxheti komunal, ndërsa gjatë vitit 2024 janë investuar 200.000 euro.

Në bashkëpunim me MASHTI-n ka filluar ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Rekë, ndërsa projekti për ndërtimin e çerdhes tjetër në Kaçanik të Vjetër i cili do të financohet nga Bashkimi Evropian është prolonguar për vitin 2025. Arsyeja e shtyerjes së fillimit të punimeve është për shkak të masave të vendosura ndaj Kosovës.

Lidhur me projektin “Ndërtimi i shkollës “Emin Duraku” në Kaçanik, janë kryer të gjitha procedurat që i takojnë komunës duke përfshirë edhe lëshimin e Lejes për ndërtim, por tani mbetet në vullnetin e MASHTI-t për të vazhduar me procedurat e ndërtimit.

	<p>Për paisje të shkollave me tabela digjitale janë shpenzuar 8950 euro</p> <p>Për paisje të shkollave me kompjuter janë shpenzuar 9344 euro</p> <p>Për vendosjen e roletave dhe perdeve në shkolla, janë shpenzuar 28.919 euro</p> <p>Për renovimin e hapësirave shkollore, janë shpenzuar 22.000 euro.</p> <p>Për furnizim të shkollave me pelet, janë shpenzuar 25.669 euro</p> <p>Nga subvencionet në arsim, janë ndarë 41 bursa për student në vlerë 500 euro për student.</p>
<p>4.2 Sigurimi i transportit për nxënësit e IAAP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” dhe të tjerë</p>	<p>Edhe këtë vit shkollor 2023-2024 sikurse edhe vitin e kaluar, Drejtorja e Arsimit është duke i mbuluar/subvencionuar 100 % shpenzimet e transportit/bartjen për të gjithë nxënësit e Institucionit Arsimor dhe Aftësues Profesional (IAAP) “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka”. Afër 14 mijë euro është shuma mujore e shpenzuar për mbulimin e shpenzimeve e të gjithë nxënësve të shkollës profesionale, të cilët udhëtojnë nga vendbanimet e tyre e deri në shkollë dhe anasjelltas, dhe nxënësve të lokaliteteve të fshatit Gllloboçicë, Kotlinë, Ivajë dhe Gajre të cilët vijnë në mësimet në Gjinnazin “Skënderbeu” në Kaçanik dhe nxënësve të shkollave fillore të cilët udhëtojnë nga fshati Llanishtë në shkollën “Emin Duraku” në Kaçanik, Semajë në shkollën e Elezajve dhe Sllatinë në shkollën e Doganajve. Ndërkaq, është 700 euro shuma mujore që shpenzohet për mbulimin e udhëtimit të nxënësve/fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët udhëtojnë në relacionin Ferizaj – Prizren (Qendrën burimore) dhe anasjelltas.</p>

4.3 Kontrata kolektive- pajtimet gjyqësore	Drejtoria komunale e Arsimit, ka arritur pajtime gjyqësore me përfaqësuesit ligjor të mësimdhënësve, për obligimet që dalin nga Kontrata kolektive e arsimit. Me arritjen e pajtimeve gjyqësore, deri tash kemi kursyer qindra-mijëra euro nga bugjeti i komunës ndërsa vetëm gjatë vitit 2024 janë paguar 542.887.29 euro.
--	---

Drejtoria per Bugjet dhe Financa

DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCA

Mbështetur në organizimin dhe strukturimin e Komunave sipas Rregullores 2007/30 – Mbi ndryshimet e rregullores 2000/45, Mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, si dhe nenit 84. të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Drejtoria per Buxhet dhe Financa në punën dhe aktivitetin e saj gjatë vitit 2024 në bazë të kompetencave dhe përgjegjesive te sajë **ka zhvilluar aktivitetet si vijon:**

Menaxhimi, mbikëqyrja e të gjitha operimeve financiare së bashku me procedurat e ekzekutimit të buxhetit të komunës në pajtim me LMFPF, LFQL dhe dispozitat e tjera ligjore; asistenca per Kryetarin e Komunës dhe Komitetin për Politikë dhe Financa në përgatitjen e Buxhetit vjetor të komunës, këshillimi dhe komentet mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me buxhet, si dhe kordinimi dhe bashkëpunimi i ngushtë për të gjitha aktivitet, mbajtjen e të gjitha llogarive në komunë, në bashkëpunim me Thesarin dhe përgatitjen e raporteve financiare, për një proces transparent buxhetor, të gjitha këto, me një shkallë të lartë të mbikëqyrjes së të gjitha drejtorive; menaxhimin me pagesat në Thesar, mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit, inkasimin e drejtpërdrejt të hyrave vetjake komunale nga taksa obliguesit, përfshirë edhe tatim në pronë; dhe punë të tjera të caktuara nga kryetari i Komunës dhe të përcaktuara me ligj.

1. SEKTORI I FINANCAVE DHE BUXHETIT:

CASH PLAN-i

Bazuar në Rregulloren (MFPT) NR.01/2022 për alokimin e fondeve, e cila përcakton procesin për alokimin e fondeve sipas LMFPF-së dhe Ligjit vjetor për Buxhetin e Republikës së Kosovës, në fillim të vitit 2024 është përgatitur Kesh Plani komulativ për të gjitha programet, nën-programet e Organizatës Buxhetore – Komuna Kaçanik, është finalizuar sipas ndarjeve buxhetore të Ligjit të Buxhetit dhe planifikimit për zotimin përkatësisht shpenzimin e tyre.

BARTJA E MJETEVE TE PASHPENZUARA NGA VITIT 2023 NE VITIN 2024:

Pergatitja e materialeve per bartje te mjeteve te pashpenzuara-tejkalimet nga te hyrat vetanake te vitit 2023 ne vitin 2024. Keto mjete pritet te destinohen kryesisht per Investime Kapitale pra shtohen investimet e vitit 2025 per shumë totale te bartur e cila behet e ditur me rastin e konsolidimit te Pasqyrave Vjetore Financiare te vitit 2024 nga niveli qendrorë.

RAPORTET E SHPENZIMEVE

Sipas afatit të paraparë ligjorë është hartuar Raporti Vjetor Financiar per perfundimin e vitit fiskal 2024 per MFPT. Ky raport eshte derguar nga Drejtoria e Financave para dates 30.01.2025 në Ministrinë e Financave, Punes dhe Transfereve dhe i njëjti ne seancën e muajit shkurt 2025 do te dërgohet per shqyrtim dhe diskutim ne Asamblene Komunale.

Poashtu, përgjatë vitit 2024 janë përgatitur raportet tre mujore financiare per periudhen janar-mars; prill-qershor, korrik shtator dhe tetor-dhjetor 2024, ku këto raporte janë dërguar në Asamblenë Komunale për diskutim dhe shqyrtim të mëtejme.

Për të arritur një transparencë buxhetore, gjitha raportet e hartuara kanë përmbajtur shënime të hollësishme apo analitika për shpenzimet e ndodhura.

Në vijim në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur aktivitetet e zakonshme të realizuara gjatë vitit fiskal 2024:

- Përgaditjet për nisjen e vitit fiskal 2024;
- Plotësimi i formularëve me emërimet dhe flëtëdeponimet e nënshkrimeve për autorizuesit e programeve/ nënprogrameve buxhetore dhe zyrtarëve me qasje në modulet e SIMFK-s (FreeBalance);
- Dorëzimi i listës së përdoruesve me qasje në SIMKF (FreeBalance) gjatë vitit fiskal 2024;
- Përgaditja e Raportit Vjetor Financiar 2023 ;
- Përgaditja dhe përpilimi i planit të zotimeve dhe planit të shpenzimeve/ rrjedha e parasë së gatshme sipas planifikimeve mujore;
- Raportimi mujor i obligimeve kontraktuale dhe detyrimeve te papaguara në Departamentin e Thesarit;
- Barazimi mujor me Departamentin e Thesarit për të hyrat dhe daljet (shpenzimet) e gjitha kategorive ekonomike- procesi i pajtueshmërisë së librave kontabël (rikonsilimi);
- Plotësimi i ‘Pyetësorit të vetë-vlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm’;
- Ndërmjetësimi dhe prezantimi i lëndeve përpara ekipës së Zyrës Kombëtare të Auditimit, që auditon dhe përgadit raport auditimi me të gjeturat dhe rekomandimet në Komunën e Kacanikut
- Deklaratat për disponueshmërinë e mjeteve financiare për nisjen e procedurave të prokurimit për Zyren e Prokurimit;

- Procesimi i ndryshimeve në listën e pagave, bazuar në kërkesat e Zyres së Personelit;
- Operacionet e brendshme financiare, pranimi i kërkesave nga drejtoritë komunale, zotimet dhe kërkesat për blerje; ekzekutimi i shpenzimeve sipas kodeve të duhura të planit kontabël 2024
- Komunikimi i vazhdueshëm me Departamentin e Thesarit dhe Departamentin e Buxhetit (MFPT) përmes shkresave dhe kërkesave të ndryshme lidhur me operacionet e brendshme organizative (kërkesa për bartje të mjeteve të pashpenzuara gjatë periudhave fiskale, kërkesa për regjistrime të përfituesve, kërkesa për alokim të të hyrave vetanake, participimeve e donacioneve, kërkesa për anulime e korigjime, kërkesa për transfere etj.
- Raportimi dhe informimi në baza ditore e javore për ZKA- në dhe mbajtësit e autorizuar të programeve buxhetore (ekzekutivin komunal) lidhur me të hyrat dhe daljet (shpenzimet) e njësive të tyre;
- Përgaditja e propozim buxhetit të vitit 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026 e 2027;
- Përgaditja e dokumenteve më të dhëna financiare në formate të ndryshme (excel, pdf, word) për publikim në ëeb faqen e Komunës së Kaçanikut- publikime të nevojshme për transparence buxhetore ndaj qytetarëve të cilat vlerësohen edhe nga organizata joqeveritare (KDI, Instituti GAP);
- Evidentimi dhe regjistrimi vjetor i pasurive jofinanciare komunale;
- Përgaditja e raporteve financiare tremujore (TM1, TM2, TM3).
- Përfundimi i vitit fiskal 2024.

SHPENZIMET - ÇERTIFIKIMI DHE APROVIMI I PAGESAVE:

Shpenzimi i parasë publike kërkon një kontrollë të mirë të ndjekjes së procedurave dhe ekziston rregullore e veçantë **“RREGULL FINANCIARE NR.01/2013/MF – SHPENZIMI I PARAVE PUBLIKE”** përmes së cilës përveq tjerash sigurohet kontrolli i brendshëm si proces integral që ndikohet nga udhëheqësit dhe personeli i njësisë dhe ka për qëllim për të dhënë bindje të mjaftueshme që duke synuar kah realizimi i misionit të njësisë, janë duke u arritur këto objektiva të përgjithshme:

- a. Ekzekutimi i rregullt, etik, efikas dhe efektiv i operimeve;
- b. Plotësimi i obligimeve të llogaridhënies;
- c. Veprimi në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme;
- d. Mbrojtja e burimeve nga humbja;

Bazuar në këtë rregullore dhe procedurat tjera ligjore, gjatë vitit 2024 janë përfunduar të gjitha punët rreth shpenzimit të buxhetit komunal si në vijim:

Mallra dhe Shërbime:

-Totali i Mallrave dhe Shërbimeve (1302 lende)për vitin 2024- 1,430,944.24 €

Komunali:

-Totali i Komunali(1120 lende)për vitin 2024– 200,561.90 euro

Subvencionet dhe Transferet:

-Totali i Subvencionet (389 lende)për vitin 2024 – 507,424.51 euro

Investime Kapitale:

-Totali i Investime Kapitale (256 lende) për vitin 2024- 3,436,778.36 euro

Gjithësej pagesat e gjithave kategorive të shpenzime të cilat janë çertifikuar dhe aprovuar janë **3,067** pagesa të cilat kapin shume prej **5,575,709.01euro** pa perfshire kategorinë e pagave dhe mëditjeve.

REGJISTRIMI I TE HYRAVE VETANAKE:

Përveç Granteve Qeveritare, Donacioneve të ndryshme dhe burimeve tjera, të Hyrat Vetanake janë burim tejet i rëndësishëm në kontestin e financimit të aktiviteteve të ndryshme komunale.

Pagesat apo pranimet e mjeteve nga qytetarët me rastin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme nga zyrtarët komunal dhe me rastin e pagesave të taksave dhe tatimeve, janë realizuar në dy mënyra:

- a) Pagesat në trezor shuma, e secilës pagesë që ka vlerë nën 10 (dhjetë) euro dhe
- b) Pagesat në llogarinë bankare, shuma e së ciles pagesë që ka vlerë mbi 10 (dhjetë) euro.

Gjatë vitit 2024 nga zyrtarët e Drejtorisë së Financave, me azhuritet është bërë pranimi dhe barazimi i mjeteve nga trezori i Shck-së, Participimet në Shëndetësi (QKMF), të hyrat nga zyret e vendit, të hyrat nga antarësia në bibliotekë dhe barazimet me arkëtarët e këtyre trezorëve.

Për çdo ditë janë siguruar raporte ditore nga Sistemi i Free-Balanc-it mbi pagesat e të Hyrave vetanake të paguara përmes llogarive bankare, është bërë klasifikimi i të Hyrave për secilën Drejtori veç e veç a mbi pagesat e pranuar nga palë të ndryshme, etj.

Në periudha tremujore është bërë barazimi i rregullt mes zyrtarit të regjistrimit të të hyrave vetanake dhe departamenteve tjera që kanë inkasuar mjete.

PERGATITJA E BUXHETIT 2025 – 2027

Për çdo vit me fillim të muajit maj të vitit aktual fillojnë punimet rreth hartimit të Buxhetit komunal për vitet vijuese. Fillimisht pas hartimit të Kornizës Qeveritare Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2025 - 2027 të Ministrisë së Financave dhe sipas udhëzimeve të lëshuara nga Ministria është filluar me fazën e parë të përgatitjes së buxhetit komunal për vitin 2025 dhe vlerësimeve për vitet 2026 – 2027.

Hapat rreth procesit buxhetor të cilat janë ndjekur gjatë vitit 2024 për përgatitjen e Buxhetit 2025 dhe vlerësimeve për periudhën afatmesme 2026 -2027 kanë qenë:

Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2025-2027, ku fillimisht janë zhvilluar degjime apo diskutime të brendshme mes Kryetarit dhe ekzekutivit komunal, pastaj janë caktuar dhe zhvilluar Degjime Publike me qytetarët e komunes për Kornizën Afatmesme Buxhetore. Pas finalizimit të KAB-it komunal është shqyrtuar në mbledhjen e KPF-es pas Aprovimit nga Asambleja komunale në seancën e zhvilluar, pastaj ky dokument tejet strategjik komunal është dërguar në Ministrinë e Financave Punes dhe Transfereve.

Pas kësaj faze janë zhvilluar edhe disa takime me qytetarë dhe grupe tjera të interesit, me pas para datës 30 shtator 2024 është shqyrtuar dhe miratuar me shumicë votash Buxheti për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026 – 2027.

2. SEKTORI I TATIMIT TË PRONËS:

ZYRA E TATIMIT NË PRONË

Përveq punëve të përditshme Zyra e Tatimit në Pronë në bazë të ligjit Nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme në Kosovë, si dhe Ligji NR. 08/L-224 Për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit NR. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, që nga fillimi i vitit 2024 jemi angazhuar me faturimin dhe ngarkesat për tatim për vitin 2024.

Shpërndarjen e faturave të tatimit në prone të kontraktuara me Postene Kosovës dhe të njëjtit më dt.11.03.2024 kishin pranuar një numër prej 6378 faturash nga MF-Departamenti i tatimit në prone. Vlera e këtyre faturave ishte 551.010,30 € dhe ato 178.722,67€ për objekte dhe 372.287,63€ për parcela.

Për vitin 2024 vlenë të theksohet se ka filluar ngarkimi me tatim edhe për pronat - parcelat bujqësore.

Inkasimi gjatë vitit 2024 ishte 310.632,83€ për objekte dhe parcela.

Me ndryshimet ligjore kishte ndryshuar edhe afati i ankesave qe mund te behej gjat tërë vitit kerkesa per korigjim e gjat vitit 2024 kemi pranuar gjithsejt 32 ankesa për objekte dhe 58 ankesa për parcela te cilat janë shqyrtuar dhe vendosur nga Zyra e Tatimit në pronë. Nga fillimi I muajit prill kemi fillu me pranuar ankesa për tatim në pronë ku deri më dt.31.12.2024 kemi pranuar gjithsejt 90 ankesa,32 për objekte ndersa 58 per parcela,të cilat janë shqyrtuar ku janë aprovuar 89 prej tyre ndersa 1 prej tyre është refuzuar. Të gjitha ankesat janë shqyrtuar brenda afatit të paraparë ligjorë.

Poashtu jemi njoftuar dhe kemi punuar për auditimin Të hyrat e Tatimit në pronë. Gjatë muajit shtator kemi pranuar nga Ministria e Financave,Punës dhe Transfereve-Departamenti i Tatimit në pronë Raportin mbi vlerësimin e përgjithshëm për prona bujqësore dhe pyjore Nr.370/2024 dt.16.09.2024.

Janë realizuar edhe inspektimet vjetore nga Departamenti i Tatimit ne prone në Ministrinë e Financave,Punës dhe Transfereve për të cilinin inspektim kemi pranuar raportin ne muajin tetor.

Gjat muajit Nentor është aprovuar Vendimi për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e palujtshme për vitin 2025 .

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Sektori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes se Mjedisit

- **Këkesa për kushte ndërtimi 43**

1.1 Kushte ndërtimore të miratuara 43

- **Kërkesa për leje ndërtimi 28**

2.1 Të miratuara 28

2.2 Në procedurë 15

2.3 Nga Lejet e Ndërtimit, të cilat janë lëshuar: 7 i takojnë kategorisë së dytë

2.4 Leje për vendosjen e paneleve solare 5

- **Kërkesa për Legalizim 92**

3.1 Të miratuara 53

3.2 Në procedurë 39

- **Kërkesa për ndërrim destinim të tokës Bujqësore në Ndërtimore 52**

4.1 Kërkesa të miratuara 49

4.2 Kërkesa të refuzuara 3

- **Drejtoria ka lëshuar edhe:**

5.1 Leje mjedisore komunale 12

5.2 Njoftime me PZHK 19

5.3 Pëlqime paraprake për bujqësi dhe grante 3

- **Përditsimin sistemit të adresave**

6.1 Rreth 350 numra të vendosura në sistemin Aris

6.2 Verifikimi i objekteve të reja në Komunën e Kaçanikut 60

Drejtoria ka kryer punë për realizimin e projekteve kapitale sikurse:

Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve Urbane - Kaçanik viti 2024

1 Asfaltimi i rrugëve ne Kaçanik				
Nr.		Nj.m.	gjersia	Kubza
1	Rrugica te deg.i rruges"B.62 A.Bajrami" Bob	133	3	
2	Rruga "Tefik Raka"	0	3	240
3	Rruga "Xh.Femi Lladrovci" (Burrnikt)	252	3	
4	Rruga "Isa Buletini"	58	3	
5	Rruga "F. Berisha" Runjevë	253	3	
6	Rrugica te Kisi (Dushkaj)	65	3	
7	Rrugica te Xhamia (Dushkaj)	0	3	160
8	Trotuari te Kisi (Dushkaj)	0		65
9	Rrugica te Tirollt (Dushkaj)	0		166
10	Rruga "Emin Duraku" (Llanishtë)	118	3	
11	Rruga "Elmaz Axhami" (Llanishtë)	155	3	
12	Rruga " Sh.Kuka" (Degëzimi I)	174	3	
13	Rruga " Sh.Kuka" (Degëzimi II)	136	3	
	Gjithsejt rruge te asfaltuara	1344.00		
	Vërejtje : Shumat Totale			
	Rruge te Asfaltuar gjithsejt meter gjatesi... ..1344.00 m , x 3.00=4032.00			
	Rruge pa Asfaltuar tampon gjithsejt meter..326.00 m x3.00=978.00			
	Rruge pa Asfaltuar me kubza gjithsejt meter ...		305.00mx3.00=915.00	

Investimi i paraparë për këto rrugë 147 667.00 €, ndësa të kryera janë 122 313.60 €

- **Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve Rurale Kaçanik:**

8.1 Investimi i paraparë për këto rrugë 276 480.36 €, ndësa të kryera janë 275 157.28 €

Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve Rurale - Kaçanik viti 2024

Asfaltimi i rrugëve ne fshatin - DUBRAVE				
Nr.		Nj.m.	gjersia	Kubza
1	Rrugica te Hajdart deg.i rruges"B.25 Maji"	105	3	
2	Rrugica te rruga " Isuf Vishi"	220	3	
3	Rrugica te rruga "R. Kasa"	246	3	
4	Rrugica te rruga "Haki Vishi"	167	3	
5	Rrugica te rruga "Ziber Vishi"	155	3	
6	Rrugica te Memajt Xhamia deg.i rruges"B.25 Maji"	117	3	
7	Rrugica te Memajt "Qlirimtare"	115	3	
8	Rruga " Shullani"	115	3	
9	Rruga "O. Kuka"	0	3	
10	Rruga "T.Topalli"	120	3	
11	Rruga "Shaban Topalli" me tampon	0	4	305
	Ruga " Shkelzen Haradinaj" lagja Krivenjevë	0		2090
12	Rruga " vatra shqiptare" me kubza	0	3	97
		1360		2492.00
Asfaltimi i rrugëve ne fshatin - Begrace-Stagove				
1	Rruga "2 Shtatori"	105	3	
2	Rruga "S. Gashi"	85	3	
3	Rruga " F.Mani"	292	3	
4	Rruga "T. Jaha"	89	3	
	Gjithsejt rruge te asfaltuara	571.00		
Asfaltimi i rrugëve ne fshatin - Strazhe				
1	Rruga " Beteja 8 Marsi"	215	3	
2	Rruga " Strazha Luma"	198	3	
	Gjithsejt rruge te asfaltuara	413		
Asfaltimi i rrugëve ne fshatin - ELEZAJ				
1	Rruga "Nazmi Osmani" (te Invalidi)	80	3	1360
2	Rruga "Nazmi Osmani" (te I.Doda)	170	3	571
3	Rruga "Nazmi Osmani" (te J. Terziu)	125	3	413
	Gjithsejt rruge te asfaltuara	375		375
				2719
Rruge te Asfaltuar gjithsejt meter gjatesi.....				2719.00 m
Rruge pa Asfaltuar vetem me tampon gjithsejt meter				2395.00 m
Rruge pa Asfaltuar me kubza gjithsejt meter				97.00 m

- **Ndërtimi i shtretërve te lumenjeve dhe perroskave**

9.1 Rregullimi i perroit në lagjen Kovaqi, Soponicë L= 115.00 m'

9.2 Rregullimi i perroit te shkolla, Kovaqec, L= 45 m'

9.3 Rregullimi i perroit në fshatin Stagovë, L= 140 m'

9.4 Rregullimi i perroit në lagjet Burrniku, Koraqi, Kupina, Muça, Kovaqec L= 210 m'

9.5 Rregullimi i prronit në lagjen Rakoc, Kaçanik L= 125 m'

Investimi i parapare per rregullimin e perrenjeve 141 158.88 €, ndersa te kryera jane 103 500 €

- **Rrenimi i objekteve dhe mbyllja e deponive ilegale**

10.1 Per vitin 2023 janë parapare 40 000€, ndërsa janë kryer 40 000€

- **Ndërtimi I Urës mbi lumin Neredime**

11.1 Investimi i parapare për ndërtimin e Urës 68 489.54 €, ndërsa te kryera janë 26 027.54 €

- **Ndërtimi i Çarshisë së vjetër**

12.1 Investimi ne Çarshinë e vjetër 10 000 €, ndërsa te kryera afër 10 000 €.

Për vitin 2024 janë paraparë investime për projekte 683 795.78 € ndërsa janë realizuar 576 998.42 €

- **Drejtorja ka bër menaxhimin e projekteve edhe të drjetorive të tjera:**

14.3 Mirebajtja dhe renovimi I Objekteve shkollore

14.4 Ndertimi I kanalit per ujitje

Vlen të theksohet se si drejtori jemi ballafaquar me ndërrimet e destinimit për parcela të ndryshme, meqenëse PZHK-ja është në proces në MMHI.

Sektori i Kadastrit **Raporti i punës për vitin 2024**

Gjatë vitit paraprak pranë sektorit të kadastrit kemi pranuar dhe janë regjistruar 5281 lëndë duke i shtuar edhe lendet e bartura nga viti 2023 afersisht 250, që në total janë 5731, ku nga ky numër janë zgjidhur 5731 lëndë kryesisht të RDPP-së që kanë të bëjnë me bartje të pronave, ndarjet fizike dhe bashkim të parcelave si dhe legalizime të objekteve të pranuar nga ana e palëve fizike apo juridike.

Ky sektor ka vazhduar me përpikmëri të bëjë implementimin e ligjit mbi Kadastrin me NR.08/L-237 i cili ka hyre në fuqi me 09.01.2024 dhe plotësimin të tij me 11 Udhezime Administrative si dhe ligjit mbi hipotekat Nr.2004/4.

Nga lëndët sa u përket Çertifikatave, Fletët Poseduese, Kopjet e Planit, Kordinatave gjeodezike etj të gjithat janë të kryera dhe të dorëzuara brenda afatit ligjor përkundër fluksit të madh të kërkesave nga palet përfshir kryesisht mërgimtarët që don të thot se nuk ka pasur ngecje në punë dhe palët kanë qenë të shërbyer në afatin optimal.

Në vazhdim kemi paraqitur llojet dhe sasin e kërkesave për secilen kategori veq e veq të cilat gjatë ekzekutimit në total kanë gjeneruar të hyra afërsisht në shumën prej 75,091.50 € (euro) dhe atë:

= Shërbimet e ofruara sipas kërkesave të palëve:

• Fleta poseduese	2265 lëndë
• Kopje të planit	433 lëndë
• Çertifikata të gjendjes së pasurisë	602 lëndë
• Koordinata gjeodezike	489 lëndë
• Identifikime	00 lëndë
• Të ndryshme (AKP, Gjykatat, K.K Kaçanik etj.)	25 lëndë
• Regjistri i RDPP-së	1469 lëndë

= Regjistri i RDPP-së :

Lloji i Lendes ne RDPP	Totali
Bartja e posedimit - Ndarje fizike	10
Bartja e posedimit - Blerje	310
Bartja e posedimit - Dhurim	539
Bartja e posedimit - Këmbim	20
Bartja e posedimit - Shpronësim	17
Bartja e posedimit - Trashëgimi	102
Bartja e posedimit Aktgjykim dhe fitime tjera të posedimit	52
Bartja e pronësisë - Blerja	22
Bartja e pronësisë - Dhurata	3
Bartja e pronësisë - Trashëgimia	1
Bartja e pronësisë Aktgjykim dhe fitime tjera të pronësisë	2
Bashkimi	112
Bashkimi i personave të njejtë me ID te ndryshme	18
Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit	43
Fshirja e të drejtës së shfrytëzimit	2
Fshirja e ngarkesës tatimore sipas vendimit të ATK	1
Fshirja e Vërejtjes me kërkesë të palës	8
Modifikimi atributiveve të parces	270
Modifikimi i atributiveve të ndërtesës	1
Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale	13
Modifikimi i të drejtave	6
Ndarja	306
Regjistrimi (krijimi) i parcelës së re	1
Regjistrimi i hipotekës	37
Regjistrimi i ndërtesës	52
Regjistrimi i ngarkesës tatimore	4
Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës	3
Regjistrimi i qiramarrjes	3
Regjistrimi i servitutit I	2
Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit	4
Regjistrimi i vërejtjes me kërkesë të palës	4
Regjistrimi i vërejtjes me vendim të gjykatës	1
Regjistrimi i vërejtjes sipas kërkesave tjera	3

Është vazhduar me Implementimin e Kadastrit digjital, ku është punuar në barazimin e pjesës grafike të Operatit Kadastral me atë tekstual.

Është vazhduar me bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës në eliminimin e gjitha problemeve që kanë dalë gjatë punës së përditshme profesionale në këtë sektor, gjithashtu ky bashkëpunim është bërë edhe sa i përket trajnimit të mëtutjeshëm të personelit që është i angazhuar në kuadër të këtij sektori.

Në aspektin profesional është përkrahur Kuvendi Komunal në punët e shumë komisioneve siq janë: Komisioni për pranime teknike të projekteve, vlersimin e ofertave, etj.

Gjithashtu asistenca dhe bashkëpunimi profesional nuk ka munguar dhe ndaj institucioneve shtetërore siç janë: Agjencioni Kosovar i Privatizimit, Ministria e Infrastrukturës etj, ndërsa me informacione të ndryshme sipas kërkesës është përkrahur edhe Gjykata Komunale.

Sektorinë për qështje pronësore-juridike gjatë periudhës raportuese është marrë me punët dhe detyrat që i takojnë këtij Sektori dhe atë nga lëmia e uzripimit arbitrar të Pronës Komunale dhe asaj publike, Shpronësimit, Mbajtjes së evidences së Pronës Komunale si dhe mënyrat e rregullimit të mardhënjeve pronësore-juridike, informata dhe raporte për organe të ndryshme.

Në kuadër të legalizimeve kemi vazhduar me procesin e legalizimit të objekteve-ndërtesave dhe ekzekutimin e tyre në planet digjitale kadastrale dhe pjesen tekstuale të SIKTK-së sipas ligjit dhe akteve të tjera ligjore në fuqi mbi Legalizimet.

Duhet cekur gjithashtu se gjatë vitit 2024 kemi filluar edhe me ekzekutimin e Elaboratit të Shpronësimit të Autostrades Prishtine – Shkup, ku në anë grafike kemi arritur 80 % të ekzekutimit të ndryshimeve në planin kadastral ndërsa në anën tekstuale afër 60% e ekzekutimit të ndryshimeve në regjistrat kadastral. Gjithashtu lidhur me këto proces jemi në kontakte dhe bashkëpunime të vazhdueshme me Agjencionin Kadastral Të Kosovës dhe Departamentin e Shpronësimit pranë MMPH-së.

Gjatë viti 2024 gjithashtu është nënshkruar edhe marrëveshja ndërmjet komunës së Kaçanikut dhe Agjencionit Kadastral të Kosovës për vazhdimin e Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale – RIK edhe për 2 zona kadastrale në komunën tone të financuara nga projekti REGIP i Bankës Botërore.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjences

Hyrje

Raporti përmbledhës i punës njëvjeçare të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave ka për qëllim të raportimin për kryetarin e komunës si dhe informimin e opinionit publik për punën e drejtorisë për periudhën Janar-Dhjetor 2024. Është raport përmbledhës dhe paraqet punët e përgjithshme të kësaj drejtorie të cilat në një formë apo tjetër kanë ndikuar drejtpërdrejtë në jetën e qytetarit.

• PROJEKTE KAPITALE

Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike në kuadër të përgjegjësisë dhe aktiviteteve të saja edhe gjatë vitit 2024 është përkushtuar në realizimin dhe menaxhimin e projekteve kapitale brenda listës së buxhetit për investime kapitale për vitin 2024, i miratuar nga kuvendi komunal dhe projekteve kapitale të përfituara në bashkëfinancim me ministritë e ndryshme dhe fondin e përfituar nga Granti i Performancës komunale. Në bashkëpunim me Zyrën e kryetarit dhe të drejtorive tjera është angazhuar për implementimin dhe menaxhimin e projekteve të infrastrukturës rurale të cilat janë paraqitur si vijon:

➤ Ndërtim i rrugëve dhe objekteve të infrastrukturës publike

Gjatë vitit 2024 është vazhduar me implementimin e projektit “Ndërtimi i Objektivit për Zjarrëfiksa”-faza e II-të.

Poashtu nga lista e investimeve kapitale bashkëfinancim Ministria e Infrastrukturës është vazhduar me implementimin e projektit “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës ”Idriz Seferi”-faza e I-rë” si dhe është filluar implementimi i projektit “Rregullimi i rrugës Bob-Kulla e Hasanit”

Nr.	Emërtimi	Nr.
1	Ndërtimi i objektivit të Zjarrëfiksave-faza e II-të	1 projekt
2	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës”Idriz Seferi”-faza e II-të L=1347m	1 projekt
3	Rregullimi i rrugës Bob-Kulla e Hasanit L=2998m	1 projekt
	Total	3 projekte

• UJËSJELLËSI

Projekti “Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit”- është realizuar në këto lokacione sipas tabelës së poshtëshënuar.

Nr.	Emërtimi
1	Vazhdimi i rrjetit të ujësjellësit Φ 63 në rr.Dëshmorët e Kombit-Dushkajë L=600m
2	Vazhdim i rrjetit të ujësjellësit Φ 63 në rrugën “Selim Shehu” L=50m
3	Kaptimi i burimit dhe ndërtimi i odës akumuluese “Te Mrizi” -Ivajë e Vjetër
4	Shtrirja e gypit furnizues Φ 110 nga burimi -Ivajë e Vjetër deri në rrjetin furnizues të qytetit L=1800m
5	Vazhdimi i rrjetit primar furnizues të ujësjellësit Φ 75 deri te rezervuari i ri i fshatit Ivajë L=900m
6	Shtrirja e rrjetit sekondar të ujësjellësit Φ 50 në rr.”24 Marsi”-Ivajë L=800m
7	Punimi i depërtimit të gypit kryesor nën linjën hekurudhore të Ura e Konakut-Kaçanik

Total	4150m
-------	-------

- **Furnizim me gypa të ujësjellësit për bashkëfinancim në realizim të projekteve të rrjeteve të ujësjellësit**

Gjatë vitit 2024 është mundësuar furnizimi me gypa të ujësjellësit komuniteteve që kanë shprehur gatishmëri për bashkëfinancim në realizim të projekteve në rehabilitim të rrjeteve ekzistuese në lokalitetin e tyre. Janë furnizuar komunitetet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Gjatësia/m
1.	Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 63, për rrjetin e ujësjellësit në lagjen Trena- Begracë	600m
2.	Furnizimi me gypa të ujësjellësit 200m / Φ 63 dhe 100m/ Φ 75, për rrjetin e ujësjellësit në lagjen Zmak-Ivajë	385m
3	Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 50, për rrjetin e ujësjellësit në lagjen Hajdari-Rekë	210m
4	Furnizim me gypë 5/4 për KRU" Bifurkacioni" për nevoja të rrjetit të ujësjellësit të lagjes Topalli- Soponicë	300m
5	Furnizim me gyp Φ 110 për KRU" Bifurkacioni" për nevoja të rrjetit të ujësjellësit të lagjes Dalloshi dhe Tushaj-Soponicë	120m
6	Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 63, për rrjetin e ujësjellësit në lagjen Imishti-Dubravë	510m
7	Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 63, për rrjetin e ujësjellësit në lagjen Memaj-Dubravë	200m
8	Furnizim me gyp Φ 63 për KRU" Bifurkacioni" për nevoja të rrjetit të ujësjellësit në rr. "Idriz Seferi"-Kaçanik	480m
	Totali	2805m

- **KANALIZIMET FEKALE DHE ATMOSFERIKE**

Kemi vazhduar me realizimin e projektit "Ndërtim i rrjetit të kanalizimit fekal në fshatin Begracë"-projekti është kontraktuar për periudhën kohore të implementimit 2022-2024.

Nr.	Emërtimi	Gjatësia	Gjatësi e punuar/2024
1	Ndërtim i rrjetit të kanalizimit fekal në fshatin Begracë	18km	5538m
	Total		5538m

- **Rrjete të kanalizimeve fekale dhe atmosferike**

Në kuadër të kodit buxhetor "Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike" kontratë 2 vjeçare. Në vitin 2024 janë realizuar këto projekte:

Nr.	Emërtimi	Gjatësia/m
1	Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimit fekal në Runjevë-Lagje te Re përgjatë linjës së hekurudhës (TMK, Kemal Thaqi dhe përgjate hekurudhës-Lagje Re	264
2	Kanalizimi fekal në Dubrave-lagjja Vishaj-Kamishi /Te Shullani-vazhdim	430

3	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal te rr."Qendresa" dhe kyqja e rrjetit të lagjes Imishti me rrjetin e lagjes Memaj	798
4	Ndërtimi i rrjetit te kanalizimit fekal në rr."Mujedin Aliu"-Kaçanik i Vjetër	192
5	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal në lagjen Krraba-Stagovë	286
6	Ndërtim dhe sanimi i rrjetit të kanalizimit fekal te hekurudha Kaçanik i Vjetër	77
7	Ndërtimi i kanalizimi fekal në lagjen Kukaj-rruga kryesore	518
8	Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen Perzhaj-K.Vjetër	288
9	Ndërtimi i kanalizimit fekal përgjate rruges alternative në Biqec	1400
10	Ndërtimi i kanalizimit fekal në rr."Jehona Raka"-Dushkajë	34
11	Ndërtimi i kanalizimit fekal në rr."Faruk Begolli"-Begracë	367
12	Ndërtimi i kanalizimit fekal në Begrace-lagjja te Pompa Veda	332
13	Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Duraj	473
14	Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen Kukaj -faza II-të/degëzim	130
15	Ndërtimi i kanalizimit fekal në Dushkaje-te xhamia	230
16	Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen Berisha-Runjevë	96
17	Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen Shorra dhe Zharku-Biqec-faza I-rë	562
18	Ndërtimi i kanalizimit fekal ne rr. "Kemal Kolshi" –te Zalli Adrakes	80
19	Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen Dashi-Stagovë	276
20	Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen Luzha -Begrace	396
21	Ndërtimi i kanalizimit fekal në Lagje te Re-Kaçanik (familja Dubova)	102
22	Ndërtimi i kanalizimit fekal përgjate rruges alternative në Biqec-lagjja Sallahu	162
23	Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen Kurtaj-Gabrice	170
24	Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen Memaj-Dubrave	102
25	Ndërtimi i kanalizimit fekal në Doganaj-lagjja Shehler	250
26	Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen Hysaj-Stagovë	300
27	Ndërtimi i kanalizimit fekal te Restoran "Natyra"-Duraj	150
28	Ndërtimi i kanalizimit fekal në rr."Triumf Riza"-Stagove/ varrezat-puseta ekzistuese	323
29	Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen Trupaj-Kovaqec	102
30	Ndërtimi i kanalizimit fekal në rr."Drenica" dhe "Beteja e 25 Majit"-Provoli	993
31	Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen Muqaj-Kovaqec	138m
	Totali	10021m
	Ndërtim i rrjeteve të kanalizimeve atmosferike	Gjatësia/m
1	Ndërtimi i kanalizimit atmosferik në Runjevë-Lagje te Re	140
2	Ndërtimi i kanalizimit atmosferik Ø800-beton -lagjja Lama -Kaçanik i Vjetër	100
3	Ndërtim i kanalizimit atmosferik Ø315 ne fshatin Duraj	50
4	Ndërtimi i kanalizimit atmosferik te AMF-ja në K.Vjeter (Parku i lagjes)	52
5	Ndërtimi i kanalizimit atmosferik Ø800-beton/leshesa e rrugës Doganaj	25
6	Ndërtimi i kanalizimit atmosferik në trotuar Bajnice (Ø315 dhe Ø400)	108
7	Ndërtimi i kanalizimit atmosferik në rr."Lumnije Raka"- Dushkaje - Ø400	30
8	Ndërtimi i kanalizimit atmosferik Ø800-beton -lagjja Deda-K.Vjeter	25
9	Ndërtimi i kanalizimit atmosferik përgjatë rrugës "Ahmet Kaçiku"-Doganaj	1760
10	Ndërtimi i kanalizimit atmosferik përgjatë rrugës "Idriz Seferi"-Kaçanik	1325
11	Ndërtimi i kanalizimit atmosferik në lagjen Berisha-Runjevë	96

	Totali	3711m
--	---------------	--------------

Mirëmbajtje e rrjeteve ekzistuese të kanalizimeve fekale dhe atmosferike	
1	Vendosja e kapakeve të dëmtuar në pusetat ekzistuese të kanalizimeve f&v
2	Pastrim i pusetave aktuale në qytet (fekale dhe atmosferike)
3	Vendosja 12 kapakëve për puseta të kanalizimit në rr."Idriz Seferi"-Kaçanik
4	Pastrimi i kanalit të ujitjes në lagjen Provoliu-Soponicë
5	Rregullimi i kanalizimit fekal te lagjja Burnniku-Runjevë

• HAPËSIRA PUBLIKE

Këtë vit kemi realizuar 3 (tri) projekte në fushën e rregullimit të hapësirave publike. Kemi vazhduar me implementimin e projektit “Ndërtimi i Sheshit të Qytetit-faza e II-të”, projekt që po realizohet për periudhën kohore 2022-2024.

Si pjesë e Grantit të Performancës komunale përmes Marrëveshjeve të Bashkfinancimit me MAPL-në dhe Helvetas Säiss Intercooperation (projekti DEMOS) në kuadër të projekteve për rregullimin dhe ndërtimin e parqeve publike është bërë implementimi i dy projekteve: “Ndërtimi parqeve dhe hapësirave publike në lokacionet: Kaçanik i Vjetër dhe lagjja Hajdari- fshati Rekë” dhe “Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë së Qytetit”.

Nr.	Emërtimi	Projekte
1	Ridizajnimi i hapësirës së Parkut të Qytetit përballë Kalasë së Qytetit /2345m ²	1
2	Ndërtimi i Sheshit të Qytetit-faza e II-rë /3876.82m ²	1
3	Ndërtimi parqeve dhe hapësirave publike në lokacionet: Kaçanik i Vjetër/ 3457 m ² dhe lagjja Hajdari- fshati Rekë/ 3812 m ²	1
	Totali=13490.82m²	3 projekte

• PARKINGJE

Gjatë vitit 2024 kujdes i veçantë i është kushtuar krijimit të hapësirave të reja për parkingje publike. Janë lejuar shfrytëzimi i hapësirave për parkingje në këto lokacione:

Nr.	Emërtimi	Nr. i parkingjeve
1	Hapësira publike përballë Qerdhes së Qytetit	10
2	Hapësira publike në rr."Sali Bajra " përballë Sheshit të Qytetit	7
3	Hapësira publike në rr."Qamil Ilazi"-prapa kafeterise “Egzona”	12
	Totali	29

• NDRIÇIMI PUBLIK

Projekti kapital “Rregullimi i ndriçimit publik”- është në këto lokacione:

Nr.	Emërtimi i projektit /Lokacioni i punishtes	Gjatësia (m)	Nr.trupave
1	Rregullimi i ndriçimit publik lagjja Mulaku- përreth N2-deri te palestra	405	11
2	Rregullimi i ndriçimit publik lagjja Dashi fsh.Stagovë	2500	53
3	Rregullimi i ndriçimit publik rr. "Murat Lika" fsh. Strazhë (nga shkolla deri te lagjja)	1960	52
4	Rregullimi dhe renovimi i ndriçimit te kompleksi i varrezave të dëshmorëve	550	63
5	Rregullimi i ndriçimit publik në shetitoren III në Bulevardin "Ismail Raka" nga "Ura e Hazirit" deri te Xhamia e Dëshmorëve	680	30
6	Rregullimi i ndriçimit publik në shetitoren IV në Bulevardin "Ismail Raka" nga "Ura e Hazirit" deri te Xhamia e Dëshmorëve	680	30
	Totali	6775m	239

• Rrjete të ndriçimit publik në kuadër të projekteve tjera kapitale

	Emërtimi i projektit /Lokacioni i punishtes	Gjatësia	Nr.i trupave
1	Rregullimi i ndriçimit publik në rr."Idriz Seferi"-Kaçanik	1420	58
2	Rregullimi i ndriçimit publik në rr."Ahmet Kaçiku"-Doganaj	1625	49
3	Rregullimi i ndriçimit publik në hapësirat publike të parqeve në K.Vjetër dhe lagjen Hajdari- Rekë	445	27
4	Rregullimi i ndriçimit publik në hapësirën publike të Parkut të Qytetit përballë Kalasë së Qytetit	370	26
5	Rregullimi i ndriçimit publik në hapësirën publike te Sheshi i Qytetit	375	34
	Total	4235m	194

Edhe gjatë këtij mandati, kemi dhënë pëlqime për rregullimin dhe shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik në lagjen dhe fshatrat ku komuniteti është shprehur i gatshëm të vetëfinancojnë projektin.

Kemi dhënë pëlqime për rregullim të ndriçimit publik në:

- Rruga "Triumf Riza"-lagjja Krraba –Stagovë
- Rruga "Nerimane Guri"-Nikaj

• TROTUARE DHE SHTIGJE PËR ÇIKLISTA

Gjatë vitit 2024 në kuadër të investimeve kapitale janë ndërtuar edhe 3 projekte të trotuareve për këmbësorë dhe shtigjeve për çiklizëm. Përmes fondit të Grantit të Performancës komunale në përmes Marrëveshjes së Bashkfinancimit me MAPL-në dhe Helvetas Sëiss Intercooperation (projekti DEMOS) kemi implementuar projektin “Ndërtimi i trotuarit për këmbësor dhe shtegut për çiklista nga restorant “Natyra”-Fusha e Pajtimit

Nr.	Trotuare	Gjatësia/m
1	Ndërtimi i trotuarit për këmbësor nga restorant "Natyra"-Fusha e Pajtimit	1625
2	Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Idriz Seferi"-Kaçanik	1100
3	Ndërtimi i trotuarit për këmbësor në rr."Fadil Bunjaku"-faza -I	1560
	Totali	4285m
	Shtigje për çiklizëm	
1	Ndërtimi i shtegut për çiklizëm nga restorant "Natyra"-Fusha e Pajtimit	1625
	Totali	1625m

• **MENAXHIMI I MBETURINAVE**

- Implementimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027.
- Kemi asistuar si grup teknik në hartimin e Draft-Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për komunat e regjionit të Ferizajt dhe Gjilanit, ku bëjmë pjesë edhe ne si komunë.
- Me kompaninë private NT"Krasniqi" është lidhur Marrëveshje për periudhën njëvjeçare për operim në grumbullimin e mbeturinave në lokalitetet Begracë, K. Vjetër.
- KRM "Pastërtia"- njësi operative në Kaçanik ka zgjëruar operimin me mbulueshmëri të grumbullimit të mbeturinave edhe në lokalitetin Koxhaj dhe janë futur në shërbim ekonomi familjare të reja në zonat e operimit.
- Mbulueshmëria më shërbim të grumbullimit të mbeturinave në komunën e Kaçanikut është mbi 100%.

• **KOMUNIKACIONI RRUGOR**

Gjatë vitit 2024 kujdes i veçantë i është kushtuar sigurisë dhe krijimit të mundësive më të mira për pjesëmarrësit në trafik në rrugët lokale të komunës sonë, ku përmes kontratës "Rregullimi dhe mirëmbajtje e sinjalizimit horizontal dhe vertikal" jemi përkujdesur në:

- Shenjzimi i vijave horizontale në rrugë dhe vend parkingje
- Vendosi dhe mirembajtje e shenjzimit vertikal
- Vendosi e shenjave njoftuese për vendbanime dhe institucione
- Punim të shiritave vibrues, etj

Në vitin 2024 janë realizuar punime në këto lokacione:

1. Rruga "Qamil Ilazi"(fillimisht për heqjen e parkingjeve dhe pastaj për lejimin e qarkullimit në dy kahje)
 - 2 shenja "ndalim parkimi"
 - 2 shenja "ndalim ndalje dhe parkimi"
 - 2 shenja "rrugë dy-kahore"
 - 2 shtylla
 - ngjyrosje e vijave të parkingjeve me ngjyrë të zezë me gjatësi 348 m'
 - vija dykomponentëshe në mes të rrugës
 - 8 riparime të shtyllave dhe shenjave

2. Rruga “Gllloboçicë – Gorancë”
 - 2 shenja “kthesë e rrezikshme”
 - 2 shenja “kufim shpejtësie 30 km/h”
 - 2 shtylla
3. Rruga “Bob – Doganaj”
 - 3 shtylla
 - 7 riparime të shtyllave dhe shenjave
4. Rruga kryesore e fsh. Sllatinë
 - 4 “shenja ngushtim rruge”
 - 4 shtylla
5. Rruga “Mynyr Thaqi” në fsh. Kovaçec
 - 1 pasqyre
 - 1 shtyllë
 - Shenjëzimi i dy poligonave të autoshkollës të tregu i kafshëve
 - 210m vijë njëkomponentëshe
 - 12m² vija “STOP”
 - Vendosja e policëve të shtrirë (2 lokacione)
6. Rruga “Hamzë Jashari”
 - 21 logo për shtigje të biçikletave
 - 2 shenja të vendbanimeve
 - 2 shtylla
7. Rruga “Ismail Raka”
 - 1 shenjë “trekëndësh”
 - 1 shenjë “dy-kahore”
 - 1 shenjë “rrugë një-kahore” me shenjë plotësuese pas 200 m’
 - 3 shtylla
 - 9 riparime të shtyllave dhe shenjave
 - vija dykomponentëshe në mes të rrugës me gjatësi 895 m’
8. Rruga te Qerdhja e Qytetit
 - 2 shenja parkimi
 - 2 shenja “ndalim parkimi”
 - 3 shtylla
9. Rruga “Çamëria” në fsh. Bajnicë
 - 2 shenja “Stop”
 - 2 shenja “Përparësi kalimi”
 - 4 shtylla
10. Kryqëzimi i rrugës kryesore të fsh. Nikaj dhe fsh. Biçec

- 2 shtylla
- 5 riparime të shtyllave dhe shenjave

11. Rruga “Beteja e 25 majit” në fsh. Dubravë

- 2 shtylla
- 1 shenjë “Fëmijët në rrugë”
- 5 riparime të shtyllave dhe shenjave
- Vendosja e policëve të shtrirë (1 lokacion)

12. Rruga “Skenderbeu” në fsh. Kaçanik

- 1 shenjë “Kufizim shpejtësie”
- 1 shtyllë
- 1 riparim të shtyllës dhe shenjës

13. Rruga “Idriz Seferi” në Kaçanik

- 2 shenja “ngushtim rruge”
- 2 shenja “ndalim qarkullimi për kamion”
- 1 shenjë “rrugë dy-kahore”
- 1 shenjë “ndalim parkimi”
- 1 shenjë rrethore “rrugë me përparësi kalimi nga ana e kundërt”
- 1 shenjë katrore “rrugë me përparësi kalimi nga ana e kundërt”
- 7 shtylla

14. Rruga e re te Sheshi i Qytetit

- 2 zebra për këmbësor
- vija dykomponentëshe në mes të rrugës

15. Rruga “Agim Bajrami”

- 1 pasqyre

16. Rruga “Murat Lika”-Strazhë

- Vendosja e policëve të shtrirë (2 lokacione)

17. Rr.”Agim Bajrami”-Kaçanik

- 1 shtyllë
- Tabelë informuese 90cm (partneriteti Kaçanik-Moosseedorf)

➤ Transportit publik i udhëtarëve

Është hartuar dhe miratuar në Kuvend komunal **Plani Komunal për Transport Publik të udhëtarëve 2024-2028.**

Transporti publik i udhëtarëve në komunën tonë ka funksionuar mirë. Jemi fokusuar në zbatimin e Rregullores komunale për Transportin Publik. Janë paisur me leje pune dhe janë vërtetuar rendet e udhëtimit për linjat urbano-periferike të gjithë operatorët që operojnë me autobus, kombi-bus dhe auto taksi. Aktualisht funksionon transporti publik i udhëtarëve në të

gjitha vijat të cilat janë shpallur nga DSHPE-ja (pos në relacionin Kaçanik –Kotlinë dhe Kaçanik-Kovaçec, ku nuk kemi operator të interesuar).

• **PROJEKTE TJERA**

Nr.	Emërtimi i projektit	
1	Krasitja e drunjëve dekorativ në bulevard, hyrje e qytetit dhe Varrezat e Dëshmorëve	1 projekt
2	Shërbimet e ekzaminimit te materialeve ndërtimore	1 projekt
3	Raporti i Auditimit të Energjisë për Sistemin e Ndriçimit Publik në Komunën e Kaçanikut	1 projekt
4	Ndërtimi poligonit për ushtrimin e pjesës praktike kandidatëve të autoshkollave që operojnë në komunën tonë	1 projekt
	Total	4 projekte

➤ **Ekzaminimi i elementeve ndërtimore**

Është vazhduar me implementim të kontratës” **Ekzaminimi i elementeve ndërtimore**” për periudhën 3 vjeçare (2022-2024). Në këtë vit kemi realizuar aktivitete të kësaj fushe në shumën **6,288.00€** për shërbimet e ekzaminimit te materialeve ndërtimore si:

- Marrje e mostrave të betonit, kubëzave, skajoreve dhe asfaltit
- Matje e ngjeshmërisë së traseve të trotuareve dhe rrugëve

• **MIRËMBAJTJE INVESTIVE**

➤ **Mirëmbajtja e ndriçimit publik-2024**

Mirëmbajtjen e ndriçimit publik në rrjetet ekzistuese e kemi realizuar fillimisht me lidhjen e një kontrate emergjente për mirëmbajtjen e rrjeteve të ndriçimit aktual ku është intervenuar në rrjete të ndryshme ekzistuese të ndriçimit publik në sanimin e defekteve dhe ndërrim të trupave ndriçues dhe më pas është kontraktuar kompania për mirëmbajtje vjetore. Është intervenuar në vazhdimësi në të gjitha rrjetet ekzistuese duke sanuar defektet e krijuara sipas evidentimeve të bëra nga monitorimet në teren nga zyrtarët komunal.

PASQYRË RRETH NDRIÇIMIT PUBLIK

NR. RRJETEVE TË NDRIÇIMIT PUBLIK	94
NR. TRUPAVE NDRIÇUES	3067
NR. KABINAVE ELEKTRIKE	89
NR. SHTYLLAVE METALIKE	1414
NR. SHTYLLA BETONI	1322
NR. SHTYLLA DRURI	289
SHPENZIMI VJETOR PËR MIRËMBAJTJE TË NDRIÇIMIT	34,759.30€

NR	EMËRTIMI	Kontraktues
1	Rregullimi i ndriçimit në rrjetet ekzistuese të ndriçimit publik= 6,799.50€	Toni Company
2	Mirëmbajtja dhe rregullimi i ndriçimit në rrjetet ekzistuese të ndriçimit publik në komunën e Kaçanikut-kontrate vjetore= 27,959.80€	Elektra L.L.C.

Intervenime në rrjetet e ndriçimit publik-2024

NR	EMËRTIMI	Copë
1	Ndërrim i trupave ndriçues LED 100W	124
2	Ndërrim i trupave ndriçues LED 50W	547
3	Zëvendësim i kontaktorëve	12
4	Ndërrim i siguresave	52
5	Kabllo ajrore 16mm	184m
6	Drejtim i shtyllave ekzistuese	25
7	Zëvendësim i shtyllave të dëmtuara	2

Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara-KRM "Pastërtia"-Kaçanik

Kemi vazhduar me aktivitetin për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara sipas Marrëveshjes me KRM"Pastërtia"-njësia e Kaçanikut

- Pastrimi i shetitoreve në bulevardin "Ismajl Raka"-Kaçanik dhe Sheshit të Qytetit,
- Kositje e barit dhe mirëmbajtje e hapësirave të gjelbëruara të kompleksi i Varrezave të Dëshmorëve dhe hapësirat e busteve në qytet,
- Krasitje dhe mirëmbajtje drunjëve dekorativ,
- Largim të deponive të vogla ilegale

➤ **Pastrimi dhe mirëmbajtja e kompleksit të varrezave të dëshmorëve dhe veteranëve të UÇK-së**

Gjatë vitit 2024 është bërë pastrimi dhe kujdes i vazhdueshëm i hapësirës së kompleksit të varrezave të dëshmorëve dhe veteranëve të UÇK-së, posaqërisht para çdo date të shënuar për përkujtime apo festa shtetërore dhe komunale. Është mirëmbajtur hapësira e gjelbëruar, lulet dhe drunjët dekorativ (kositje e barit, ujitje dhe pastrim të hapësirave publike). Gjithashtu në çdo datë të përvjetorëve janë pastruar edhe lokacionet e shtatoreve dhe busteve të dëshmorëve dhe martirëve të ngritura në lokacione të ndryshme të komunës sonë.

➤ **Rregullim dhe pastrim i shtretërve të përrockave dhe lumenjëve**

Krahas rregullimit të shtretërve të lumenjve dhe përrockave dhe këtë vit është vazhduar me traditën e pastrimit të shtretërve ekzistues të tyre nga prurjet e ndryshme dhe shkurret.

NR	EMËRTIMI	Gjatësia
1	Pastrimi i shtratit të lumit Nerodime-Kaçanik	960m
2	Pastrimi i shtratit të përroit të Rakocit-Kaçanik	350m
3	Pastrimi i kanalit të ujitjes në lagjen Provoliu-Soponicë	35m
	Totali	1345m

➤ **Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale 2024**

Gjatë vitit 2024, DSHPE-ja është angazhuar në vazhdimësi në realizimin e kontratës për mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve lokale gjatë sezonës verore dhe dimërore. Krahas mirëmbajtjes rutinore gjatë kësaj kohe si (largimi i dheut nga rrëshqitjet, mbushja e gropave me shtresë asfalti, pastrimi i kanaleve të ujërave atmosferike, ndërtim i mureve mbrojtëse, largimi i borës, hudhja e kripës industriale, etj), janë bërë edhe rehabilitime të dukshme të rrugëve me shtresë zhavorri dhe shtresë të re asfalti.

Nr.	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale	Gjatësia/km
1	Gjatësia totale e rrugëve në territorin e komunës së Kaçanikut	332.37
2	Gjatësia e rrugëve në territorin e komunës së Kaçanikut te asfaltuara, kubëzuara, beton ndër vite.	285.43
3	Gjatësia e rrugëve të mirëmbajtura gjatë sezonit të dimrit: pastrimi i borës, hedhja e kripës etj. gjatë vitit 2024	247
	Totali	

Nr.	Mirëmbajtja verore e rrugëve lokale	Gjatësia/km
1	Gjatësia totale e rrugëve në territorin e komunës së Kaçanikut	332.37
2	Gjatësia e rrugëve në territorin e komunës së Kaçanikut te asfaltuara, kubëzuara, beton ndër vite.	285.43
3	Gjatësia e rrugëve të cilat janë mirëmbajtur gjatë sezonit të verës gjatë vitit 2024	46.2
	Totali	

Punët e realizuara me projektin “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale” 2024

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale

- Pastrimi i borës nëpër rrugët e territorit të Komunës së Kaçanikut më datë: 20.01.2024, 21.01.2024, 22.01.2024, 23.01.2024, 24.01.2024 dhe më datë 25.01.2024
- Hudhja e kripës së përzier me rërë nëpër rrugët e territorit të Komunës së Kaçanikut më datë 20.01.2024, 21.01.2024, 22.01.2024, 23.01.2024, 24.01.2024, 26.01.2024, 28.01.2024.

Mirëmbajtja verore e rrugëve lokale

- Rregullimi i hyrjes së oborrit me zhavor ku do të ndërtohet kopshti i fëmijëve fsh Nikaj (18.03.2024)

- Rregullimi i disa gropave me kalldërm te ura e Konakut dhe përreth Xhamisë (06.04.2024)
- Rregullimi i rrugës Sepetin fsh. Dubravë nga shembja e dheut për te rrjeti kryesor i ujësjellësit (17.04.2024)
- Rehabilitimi i rrugës me zhavor deri te vendi i rënies së Komandant Bardhit (11.05.2024)
- Pastrimi i rrugës kryesore nga shembjet dhe prirjet e reshjeve te përroi fsh. Kotlinë, fsh Gajre, fsh Bob dhe Kashan (21.05.2024-23.05.2024)
- Rehabilitimi i rrugës me zhavor deri te vendi i rënies së dëshmorëve në fsh. Kukaj (24.05.2024)
- Rregullimi i prerjeve në rrugë me asfalt (në vendet ku është intervenuar në instalimet nëntokësore) në rrugën “Qamil Ilazi” dhe “Sali Bajra” dhe shtruarja me asfalt te nënkalimi pjesa ka hyrja e ETC-së (07.06.2024)
- Pastrimi dhe larja me autobot e rrugës kryesore të qytetit, hyrja dhe rr.”Ismail Raka” (08.06.2024-11.06.2024)
- Rehabilitimi i disa gropave me asfalt në rrugën kryesore Bob-Doganaj, në rrugën kryesore në fshatin Dubravë, në rrugën kryesore në fshatin Kukaj, Kovaçec, në rr. Skënderbeu etj.
- Pastrimi i shtratit të lumit Nerodime/ në zonën urbane
- Intervenimi me zhavorr në fsh Drenogllavë dhe Kashan.
- Pastrimi me ujë me autobot i bulevardit Ismajl Raka
- Largimi i vegjetacionit në rrugën kryesore në fshain Dubravë
- Pastrimi i trotuarit në rrugën Bob-Doganaj
- Hapja e rrugës për qasje në vendin e marrjes së ujit për ujësjellësin në fshatin Dubravë dhe krijimi i qasjeve për te rezervuarët
- Largimi i prurjeve nga vërshimet te përroi në fshatin Gajre,
- Rehabilitimi i disa gropave me asfalt në rrugët në qytet dhe lagjen Dushkaja
- Rehabilitimi i disa gropave me asfalt në rrugën lidhëse të lagjeve Koraq-Bunjak dhe lagjen Kamish- fsh.Dubravë
- Rrënimi (demolimi) i një objekti-Villë në fshatin Strazhë dhe transporti i materialit të demoluar deri në deponi
- Intervenimi me zhavorr në hyrjen e stadiumit të qytetit në fsh. Stagovë dhe disa rrugicave
- Vendosija e gypave Ø800 për kanalin e ujërave atmosferike përgjatë rrugës në lagjen Murseli-Doganaj.

• Sektori i emergjencave

Aktivitet e Sektorit të Emergjencave gjatë vitit 2024

Sektori i emergjencave edhe gjatë këtij viti ka vazhduar të jetë elementi themelor në identifikimin e shkaktarëve të rrezikut, evidentimin e tyre dhe marrjen e masave preventive për zbutjen ose eliminimin e pasojave nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera që mund të rrezikojnë banorët e komunës sonë.

Me dt.08.03.2024 Takim me Sylejman Latifin zyrtar për ndryshime klimatike, vërshime dhe thatësira.

Tema: Raport informues mbi gjendjen e lumenjve në komunë.

Me 19.03.2024 Takim me USAID dhe AME

Tema: Prezantimi i projektit të USAID-it –Adoptimi me ndryshimet klimatike, roli dhe përgjegjësitë e komunave.

Me dt. 20.03.2024 takim me zëvendës ministrin e i mbrojtjes të FSK-së

Tema: Menaxhimi i Fatkeqësisë (Vlerësimi i Rreziqeve)

Me 16.04.2024 Punëtorja, për energji të ripërtritëshme dhe eficiencë të energjisë >> AKEREC

Tema: Ndikimi i ndryshimeve klimatike në biodiversitet dhe masat e përshtatjes për ndryshimet klimatike në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë – përmbytjet dhe erozioni.

Zbatues i projektit : Asociacioni Kosovar për energji të ripërtritëshme dhe eficiencë të energjisë >> AKEREC

Me dt.19, 21.05.2024 dhe 22.05.2024 Të reshurat e dendura të shiut dhe breshëri që ndodhën në këtë periudhë shkaktuan dëme të konsiderueshme në infrastrukturën rrugore dhe në bujqësi.

Me këtë rast DSHPE - Sektori i emergjencave, ka marrë masat e nevojshme për parandalimin e vërshimeve duke angazhuar kompaninë për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve,

Në kuadër të tërë kësaj, do ta paraqesim raportin sipas aktiviteteve të zhvilluara pas reshjeve të shiut dhe breshërit për ditët 19, 21 dhe 22 Maj 2024.

Me dt. 19.05.2024 Intervenim nga kompania për mirëmbajtjen e rrugëve verore dhe dimërore në fshatin Gajre, Ivajë dhe Kotlinë.

Me dt. 19.05.2024 pas reshjeve të shiut janë shkaktuar shembje të dheut dhe rrokullisje të gurëve në fshatin Gajre, dhe Kotlinë me këtë rast intervenimi është bërë përmes kompanisë mirëmbajtjes verore dhe dimërore të rrugëve .

Me dt. 21.05.2024 në fshatin Llanishtë nga reshjet e mëdha të shiut dhe breshëri është bllokuar rruga dhe për këtë është bërë intervenim emergjent për sanimin e dëmit.

Gjatë inspektimit në terren është evidentuar bllokimi i rrugëve nga prurjet të zhavorrit në fshatin Gajre, Ivajë, Kashan dhe në rrugën “Tefik Raka” – Kaçanik.

Në të gjitha rrugët është intervenuar dhe mbikëqyrur nga menaxheri për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve.

Me dt. 21.05.2024 nga të reshurat e mëdha të shiut dhe breshëritë, janë bllokuar rrugët në fshatrat Llanishtë, Gajre, Kotlinë dhe në lagjen Rakoc, si dhe janë shkaktuar dëme në kultura bujqësore në **Fshatin Llanishtë, Kotlinë dhe Duraj- Gabrricë**

Sipas komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve; dëmet e shkaktuara nga fatkeqësia natyrore – (breshëri), në kultura bujqësore, pemëtari dhe perimtari në fshatin **Llanishtë, Kotlinë dhe Duraj-Gabrricë** arrijnë vlerën në **8,159.37€**

Nr.	Lokacioni	Shkaktari i dëmit	Kultura e dëmtuar	Vlera totale në €
1	Llanishtë	Breshëri	Pemë	3,29.20
2	Kotlinë	Breshëri	Pemë	3,519.60
3	Duraj-Gabrricë	Breshëri	Perime	1,610.57
Totali i dëmeve				8,159.37€

Tabela e dëmeve të shkaktuara nga breshëri të datës 21.05.2024

Me dt.22.05.2024 është bërë zhblllokimi i rrugës në fshatin Llanishtë

Me dt.23.05.2024 është bërë zhblllokimi i rrugës në fshatin Gajre dhe Ivajë

Me dt.23.05.2024 është bërë zhblllokimi i rrugës dhe hapja e kanalit në Kashan, (shtëpia e Rizvan Belës)

Me dt.29.05.2024 Pjesëmarrja në punëtori , "Hartat Rrezikshmërisë dhe Rrezikut nga Vërshimet për të gjitha pellgjet lumore në Kosovë "

Me dt. 14.06.2024 pas kërkesën me nr. prot. **07-104/02-14116/24** të datës **14.06.2024** në DSHPE e adresuar nga "GERMAN BETON" ShPK, për gjetjen e zgjidhjes teknike për largimin e autopompës së aksidentuar gjatë procesit të punës dhe mënjanimit të rrezikut për banorët lokal të kësaj zone.

Për shkak se Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike-sektori i Emergjencave nuk posedon kapacitete teknike për intervenim të kësaj natyre, DSHPE ka bërë kërkesë në LMT-KFOR-it për asistim në largimin e autopompës së aksidentuar gjatë zbrazjes së betonit në fshatin Bob- Kaçanik.

Me dt.08.07.2024 Njoftim për qytetarët e Komunës së Kaçanikut; për shkak të temperaturave të larta dhe rrezikut të ndezjes dhe përhapjes së zjarreve,

Me dt. 01.10.2024 punëtori me temën "Vlerësimi i rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera" me strukturat për Reagim dhe Koordinim Emergjent për rajonin e Ferizajit në Prishtinë, e organizuar nga AME, dhe e mbështetur nga OSBE

Me dt.04.12. 2024 është bërë Aktdhurimi në favor të stacionit të Zjarrfikësve në Komunën e Kaçanikut, nga RC-Ë dhe Kontigjenti Italian janë dhuruar pajisje në vlerë **10,000.00€**

Nënshkrimi i këtij akti është bërë nga drejtori i DSHPE-së z. Ramadush Osmani dhe Komandanti i RCË – së Col. F. (b) t. ISSMI Rocco MUNDO përfaqësues i Kontingjentit Italian.

Me dt. 06.12.2024 Në kuadër të Sensibilizimi i dhe përfitimi i njohurive të nxënësve për zjarret, është mbajtur ushtrimi, mbrojtja nga zjarri për nxënësit e parashkollorë dhe klasat e para fillore të paraleles së ndarë të shkollës fillore ""Emin Duraku"" të fshatit Runjevë me temën: **fikja e zjarreve fillestare me aparate për fikjen e zjarrit.**

Me dt.11.12.2024-Pjesëmarrja në punëtorinë e përbashkët, me qëllim të prezantimit të Strukturës së Unifikuar, në formë të Mostrave dhe Udhëzuesve për hartimin e Dokumentit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë dhe Planeve Lokale të Reagimit Emergjent, në përputhje me Rregulloren (QRK) Nr. 25/2020 për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë dhe Rregulloren Nr. 08/2013 për Përmbytjen dhe Procedurat e Hartimit të Planeve të Reagimit Emergjent.

Njësia Profesionale Zjarrfikëse dhe Shpëtimit

Inspektori i preventivës dhe mbrojtjes nga zjarri ka bërë inspektime të rregullta në subjekte të ndryshme në teren, ka dalë në vendngjarje dhe ka bërë raportime për shkaktarët e zjarrit, ka pranuar kërkesa të ndryshme nga palët, për vërtetime të zjarrit, procesverbale të ndryshme, si dhe kërkesa nga Policia e Kosovës për raporte të zjarreve.

Njësia Profesionale Zjarrfikëse dhe Shpëtimit ka intervenuar në 225 raste prej të cilave 204 kanë qenë zjarre (malore, fushore, objekte banimi, objekte ndihmëse, objekte biznesi, oxhaqe, objekte publike, objekte industriale, pajisje elektrike) si dhe intervenime tjera të paraqitura në tabelë.

Nr.	Lloji i intervenimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithësej
1	Zjarre	3	36	15	21	1	8	25	58	13	8	13	3	204
2	Interv.teknik		3	1		6	1		1		2			14
3	Shërbime							1						1
4	Aksidente						1			1		1		3
5	Vërshime					2	1							3
6	Alarmi rrejshëm													
7	Gjithësej	3	39	16	21	9	11	26	59	14	10	14	3	225

Tabela: Kategorizimi dhe intervenimi i zjarreve sipas muajve gjatë vitit 2024

Tabela: Ndarja analitike e zjarreve në: Objekte ndërtimore

Nr.	Lloji i intervenimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithësej
1	Banesa-shtëpi	1	2	1			1						1	6
2	Objekte ndihmëse				1		1	2			1			5
3	Stalla						1					1		2
4	Objekte kolektive													
5	Oxhaqe				1							1		2
6	Të tjera													
7	Gjithësej												1	15

Nr.	Lloji i intervenimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithësej
1	Publike			1										1
2	Objekte Biznesi		1											1
3	Objekte industriale													
4	Të tjera													
5	Gjithësej		1	1										2

Tabela: Ndarja analitike e zjarreve në: Objekte ekonomike

Nr	Lloji i intervenimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithëse
1	Pajisje elek./Trafo		3										1	4
2	Pajisje shpërndarëse	1		1			1			1	2	1		7
3	Gjeneratorë													
4	Të tjera												1	1
5	Gjithësej	1	3	1			1			1	2	1	2	12

Tabela: Ndarja analitike e zjarreve në: Pajisje elektrike

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE -2024		
1	Ndërtimi i Sheshit të Qytetit-faza e II-të	1 projekt
2	Ndërtim i rrjeteve të ujësjellësit= 7 projekte	4150m
3	Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve fekale =32 projekte	15559m
4	Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve atmosferike=11 projekte	3711m
5	Ndërtim i trotuareve për këmbësor= 3 projekte	4285m
6	Ndërtimi dhe asfaltimi rr."Idriz Seferi"-Kaçanik L=1347m	1 projekt
7	Ndërtim i shtigjeve për çiklista për këmbësor= 1 projekt	1625m
8	Ndërtimi i Objektivit për Shërbimin e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit-faza II-të	1 projekt
9	Rregullim i ndriçimit publik= 11 projekte	11010m/433 trupa
10	Rregullimi i hapësirës publike në K.Vjetër dhe Lagjja Hajdari-Rekë	1 projekt
11	Ridizajnimi i Parkut të Qytetit përballë Kalasë së Qytetit	1 projekt
12	Asfaltim dhe riparim i rrugëve lokale të asfaltuara	1,326.98m ²
13	Rehabilitimi i rrugëve publike të pa kategorizuara me shtresë zhavori	5 projekte
14	Sinjalizim vertikal	
a.	Shenja të rrezikut.....	9 copë
		12 copë
b.	Shenja të urdhëresave prera.....	13 copë
		1 copë
c.	Shenja të lajmërimit,.....	2 copë
		5 lokacione

	d. plotësuese.....	Tabelë	260 m
	e. Pasqyre.....		907 m ²
	f. Barriera (policë të shtrirë).....		21 copë
	Sinjalizim horizontal-material një dhe dykomponent		35 copë
	a. Shenjëzim (vija) horizontal.....		
	b. Shenjëzim i vendkalimeve për këmbësor (zebra).....		
	c. Llogo për shtigje për këmbësorë.....		
	d. Riparime të shenjave dhe shtyllave të shenjzimit vertikal.....		
15	Furnizim komuniteteve me gyp ujësjellësi=PE		
	a. Φ 110.....		120m
	b. Φ 63.....		1990m
	c. Φ 50.....		210m
	d. Φ 5/4.....		300m
	e. Φ 75.....		100m
16	Ndërtim i vendparkingjeve për vetura		29 vend parkingje
17	Krasitja e drunjëve dekorativ		1 projekt
18	Pastrim i përrockave dhe lumenjëve		1345m
19	Pëlqime për rregullim të ndriçimit publik nga komunitetet		2 pëlqime
20	Plane dhe rregullore komunale		1 dokument

Dejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë

Prioriteti 10: Zhvillimi i bujqësisë, krijimi i vendeve të reja të punës , rritjen e të ardhurave shtesë në zonat rurale dhe mbrojtja e pyjeve	
Aktivitetet kryesore për realizimin e këtij prioriteti	Arritjet /progresi/ performanca kyçe gjatë periudhës janar-qershor, të vitit 2024

Shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët dhe vendosja me kohë. Mbështetja e fermerëve, në kompletimin e dokumentacionit, për aplikim në projektet e subvencionimit të fermerëve nga MBPZHR dhe projekteve me mjete nga buxheti komunës

Si drejtori jemi angazhuar në mbështetjen e fermerëve për realizimin e kërkesave të tyre, duke i shqyrtuar çdo kërkesë të parashtruar dhe vendosjen me kohë të tyre, për të cilat edhe janë informuar, jemi angazhuar në mbështetjen e fermerëve gjatë pranimit të aplikacioneve, duke i ofruar ndihmë në plotësimin e aplikacioneve me dokumentacione përcjellëse, gjatë aplikimit për subvencione në projektet e ofruara nga MBPZHR dhe në realizimin e projekteve me mjete nga buxheti komunës si dhe aktivitete tjera.

Nga Projektet e ofruara të MBPZHR, për subvencionim të fermerëve, këtë vit kemi 430 fermerë, që kanë aplikuar në zyren e DBZHRP-së, në projektet e subvencionimit të MBPZHR (subvencionim të kulturës së grurit, misrit, kulturave pemëtare, perimore si dhe subvencionimit të fermerëve për lopë qumështore, viqave për majmëri, mësherrave deleve, dhive, bletëve si dhe shpezëve-pulave).

Gjithashtu fermerëve ju kemi ofruar mbështetje për plotësim me dokumentacion shtesë të kërkesave të tyre, në projektet e subvencionimit të MBPZHR. Mbështetja e ofruar fermerëve lidhur me marrjen e informacioneve për plotësimin e dokumentacionit shtesë të kërkuara nga zyrtarët e MBPZHR sipas kërkesave dhe përcjelljen e tyre me kohë tek zyrtarët e MBPZHR, me qëllim që fermerët të mos ndëshkohen me humbjen e subvencioneve.

Si drejtori, aktivitetet tona kanë qenë të fokusuar në përmbushjen planit të punës dhe realizimit të misionit dhe objektivave të drejtorisë: mbështetjen e fermerëve për mes projekteve të DBZHRP-së, me qëllim të krijimit të lehtësirave dhe rritjen e të hyrave shtesë për familjet, në zonat rurale.

Nga projektet e realizuara me mjete nga buxheti komunal, mjetet e bashkëfinancimit me OJQ-re dhe participimit të fermerëve kanë përfituar **320 fermerë**, në shumë të përgjithshme të investimeve në subvencionimin e fermerëve prej **339,395.57 €**

Nga projekti për mbështetje të fermerëve me serra kanë përfituar **100 fermerë serra** në sipërfaqe prej 50m², vlera e projektit **70,000.00€**, projekt i realizuar me bashkëfinancim (të OJQ-ës Church Jezus Krisht **28,000.00€**, buxheti Komunës **27,000.00€** si dhe participimi i fermerëve 20% vlerës së projektit **14,000.00€** si dhe nga OJQ - IKC **1000 €**

Nga projekti për mbështetjen e fermerëve me freza 1.6m për tërheqje me traktor, që është vazhdimësi e projektit nga viti i kaluar, kanë përfituar 21 fermerë, vlera e projektit **15,582.00€**, (buxheti komunal **12,465.60 €**, (20% participimi i fermerëve **3,114.40€**).

Këtë vit kemi investuar **60,000.00€** për ndërtimin e kanaleve të hapura të ujitjes në fshatërat: Dubrvë- lagja Vishaj, Vataj dhe Nikaj, projekti është përfunduar.

Gjithashtu këtë vit kemi realizuar edhe projektin për mbështetjen e fermerëve me mekanizëm bujqësor : (moto kultivator(**86**), freza për tërheqje me traktor (**32**), makina spërkatëse për kulturat lavërtare (**15**), makina kositëse (**24**), makina mbjellëse të grurit (**17**), makina mbjellëse misrit (**19**) dhe makina mbjellëse të patates (**6**), gjithsejtë **199 fermerë përfitues**. Vlera e projektit **253,813.57 €**, projekti me bashkëfinancim të OJQ-së Relief Islamik **106,521.74 €**, buxheti komunal **102,347.83€** si dhe 20 % participimi i fermerëve për vlerën e secilës pajisje **44,944.00€**.

Jemi angazhuar në përcjelljen e gjendjen e kulturës së grurit që nga faza e mbirjes e deri në fazën e korrjeve, kemi përcjellë fushatën e korrje-shirjeve të grurit dhe për sipërfaqet e korrura, vazhdimisht çdo fundjavë deri në përfundimin e fushatës së korrjeve kemi raportuar në MBPZHR, lidhur me sipërfaqet e korrura dhe rendimentin mesatar të kësaj kulture (nga 410 ha sipërfaqe të korrura me grurë, kemi pasur një rendiment mesatarë prej 4300kg/ha).

Me kërkesë të MBPZHR kemi hartuar raportin për mbjelljet pranverore dhe mbjelljeve vjeshtore, të cilët i kemi përcjellë në MBPZHR.

Kemi bërë monitorimin e fermerëve përfitues në kuadër të projekteve të subvencionimit të fermerëve me buxhet komunal, lidhur me keqpërdorimet eventuale të fermerëve.

Sa i përket kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, janë shqyrtuar 50 kërkesa, prej të cilave 49 të miratuara, dhe 1 kërkesë e refuzuar

Sipërfaqja e tokës bujqësore që është lejuar ndërrimi i destinimit është **76837 m²** apo shprehur në hektar **7,68.26 ha**. Nga vendosja e kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në ndërtimore janë krijuar të hyra në shumë prej **61,536.25 €**.

Me kërkesë të palëve kemi bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga bresshëri , të cilat i kemi përcjellë në Agjencionin për Menaxhimin e Emërgjencave, për kompensimin e dëmeve.

Mbështetja e fermerëve me këshilla profesionale

Këtë vit kemi organizuar trajnime me fermerë, në kuadër të projektit të shëbimeve këshillimore, trajnime për kultivimin e kulturave lavërtare, perimore dhe në bletari. Fermerët kanë përfituar njohuri teorike dhe praktike me rastin e vizitave në terrenë, gjithashtu fermerët janë mbështetur me këshilla individuale sipas kërkesave së tyre, lidhur me vështirësit dhe problemet që i kanë përcjellur, gjatë këtij viti..

Drejtoria per Kultur, Rini dhe Sport

Janar

- Përgatitja e planit të punës për vitin 2024 dhe raporti i punës për vitin 2023.
- Plotsimi i formularit në planin gjithpërfshirës të komunave në lidhje me obligimet e komunave nga agjenda evropiane në pjesën e trashëgimisë kulturore.
- Takim pune me Qendrën Rinore „Shtëpia e Shpresës” lidhur me bashkëpunimin e metutjeshëm me këtë organizatë.
- Aplikimi dhe lëshimi i vërtetimit për Shkollën e Futbollit Avdurri.
- Është punuar në raportin e monitorimit të subvencioneve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit .
- Është dorzuar propozim vendimi për KPF dhe kuvend për emërimin e Këshillit Punues për funksionalizimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.
- Aplikimi dhe lëshimi i vërtetimit për regjistrim për shkollën e futbollit Almati.
- Pjesëmarrje në ceremoninë e ndarjes së kontratave për përfituesit e projektit “Komuna për të Rinjë” organizuar nga MAPL në Prishtinë dhe shpërndarja e kontratave për përfituesit nga komuna jonë.
- Pjesëmarrje në ceremoninë e zgjedhjes së sportistit të vitin 2023 , organizuar nga Federata e Motoqiklizmit të Kosovës .
- Angazhim në aktivitetin “ Promovimi i artit dhe kulturës në qytetin e Kaçanikut “ e organizuar nga Qendra Kulturore “ Kaçaniku” dhe e mbështetur nga MKRS .

SHKURT

- Pjesëmarrje në seminarin Qeverisja Lokale dhe Dixhitalizimi-„Smart City”(Komunat e Mençura) e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës në Kulturë Rini e Sport.
- Pjesëmarrje në debatin me temë „Mundësia e realizimit të projekteve të përbashkëta në interes të shkollave dhe më gjërë” organizuar nga Drejtoria e Arsimit.

- Takim me përfaqësuesit e fshatit Biqec lidhur me kërkesën e tyre për funksionalizimin e “Mullirit të Katundit “ në fshatin Biqec.
- Pjesëmarrje në trajnimin për menagjim të financave dhe prokurim në kuadër të projektit “ Komuna për të rinjë “ organizuar nga CDF .
- Stolisja e qytetit me flamuj për 17 Shkurtin-Përvjetori i 16-të i Pavarësisë së Kosovës.
- Organizimi i turneut tradicional në futboll të vogël me nxënës të shkollave fillore „Kupa e Pavarësisë”.
- Organizimi i kuizit të diturisë me moton „Rruga drejt Pavarësisë së Kosovës”.
- Programi kulturor-artistik për nderë të 16 Vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.
- Pjesëmarrës në takimin me grupin e performancës komunale .
- Pjesëmarrës në Këshillin Punues të Muzeut.
- Pjesëmarrës në puntorinë me temë „Plani strategjik dhe ngritja e fondeve për iniciativa të të rinjëve”-e organizuar nga USAID-Programi „Up to Youth”.
- Përgatitja e vendimit për shpalljen e subvencioneve në lëminë e Kulturës,Rinisë dhe Sportit si dhe publikimi në faqën e komunës.

MARS

- Në bashkëpunim me shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor në Kaçanik janë mbajtur garat komunale në basketboll me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme.
- Shërbim Festivalit të Teatrove për Fëmijë-shfaqja teatrale „Shtëpia Magjike”-e shfaqur nga teatri „Adriana “-Ferizaj.
- Pjesëmarrës në ceremoninë përmbyllëse të projektit 5 vjeçar „Up to Youth” i implementuar në nëntë komuna të Kosovës ku pjesë e këtij projekti ishte edhe komuna jonë e organizuar dhe financuar USAID.
- Përgatitja dhe publikimi i thirrjes publike për subvencione në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- Në bashkëpunim me Klubin e Mundjes “Kaçaniku”,Federatën e Mundjes së Kosovës dhe Drejtorinë e Arsimit e bashkë me shkollat është bërë promovimi i sportit të mundjes në Palestrën Sportive .
- Pjesëmarrja e SHKA „Gryka e Kacanikut“ në manifestimin tradicional „Flakadani i Karadakut“në Viti.
- Janë mbajtur garat shkollore në volejboll aktivitet i organizuar në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollorë në Kaçanik.

- Pranimi i aplikacioneve të OJQ-ve për subvencione në Kulturë, Rini e Sport dhe për anëtarë të komisionit të jashtëm për ndarjen e subvencioneve.

PRILL

- Kemi pranuar ftesë nga DKRS në Kamenicë për pjesëmarrje në manifestimin tradicional kulturor e sportiv „Lulëkuqet e Prillit” që ju kushtohet Betejës së Marecit ku komuna jonë do të prezentohet me program folklorik nga SHKA „Tingujt e Vendlindjes”.
- Në bashkëpunim me Federatën e Mundjes së Kosovës e në mbështetje të Klubit të Mundjes „Kaçaniku ” u organizua Kampionati Individual i Kosovës për grupmoshen U15 dhe U20 në Palestrën e Sportit .
- Pjesëmarrja e të rinjëve në punëtorin “Rritja e ndërgjegjësimit dhe luftimin e ndotjes së ajrit në komunitet “-organizuar nga organizata PEN, punëtori 3 ditore.
- Aktivitet sportivë në bashkëpunim me FFK-në dhe Shoqatën Handikos për personat me aftësi të kufizuara .
- Vizitë muzeut të qytetit të Pejës me këshillin punues të Muzeut të Kaçanikut.
- Përgatitja e rekomandimit dhe njoftimit për përfituesit në subvencionet e Kulturës ,Rinisë dhe Sportit
- Anagazhim në grupin punues për shënimin e 22 prillit-Dita Ndërkombëtare e Tokës,aktivitet i mbajtur në bashkëpunim me KVRL, OMM Gjethi dhe klubet sportive.
- Takim pune me zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë për temën Drejtësia Tradicionale.
- Angazhim në organizimin e një aktiviteti për të rinjë „Dita Ndërkombëtare e Librit”, aktivitet i mbajtur në bashkëpunim me KVRL.
- Në bashkëpunim me Federatën e Mundjes së Kosovës, dhe Klubin e Mundjes Kaçaniku është bërë organizimi i Turneut Memorial “Heroinat e Kaçanikut”.
- Takim pune me Këshillin Punues të Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.

MAJ

- Shërbim për Kryqin e Kuq komunal në zhvillimin e garave regjionale të ndihmës së parë .
- Janë nënshkruar kontratat me përfituesit e subvencioneve në lëmin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ,sipas thirrjes së parë publike.

- Pjesëmarrja e Qendrës Kulturore "Kaçaniku" në Festivalin "Anadrini Jehon".
- Organizimi i garave regjionale/ kampionale për U14 në Volejbol, aktivitet i organizuar në bashkëpunim me Federatën e Volejbollit të Kosovës dhe Klubin e Femrave të Volejbollit "Kaçaniku".
- Përgatitja dhe mbajtja e diskutimit publik për draftstatutin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.
- Organizimi i finaleve në futboll për grupmosha të reja në U13, U15 në Stadiumin "Besnik Begunca", aktivitet i mbajtur në bashkëpunim me Lidhjen Rajonale të Futbollit në Ferizaj.
- Takime me klube sportive rreth shënimit të 11 Qershorit –Ditës së Çlirimit të Kaçanikut me rrethinë.
- Pjesëmarrës në forumin e informimit dhe vetëdijësimit publik me të rinjtë/adoleshentët e Kaçanikut organizuar nga USAID , ku si temë ishte Legjislacioni mbi pronësinë përmes trashëgimisë.
- Marrëveshje në mes të Këshillit të Muzeut të Kaçanikut dhe pronarit të gurit përkushtimor në Kotlinë , që ky artefag ti dorzohet Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.
- Pjesëmarrës në përrurimin e projektit kabineti i teknologjisë informatike në HANDIKOS- në kuadër të programit „Komunat për të Rinjë”.
- Takim me KVRL lidhur me përgatitjet e shënimit të 1 Qershorit-Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.
- Finalja e Turneut Memorial "DIKI 2024", aktivitet i mbajtur në Palestrën Sportive në bashkëpunim me këshillin e fshatit Nikaj.
- Pranimi i aplikacioneve të OJQ-ve në thirjen e dytë publike në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- Pjesëmarrës në Komisionin për ndarje të subvencioneve në Kulturë, Rini e Sport-faza e dytë si dhe përgatitja e njoftimit për përfituesit e këtyre subvencioneve.
- Miratimi i Draft statutit të Muzeut të Qytetit të Kaçanikut nga Kuvendi Komunal.

Qershor

- Shënimi i 1 Qershorit-Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve me aktivitete kulturore, rinore e sportive, organizuar në bashkëpunim me KVRL, Bonevet, Handikos,klubet sportive dhe shkollat fillore .
- Është bërë vendimi dhe kontrata e përfituesve të subvencioneve në fushën e Kulturës,Rinis e Sportit-faza e dytë.

- Është shënuar Dita Ndërkombëtare e Sportit dhe Mjedisit, aktivitet i organizuar në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollorë në Komunën e Kaçanikut.
- Angazhim në stolisjen e qytetit me flamuj si dhe shpërndarja e njoftimeve për aktivitetet e Ditës së Çlirimit të Kaçanikut me rrethinë.
- Është mbajtur Turnir Mbarëkombëtarë i Shahut në kuadër të aktiviteteve të Ditës së Çlirimit të Kaçanikut me rrethinë, në bashkëpunim me Klubin e Shahut Lepenci dhe Federatën e Shahut të Kosovës.
- Është bërë publikimi i raportit dhe dokumenteve përcjellëse të diskutimit publik në lidhje me Draft Statutin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.
- Pjesmarrja e Qendrës Kulturore “Kaçaniku” në festivalin tradicional folklorik në Deqan.
- Angazhim në organizimin e ekranit të hapur për përcjelljen e ndeshjeve të kampionatit evropian në sheshin e ri të qytetit.
- Ekspozitë „Kolonia artistike Shtrazë” organizuar nga artistët e Kolonisë së Artit pamor.
- Manifestim Kulturo-Artistik për nder të Ditës së Çlirimit të Kaçanikut me rrethinë .
- Festivali Tradicional i SHKA-ve për nder të Ditës së Çlirimit të Kaçanikut me rrethinë .
- “Vrapi i lirisë” aktivitet sportivë për nder të Ditës së Çlirimit të Kaçanikut me rrethinë me nxënës të shkollave fillore të komunës .
- Ekspozitë me fotografi në bashkëpunim me Shoqatën Bjeshkatore Alpiniste Kaçaniku.
- Përrurimi i Fushave të jashtme sportive te Palestra e Sportit .
- Përrurimi i Muralit të 7 Shtatorit në hapësirën e jashtme të Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” , aktivitet i mbajtur në bashkëpunim me OJQ Kampi i Artistëve Mural.

Korrik

- Përcjellja e projektit në Ministrinë e Punëve të Jashtme për Javën e Diasporës.
- Aplikimi dhe lëshimi i vërtetimit për regjistrim për Klubin e Motoqiklizmit “Enduro Kaçaniku”.
- Në bashkëpunim me simpatizuesit “Fikshat” është mbajtur Turneu Memorial “Besnik Begunca – Fikshi” .
- Është mbajtur debati publik për buxhetin për vitin 2025 në sektorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit .
- Është përcjellur raporti 6 mujor për aktivitetet e mbajtura në DKRS.

GUSHT

- Takim me Këshillin Organizativ për shënimin e 10 Gushtit-Dita e Dëshmorëve.
- Përcjellja e Memorandumit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me bashkëpunimin për aktivitetet për mërgimtarët.
- Koncert për mërgimtarët me muzikë dhe valle popullore e folklorike dhe me Rock Grupet Kaçanikase.
- Pjesëmarrës në takimin e komisionit të Kaçanikut- Moosedorfit.
- Konsultim dhe bashkëpunim me klubet sportive lidhur me aktivitetet sportive për mërgimtarët të cilat u mbajtën më datë 5 dhe 6 gusht .
- Organizimi i aktiviteteve për 10 Gushtin- Dita e Dëshmorëve ,sipas agjendës së paralajmëruar
- Pjesëmarrje në Festivalin në Prishtinë e Qendrës Kulturore Kaçaniku.
- Turneu Memorial në Futsall me të gjitha ekipet fituese të Turneve Memoriale , aktivitet i mbajtur në Palestrën Sportive.

SHTATOR

- Prgatitja e dokumentit për shpalljen publike në zyrën e prokurimit në lidhje me kriteret e llogos së Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.
- Angazhim në mbarëvajtjen e akademisë përkujtimore për veteranin e UÇK-së Ilaz Ceka.
- Në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollorë në Komunë e Kaçanikut dhe Federatën e Sportit Shkollor u shënuar Java Europiane e Sportit-Be Active. Aktiviteti u mbajt në SHMU Emin Duraku.
- Pjesëmarrje me shoqatën Handikos në Festivalin All Equall,aktivitet i organizuar nga Federata e Futbollit të Kosovës.
- Pjesëmarrja e Qendrës Kulturore “Kaçaniku” në Festivalin në Shkodër-Shqipëri.
- Zyra për trashëgimi kulturore në bashkëpunim me zyrtarin e kulturës kanë bërë vizitë monumenteve kulturore në : fsh. Nikaj, Biçec, Gllaboçic, Shtrazë, Stagovë, Begracë, Kaçanik i vjetër.
- Takim me klubet sportive me delegacionin nga Moosedorfi në Palestrën e Qytetit.
- Koncert për musafirët nga Moosedorfi nga SHKA-të e komunës .

TETOR

- Shënimi i 1 Tetorit “Dita e Pleqërisë”, organizuar në bashkëpunim me OKPIP.
- Vizitë Shtëpisë Muze të Dëshmorit “Ismajl Raka” , kalasë së Llanishtës(Tophanës) dhe „Rrugës Romake” në fshatin Gjurgjedell.
- Takim me drejtorët dhe arsimtarët e edukatës muzikore të shkollave fillore me qëllim të njoftimit të nxënësve lidhur me audicionin e hapur për pjesmarrje në Festivalin e Këngës Popullore për Fëmijë “Kacaniku 2024”.
- Pjesmarrës në punëtorinë një ditore me temë „Auditimi Social”e organizuar nga OMM,„Gjethi” dhe i përkrahur nga MAPL.
- Furnizimi me inventar dhe paisje teknologjike për bibliotekën, palestrën dhe zyrën e zyrtarës për trashëgimi kulturore.
- Pjesmarrja e Qendrës Kulturore „Kaçaniku” në festivalin „Ballkan Fest” në Kumanovë.
- Në bashkëpunim me Shoqatën e Petagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor në Kaçanik janë organizuar garat komunale në basketboll.
- Vizitë muzeut në komunën e Shtimës së bashku me Këshillin e MQK-së.
- Pjesmarrës në ceremoninë e shpërndarjes së librave për më shumë se 30 biblioteka komunale, ku biblioteka jonë u pasurua edhe me mbi 600 tituj,duke përfshirë autorë të ndryshëm.Kjo ceremoni është organizuar nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës dhe është mbështetur nga MKRS.
- Pranimi i listës së re të objekteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje nga QRTK.
- Perurimi i fushes sportive ne Gllloboqicë.

NËNTOR

- Pjesmarrës në Këshillin Organizativ për organizimin e aktiviteteve për nder Festave të Nëntorit.
- Kemi përgatitur njoftimin dhe ftesat për aktivitetet festive të Nëntorit dhe kemi kontaktuar shkollat në lidhje me bashkëpunimin për shënimin e këtyre aktiviteteve.
- Në palestrën sportive janë mbajtur garat komunale në futsall me shkollat fillore të komunës sonë në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor në Kaçanik.
- Shërbim në promovimin e ditarit (vëllimit të dytë) „Si e pashë luftën” të autorit Prof Murtez Neziraj.

- Angazhim në organizimin e aktiviteteve për nderë të Festës së Nëntorit(stolisja e qytetit me flamuj,tubim përkujtimor në 30 vjetorin e rënjes së Dëshmorit Ismajl Raka).
- Angazhim dy ditor në Festivalin e Këngës Popullore për Fëmijë „Kaçaniku 2024”
- Turneu në Ping-Pong, organizuar në bashkëpunim me Klubin e PingPongut Kaçaniku.
- Manifestim kulturo-artistik për Festat e Nëntorit .

DHJETOR

- Pjesmarrës në takimin konsultativ rreth performancës komunale
- Janë zhvilluar garat regjionale në futsall për kategorinë e meshkujve dhe femrave, aktivitet i organizuar në bashkëpunim ,me Federata e Sportit shkollor dhe Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor në Kaçanik.
- Janë pranuar aplikimet për llogon e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.
- Vazhdimi i projektit “All Equall”, I organizuar në bashkëpunim me Handikos dhe FFK.
- Takim me QRTK në Ferizaj, diskutim për trashëgiminë shpirtërore, projekteve aktuale dhe planeve të ardhshme.
- Shpallja publike për logon fituese të Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.
- Nënshkrimi i kontratës me përfituesit për subvencione për Laureatët e Vitit 2024.
- Është mbajtur manifestimi kulturo-sportiv “Laureatët e Vitit 2024”
- Pranimi i raporteve kthyesë të OJQ-ve për subvencionet në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit .

ORGANIZATAT KULTURORE, RINORE E KLUBET SPORTIVE

Edhe këtë vit , organizatat kulturore , rinore dhe klubet sportive janë përkrahur me subvencione sipas thirrjeve publike, të ndara nga komisioni i themeluar përkatës. Janë përkrahur dhe ndihmuar me subvencione organizatat kulturore, rinore e sportive :

1. Klubi Futbollit “Lepenci”
2. Fondacioni Bonevet,
3. Klubi Basketbollit “Kaçaniku”,
4. Klubi Futbollistik i Femrave “Bazelli 2015”
5. Klubi i Basketbollit “Lepenci”
6. Klubi i Mundjes “Kaçaniku”
7. Klubi i Taekëondos “Kaçaniku 2000”
8. Klubi i Volejbollit “Kaçaniku” (femrat)
9. Klubi i Volejbollit “Kaçaniku” (meshkujt),
10. Këshilli i Veprimit Rinor Lokal,
11. Motokros “Kaçaniku”,
12. Qendra Kulturore “Kaçaniku”,
13. Shoqata Bjeshkatare Alpiniste “Kaçaniku 2015”,
14. Shoqëria Kulturo Artistike “Tingujt e Vendëlindjes”,
15. Shoqëria Kulturo Artistike “Gryka e Kaçanikut”,
16. Shoqata e Peshkatarëve Rekreativo Sportiv “Trofta e Lepencit”
17. Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor në Kaçanik.
18. Klubi i Shahut „Lepenci”
19. OJQ Kampi i Artistëve Mural,
20. Shoqata Kulla e Gurit
21. Organizata e Pensionerëve të Kosovës –Dega Kaçanik.

OBJEKTET SPORTIVE

Angazhimet dhe kërkesat e DKRS-së për infrastrukturën sportive në komunën tonë drejtuar Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit edhe këtë vit nuk kanë munguar, ku edhe pas shumë kërkesave të dërguara dhe ndërprejes së punimeve për operatorin e kontraktuar të punimeve të mëhershme(kërkes edhe e MKRS) , edhe këtë vitë nuk kanë vazhduar punimet në ndërtimin e tribunave në Stadiumin e Qytetit “Besnik Begunca”. Momentalisht në Stadiumin e Qytetit “Besnik Begunca” stërvitjet dhe ndeshjet i zhvillojnë Klubi i Futbollit “Lepenci” dhe gjitha shkollat e futbollit të cilat veprojnë në komunën tone. Në Palestrën Sportive e cila tani më është funksionale zhvillojnë aktivitetet gjitha klubet sportive të cilat aktivizohen në komunën tone e që garojnë në ligat përkatëse. Fusha me barë sintetik afër palestrës sportive shfrytëzohet nga klubet sportive dhe të gjithë qytetarët e komunës sonë. Projekti në ndërtimin e fushave të jashtme sportive dhe stazës rekreative të vrapimit në hapësirën e Palestrës Sportive tani më është përfunduar dhe shfrytëzohet nga qytetarët e komunës sonë dhe klubet sportive. Gjithashtu në fshatin Gilloboçicë ka përfunduar ndërtimi i fushës sportive .

SHTËPIA E KULTURËS “XHELADIN KURTAJ”

- Edhe gjatë vitit 2024 drejtorja dhe stafi mbështetës i Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” u angazhua për kryerjen e punëve, shërbimeve dhe detyrave tjera, si:
 - Përkujdesja e vazhdueshme dhe mirëmbajtja e hapësirës së objektit.
 - Ofroi shërbim për lexues dhe për të gjitha asociacionet lokale, për aktivitetet e tyre jokomerciale kulturore-artistike, letrare, përkujtimore, politike, fetare, humane, sportive, garuese e manifestime të tjera.
- Gjithashtu vazhdojnë të qëndrojnë në lokalet e Shtëpisë së Kulturës:SHKAtë, si “Gryka e Kaçanikut”, QK “Kaçaniku” si dhe grupet e ndryshme, NKMDLNJ, Kryqi i Kuq, KVRL, OMM „Gjethi”, Shoqatat e dalura nga lufta, SH.B Alpiniste „Kaçaniku 2015” si dhe dy qendrat rinore – „Shtëpia e Shpresës” dhe „ Discovery Lab”.

SHËNIM:

Janë organizuar e ndihmuar edhe një varg aktiviteteve e programesh të tjera në Shtëpinë e Kulturës “Xheladin Kurtaj” dhe në Palestrën e Sportit në Kaçanik, mbi bazën e kërkesave të grupeve dhe shoqatave të ndryshme joqeveritare, rinore e sportive;

- Pjesëmarrje dhe angazhim në çdo përvjetor ,vizitë pllakave të të rënëve për të gjitha datat e Rënies së Dëshmorëve në Komunën tonë.
- Në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor janë organizuar gara në të gjitha lëmitë sportive (meshkuj,femra) ku vendet e para kanë përfaqësuar komunën tonë në garat regjionale.
- Pjesëmarrës dhe të angazhuar direkt edhe në komisione të ndryshme në kuadër të Komunës .
- Pjesëmarrja e SHKA-ve në Festivale të ndryshme mbrenda dhe jashtë Kosovës , të cilat përfaqësuan komunën tonë në mënyrë të dinjitetëshme, duke i sjellur shumë çmime të vlerësuara.
- Në palëestrën sportive janë zhvilluar stërvitjet dhe ndeshjet kampionale për të gjitha klubet tona në rangje të ndryshme garash dhe gjithashtu aktivitete kulturore e rinore.
- Gjatë këtij viti DKRS ka patur në dispozicion edhe minibusin dhe kombin të cilët janë shfrytëzuar nga OJQ-të kulturore, rinore dhe klubet sportive për realizimin e aktiviteteve të tyre.

INVESTIMET KAPITALE

Drejtoria për Kulturë,Rini e Sport në aktivitetet e saja gjatë vitit 2024 , është përkushtuar edhe në realizimin dhe menagjimin e investimeve kapitale , bazuar në listën e projekteve kapitale në projekt buxhetin e vitit 2024 , i cili është miratuar nga Kuvendi Komunal . Në bashkëpunim me zyrën e Kryetarit, ekzekutivin dhe zyrtarët komunal janë realizuar këto projekte:

1. Rregullimi i Varrezave të Dëshmorëve dhe Veteranëve të UÇK-së (projekt dy vjeçar)
2. Rregullimi i Tereneve Sportive te Palestra në Kaçanik
3. Rregullimi i Terenit Sportiv në Fshatin Glloboqicë

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm duke u bazuar në Planet strategjike komunale si dhe në Planin e punës për vitin 2024, ka vazhduar aktivitetin dhe punën e saj duke u munduar që në krye të prioritetëve dhe në fokus të veçantë të ketë mirëqenien e qytetarëve të Komunës tonë.

Përkundër sfidave të vazhdueshme në aspektin e çështjeve ekonomike, DZHET ka arritur që të zbatoj planin e punës të paraparë për këtë vit dhe të kryej detyrat me përgjegjësi të cilat janë në kompetencën e saj.

Të gjitha aktivitetet të cilat janë realizuar dhe ato të cilat janë në proces e sipër i gjeni të bashkëngjitura në këtë raport vjetor.

Në kuadër të drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit funksionon : Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit si dhe Qendra Komunale për Regjistrimin e Biznesit .

Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

Komuna e Kaçanikut është njëra ndër komunat me potencial të jashtëzakonshëm për zhvillim të turizmit në Kosovë e sidomos turizmit malor. Marrë për bazë këtë, ne jemi munduar në vazhdimësi që këtë potencial ta promovojmë përmes bashkëpunimeve dhe projekteve konkrete, në mënyre që të nxisim zhvillimin ekonomik dhe promovimin e vlerave historiko-kulturore dhe natyrore të vendit tonë.

Gjatë këtij viti nuk ka munguar bashkëpunimi me nivelin qendror, komunat tjera si dhe me akter të ndryshëm siç janë organizatat e ndryshme joqeveritare si :AZHR-Lindje ,Demos, USAID, GIZ-in Gjerman si dhe me KFOR-in me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit . Kryesisht këto bashkëpunime janë konkretizuar me marrëveshje më shumë në fushën e turizmit.

Vlen të theksohet se këtë vit Komuna e Kaçanikut dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit për bashkëfinancim të projektit ”Ndërtimi i objektit kullë për vrojtimit tek bashkimi i dy lumenjëve ”. Projekt ky i cili ka pasur qëllim t’i kontribuojë zhvillimit të turizmit në vend. Ky projekt nga MZHR-ja është mbështetur me shumën 60,000.00€. Komuna e Kaçanikut dhe Komanda e Rajonit Perëndimor të KFOR-it gjatë vitit kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit në fushën e turizmit . Marrëveshja përfshinë bashkëpunimin ndërmjet Komunës tonë, KFOR-it si dhe universitetet: “Haxhi Zeka” në Pejë, “Ukshin Hoti “ Prizren si dhe universitetin ”Fehmi Agani “në Gjakovë .

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe Komuna e Kaçanikut dhe USAID kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit në aktivitetin “Qeverisja e pronës “ dhe në kuadër të kësaj, janë mbajtur disa punëtori me gratë ndërmarrëse sa i përket aktivitetit për qeverisjen e pronës ,qasja më e lehtë në financa si dhe ndihmesa sa i përket hapjes dhe zhvillimit të biznesit. Gjithashtu në kuadër të këtij memorandumi është themeluar ” Këshilli publiko-privat” i cili ka për qëllim bashkëpunimin e Sektorit privat me Institucionet komunale .

Kanë vazhduar bashkëpunimet me Drejtorinë për Planifikim dhe Menaxhim të Parkut Nacional “Sharr”, në kuadër të kësaj, ne kemi dërguar propozimet tona të cilat duhet të përfshihen në Planin e ri Kombëtar për Parkun Kombëtar “Sharr”. Propozimet tona lidhen me zhvillimin e turizmit në dhe krijimin e një zone të re turistike të qasshme me infrastrukturë dhe projekte të tjera të nevojshme për zhvillimin e kësaj pjese .

AZHR-Lindje dhe Komuna e Kaçanikut në kuadër të bashkëpunimit shumëvjeçar, këtë vit kanë arritur marrëveshjen që të realizohet një projekt që ka të bëjë me promovimin e turizmit në komunën tonë.

Gjithashtu, bashkëpunimi nuk ka munguar me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrsisë dhe Tregtisë, Departamentin e Turizmit ,që kryesisht kanë qenë bashkëpunime në hartimin e dokumenteve të rëndësishme strategjike zhvillimore.

Në kuadër të politikave tona zhvillimore ekonomike, ku si prioritet kemi rritjen e numrit të të punësuarve, jemi duke identifikuar edhe disa hapësira të përshtatshme për krijimin e zonave për vendosjen e parqeve industriale ,inkubatorë biznesi dhe zonat të reja turistike me qëllim të ofrimit të kushteve infrastrukturore për investitor dhe nxitjen e tyre për investim në Komunën tonë. Përmes këtij procesi presim shtim të numrit të vendeve të reja të punës si dhe rritje të zhvillimit ekonomik në përgjithësi.

Përmes pronave të cilat mund të jepen për shfrytëzim, jemi duke u munduar të kontaktojmë investitorë potencial, me qëllim që t'i njoftojmë për kushtet e krijuara në fushën e të bërit biznes në Komunën tonë. Kemi pasur disa kërkesa nga investitorë të ndryshëm , vlen të cekët që këtë vit janë nënshkruar kontratat për dhënie të pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë me tre investitor.

Edhe në këtë periudhe ka vazhduar aplikimi i taksës zero për ushtrim të veprimtarisë së bizneseve si dhe normës minimale për biznese në tatim në pronë.

Shfrytëzimi i lokaleve në pronësi të komunës të cilat jepen për bizneset në komunën tonë do të mbetet falas deri në një vendim tjetër, me qëllim që të përkrahen bizneset lokale.

Gjithashtu, Komuna e Kaçanikut është në proces të hartimit të “Planit Strategjik për Zhvillim Ekonomik Lokal”, është formuar Grupi punues dhe i njëjti ka punuar rreth grumbullimit të të dhënave, konkretisht analizën e gjendjes aktuale, plotësimin e pjesës së sfondit. Finalizimi i këtij dokumenti pritet të të bëhet vitin e ardhshëm.

Ne si drejtori në kuadër të aktiviteteve tona kemi zhvilluar disa takime me bizneset që operojnë në komunën tonë, në mënyrë që të njihemi më shumë me nevojat dhe sfidat me të cilat përballet sektori ynë privat.

Për kundër vështirësive që kemi hasur gjatë rrugës, si pasojë e mundësive të kufizuara financiare të komunës sonë, megjithatë janë zhvilluar dhe janë në proces shumë punë të mira për Komunën dhe qytetarët tanë.

Nga puna jonë e përbashkët në DZHET me fillimin e veprimtarisë së saj, është bërë identifikimi i nevojave dhe projekteve të mundshme të cilat do të krijojnë dhe mundësojnë një zhvillim më të mirë dhe më të qëndrueshëm lokal dhe të turizmit në përgjithësi. Marrë për bazë se për shkak të pozitës gjeografike , relievit kodrinoro-malor dhe natyrës së saj piktoreske, komuna jonë ka potencial të jashtëzakonshëm të zhvillimit të turizmit malor, andaj edhe puna jonë është e fokusuar në këtë drejtim.

Disa nga projektet konkrete që janë në fazë të realizimit dhe ato që kanë përfunduar në më shumë detaje paraqiten si në vijim:

Projektet kapitale

- Projekti me titull sipas kontratës: "***Ndërtimi i shkallëve për ngjitje mbi Gurin e Shpuar***" me numër identifikues: ***KA652/23/010/521***, implementimi i këtij projekti ka filluar në vitin 2023 dhe punimet kanë vazhduar edhe në këtë vit. Ky projekt sipas kontratës është paraparë të realizohet përgjatë viteve (2023-2025), vlera e këtij projekti sipas kontratës është 217,999.35€. Këtë vit janë shpenzuar rreth 130,000.00€, janë kryer rreth 400 m shteg të shkallëve nga 510m sa janë gjithsej sipas projektit detal. Projekti pritet të përfundoj në vitin 2025 sipas kontratës me Operatorin Ekonomik.
- Projekti me titull sipas kontratës : "***Ndërtimi i parkut rekreativ në zonën turistike në fshatin Shtrazë*** " me numër identifikues: ***652-23-6713-5-2-1***. Në këtë projekt punët janë finalizuar. Vlera e kontratës me Operatorin Ekonomik 107,317.78€, ndërsa vlera e Aneks kontratës në këtë projekt kap vlerën 8,280.23€.
- Projekti me titull sipas kontratës : "***Ndërtimi i trotuarit, shtegut për çiklizëm dhe ndriçimit publik***" në rrugën " ***Murat Lika,***" në Strazhë, me numër identifikues: ***652-23-2430-521***. Ky projekt ka qenë i planifikuar të realizohet në vitet 2023-2024. Punimet në këtë projekt kanë përfunduar. Vlera e kontratës me OE ka qenë 122,852.50 €, ndërsa janë shpenzuar 120,402.50€. Projekti është kompletuar në tërësi, ndërsa të pashfrytëzuara kanë mbetur shuma e mjeteve në vlerë 2,450.00€
- Projekti kapital me titull "***Ndërtimi i objektit kulle për vrojtim tek bashkimi i dy lumenjëve*** " me numër identifikues ***652-24-1066-5-2-1***, projekt ky i cili është mbështetur me shumën 60,000.00€ nga Ministria e Zhvillimit Rajonal. Është lidhur kontrata me Operatorin Ekonomik në vlerë 67,845.67€. Në këtë projekt punimet kanë filluar sipas kontratës, ku janë kryer disa punë të gërmimit të dheut për hapjen e themeleve të shtyllave dhe është bërë betonimi i shputës së themelit të njëres nga shtyllat. Mirëpo, punimet janë ndërprerë nga Inspektorati i MMPHI-së më datë 29.07.2024, për arsye se Ministria në fjalë gjegjësisht Departamenti i ujërave (ARPL) nuk ka lëshuar pëlqimin ujqor, d.m.th punimet në këtë projekt janë të ndërprera.

Për shkak se në këtë rrugë ku janë zhvilluar punimet , operon një biznes –restorant dhe me hapjen e gropës ndërtimore për punimin e themeleve e kemi ndërprerë këtë rrugë duke e njoftuar paraprakisht biznesin se do të ketë ndërprerje në qarkullim për automjete deri sa t'i ndërtojmë themelet e objektit, mirëpo pasi që janë ndërprerë punimet ne jemi detyruar që të mbushim përsëri një pjesë të gropës ndërtimore në mënyrë që t'i krijojmë qasje për qarkullim biznesit në fjalë.

Përkundër kërkesave të vazhdueshme dhe takimeve që kemi pasur në MMPHI, Komuna e Kaçanikut nuk ka arritur të marrë këtë vit pëlqimin e nevojshëm për realizim të projektit.

Pagesat për punët e kryera në këtë projekt janë bërë nga kodi i bashkëfinancimit në vlerë prej 8,778.11€.

- Këtë vit kanë filluar punimet në projektin “*Shtegu i Lirisë*” *faza I*, vlera e kontratës me OE është 73,643.96€, ndërsa, vlera e punimeve të kryera është 24,399.22€, shprehur në përqindje rreth 33% e punimeve. Në punët e realizuara përfshihet: hapja e trasesë, gjurmimi i dheut, punët e zhavorrit dhe punimi i disa elementeve të shtegut. Kjo fazë e projektit do të vazhdojë dhe pritet të përfundojë gjatë vitit 2025.

Qendra Komunale Për Regjistrim të Biznesit

Në funksion të biznesit lokal ekziston Qendra Komunale për Regjistrimin e Biznesit. Përmes kësaj qendre komuniteti i biznesit për një periudhë të shkurtër mund të regjistrojnë apo themelojnë veprimtarinë biznesore. Poashtu, përmes saj bëhet edhe ofrimi i informatave për investitorët potencial, gjithashtu jepen këshilla ndaj bizneseve fillestare dhe atyre ekzistuese në plotësimin e aplikacioneve të ndryshme sipas nevojës.

Kjo zyre ka një bashkëpunim të veçantë me Agjencinë për Regjistrim të Biznesit të Kosovës ku kontakti ynë me këtë institucion është pothuajse i përditshëm .

Gjatë periudhës raportuese, kjo zyre ka pranuar gjithsej **676** lëndë të cilat në afatin ligjor ka shqyrtuar të gjitha lëndët e pranuar.

Gjatë këtij viti kjo qendër numëron 145 biznese të reja të regjistruara.

Bizneset e regjistruara kanë qenë: 102 SH.P.K (Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) dhe 43 B.I (Biznese Individuale). Nga këto shifra që prezantuar më lartë 108 biznese menaxhohen nga meshkujt ndërsa 37 biznese nga femrat.

Qendra komunale për regjistrimin e biznesit	
Lloji i kërkesës	Numri
Biznese të reja	145
Shuarje të biznesit	13
Ndryshime në biznes	51
Çertifikatë dublikate	22
Çertifikatë e re	24
Informata të biznesit	226
Vërtetime rreth taksës komunale	31
Vërtetime individuale	160
Kërkesë për zgjatje të orarit të punës	01
Pagesë e taksës për ushtrim të veprimtarisë biznesore	03

Tabela 1:
Numri sipas
llojit të
kërkesave

Veprimtaritë e bizneseve të reja kanë qenë të ndryshme por më shpeshta kanë qenë, shih tabelën më poshtë:

Bizneset sipas llojit të veprimtarisë /aktivitetit	Nr.
Aktivitete shërbyese të pijeve	18
Tregëtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël	16
Aktivitete tjera shërbyese të ushqimit	13
Punime suvatimi	13
Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve	13

Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore	12
Aktivitete e tjera të specializuara ndërtimi p.k.t	11
Aktivitete të tjera me nr. me të vogël	49
Totali	145

Tabela 2: Numri i bizneseve sipas llojit të veprimtarisë /aktivitetit

Subvencionimi

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm (DZHET) në Komunën e Kaçanikut, në bazë të Rregullores për ndarjen e subvencioneve, në kuadër të Programit " Subvencionimi i bizneseve ekzistuese mikro dhe të vogla " me datë 02.07.2024 ka shpallur thirrjen për aplikim për mbështetje të bizneseve lokale mikro dhe të vogla. Nga kjo thirrje publike kemi pasur 15 përfitues. Shuma totale e mjeteve financiare të ndara për përfituesit sipas vendimit për ndarje të subvencioneve ka qenë 30,477.70 €.

Qëllimi i Programit "Subvencionimi i bizneseve ekzistuese mikro dhe të vogla", ka pasur synim fuqizimin e bizneseve të vogla lokale , përkatësisht promovimin dhe rritjen e tyre. Gjithashtu, synimi i këtij fondi ka qenë nxitja dhe mbështetja e zgjerimit të bizneseve për punësim kryesisht të grave dhe të rinjëve.